ISSN 2306-6106

AUDITIMI PUBLIK

KLSH

KËRKIMORE

SHKENCORE

INFORMATIVE

REVISTË 4 - MUJORE Nr.16

2017

ALSAI

EUROSAI

INTOSAI

Seria: botime KLSH - 06/2017/73

Tiranë, 2017

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Experentia mutua omnibus prodest

AUDITIMI PUBLIK

REVISTË KATËRMUJORE
kërkimore-shkencore-informative
shqip - anglisht

Nr. 16/2017, Tiranë
ISSN 2308-6106
Viti i VI-të i botimit 2017
Janar - Prill 2017
Seria: botime KLSH - 06/2017/73

Titulli:

AUDITIMI PUBLIK NR. 16

Redaktore : Irena Islami

Art Design: Elisa Metaj

Seria : botime KLSH - 06/2017/73

Shtypur në Shtypshkronjën ”CLASSIC PRINT”

Tiranë 2017

ALBANIAN SUPREME AUDIT INSTITUTION

Experentia mutua omnibus prodest

PUBLIC AUDIT

EVERY FOUR MONTHS MAGAZINE

of research, science and information

in Albanian and in English

No. 16/2017, Tirana

ISSN 2308-6106

January - April 2017

Series:Publications ALSAI - 06/2017/73

BORDI SHKENCOR

Dr. Bujar Leskaj, Kryetar i KLSH	Kryetar
Prof. Dr. Omer Stringa Profesor, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Dhori Kule, Dekan, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Jorgji Bollano, Kryetar i Këshillit Kombëtar të Kontabilistëve	Anëtar
Prof.Dr. Skënder Osmani, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	Anëtar
Prof. Dr. Ardian Nuni, Fakulteti i Drejtësisë	Anëtar
Prof. Dr. Sotiraq Dhamo, Përgjegjës i Departamentit të Kontabilitetit FE (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Aurela Anastasi, Akademik, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Argita Berisha, Profesor, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar
Prof. Dr. Lindita Lati, Drejtore e Përgjithshme, KLSH	Anëtar
Prof. Dr. Heinz-Dieter Wenzel, Profesor, Universiteti i Bambergut, Gjermani	Anëtar
Dr. Igor Soltes, ish-President i Gjykatës së Auditimit të Sllovenisë	Anëtar
Dr. Sang M. Lee, Universiteti i Nebraskës, SHBA	Anëtar
Prof. Dr. Tonin Kola, Profesor, Fakulteti i Ekonomisë (UT)	Anëtar
Prof. As. Dr. Sazan Guri, Instituti " G& G Group"	Anëtar
Prof.As. Dr. Manjola Naço, Drejtore e Përgjithshme, KLSH	Anëtar
Prof.As.Dr. CPA Hysen Çela, Kryetar i IEKA**,** Managing Partner,nH EuroConsult	Anëtar
Prof. As.Dr. Flutura Kola, Profesor, Fakulteti i Drejtësisë (UT)	Anëtar

SEKRETARIATI

Irena Islami	Sekretare Kolegjiumi

I NDERUAR LEXUES !

Kolana e botimeve të KLSH-së po pasurohet dita ditës me botime të reja dhe Revista Kërkimore Shkencore është një nga botimet më dinjitoze të saj.

Në këtë numër të 16-të të Revistës kanë kontribuar me shkrimet e tyre personalitete të njohura të auditimit të jashtëm publik nga Gjykata Evropiane e Audituesve, pedagogë të Fakultetit të Ekonomisë, të Gjeologji-Minierave, drejtues dhe auditues të KLSH-së, etj.

Janë të ftuar të publikojnë punimet dhe opinionet e tyre kontabilistë, financierë, ekonomistë të përgjithshëm, specialistë të enteve publike dhe private, akademikë, ekspertë të shoqërisë civile, profesionistë të pavarur si dhe çdo i interesuar që gjen me vend trajtimin e një çështjeje të caktuar me interes në auditimin dhe vlerësimin e administrimit publik të vendit, bazuar në moton e INTOSAI *"Experentia mutua omnibus prodest (Eksperienca e Përbashkët ju shërben të gjithëve)"*.

Bordi Shkencor i Revistës ju fton të shprehni vërejtjet dhe sugjerimet tuaja në funksion të përmirësimit, të rritjes së cilësisë dhe efikasitetit të saj me qëllim që kjo Revistë Shkencore, të jetë një mundësi më shumë për zhvillimin e debatit në fushën e auditimit dhe më gjerë.

Adresa e redaksisë

Kontrolli i Lartë i Shtetit
Bulevardi " Dëshmorët e Kombit", nr. 3,
Tiranë Tel./ Fax. 04/ 228485, Tel. 04/ 251267
Web-site: www.klsh.org.al, E-mail: revista@klsh.org.al, klsh@klsh.org.al

PËRMBAJTJA

TITULLI	AUTORI	FAQE
Institucionet Supreme të Auditimit si garantues të qëndrueshmërisë fiskale	Prof. Ass.Dr. Recai Akyel Ish President Gjykata Turke e Llogarive	**11**
Mirëkuptimi dhe bashkëpunimi, kusht i domosdoshëm për optimizimin e strategjive, strukturave, projekteve dhe marrëdhënieve midis tyre	Dr.Bujar Leskaj Kryetar i KLSH Prof.Dr.Skënder Osmani Prof. Asoc. Dr. Nevton Kodhelaj Fakulteti Gjeologjisë dhe Minierave Universiteti Politeknik i Tiranës	**17**
Aspekte teoriko-praktike në menaxhimin e risqeve dhe shanseve	Prof.Dr. Gafur Muka Prof.Dr.Thoma Korini Fakulteti Gjeologjisë dhe Minierave Universiteti Politeknik i Tiranës	**29**
Vlerësimi i eficiencës së biznesit: Kosto e kapitalit për bizneset e mëdha në Shqipëri	Dr. Llesh Lleshaj Prof. Asoc. Dr. Edlira Luçi Doc. Dr. Alban Korbi Fakulteti i Ekonomisë Universiteti i Tiranës	**41**
Vlerësimi i pavarësisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit nga kolegët e institucioneve homologe (Peer- Review)	INTOSAI dhe Gjykata Austriake e Auditimit	**61**
Forcimi i infrastrukturës etike në Institucionet Supreme të Auditimit, tendencë e kohës.	Luljeta Nano Irena Islami KLSH	**89**

A mundet Platoni dhe Aristoteli të na ndihmojnë të auditojmë në botën dixhitale? Auditimi sot: parimet klasike + mjetet dixhitale	Jesus Nieto, Auditues, Drejtoria e Kontrollit të Cilësisë, ECA *(marrë nga revista e ECA-s, numri 5, maj 2017)*	**97**
INTOSAI miraton Kodin e Ri Etik	*Marrë nga revista INTOSAI Journal, pranverë 2017*	**107**
SAI-et dhe adaptimi i tyre me ndryshimet klimaterike	Michelle R.Wong, GAO & Willemien Roenhorst Gjykata Holandeze e Auditimit (*marrë nga revista INTOSAI Journal, pranverë 2017)*	**111**
Përgatitja e Institucioneve Supreme të Auditimit për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm	Blucer W. Rajaguguk, I Gusti Bagus Tridarwata Yatnaputra dhe Adrianus Paulus Bordi i Auditimit i Republikës së Indonezisë *(marrë nga revista INTOSAI Journal, pranverë 2017)*	**117**
Info nga vendi	Aktivitete të KLSH –së (janar- prill 2017)	**125**
Byroja Shtetërore e Auditimit të Kuvajtit	Profil	**163**
Kontrolli i Përgjithshëm i Shtetit i Republikës së Ekuadorit	Profil	**167**

CONTENT

TITLE	AUTHOR	PAGE
Supreme Audit Institutions as a Safeguard for Fiscal Sustainability	Ass.Prof.Dr. Recai Akyel Former President of Turkish Court of Accounts	**175**
Understanding and cooperation, essential criteria for optimizing strategies, structures, projects and relationships among them	Dr.Bujar Leskaj, State Supreme Audit Institution Prof.Dr.Skënder Osmani Ass. Prof. Dr. Nevton Kodhelaj Faculty of Geology and Mining Polytechnic University of Tirana	**181**
Theoretical-practical aspects in risk management and opportunities	Prof.Dr. Gafur Muka Prof.Dr.Thoma Korini Faculty of Geology and Mining Polytechnic University of Tirana	**193**
Business Efficiency Assessment: Capital cost for large enterprises in Albania	Dr. Llesh Lleshaj Ass.Prof. Dr. Edlira Luçi Doc. Dr. Alban Korbi Faculty of Economy, University of Tirana	**205**
Final Report Peer Review on the Independence of the State Supreme Audit of Albania	INTOSAI and Austrian Court of Audit	**225**
Strengthening the Ethical Infrastructure in Supreme Audit Institutions, the trend of the time	Luljeta Nano Irena Islami ALSAI	**255**

Can Plato and Aristotle help us audit in the digital world? Audit today: classical principles + digita tools	Jesus Nieto, Auditor in the Directorate of the Audit Quality Control Committee *Published in no.5 of ECA Journal*	**263**
INTOSAI launches new Code of ethics	INTOSAI Journal, spring 2017	**273**
Supreme Audit Institutions and climate change adaptation	Michelle R.Wong, GAO & Willemien Roenhorst Netherlands Court of Audit *INTOSAI Journal, spring 2017*	**277**
Preparing Supreme Audit Institutions for sustainable development goals	Blucer W. Rajaguguk, I Gusti Bagus Tridarwata Yatnaputra dhe Adrianus Paulus The Audit Board of the Republic of Indonesia *INTOSAI Journal, spring 2017*	**283**
Events and activities of ALSAI during January- April 2017	INFO	**291**
State Audit Bureau of Kuwait	Profile	**325**
General State Control of the Republic of Ecuador	Profile	**329**

INSTITUCIONET SUPREME TË AUDITIMIT SI GARANTUES TË QËNDRUESHMËRISË FISKALE

Marrë nga libri, "Çështje të Auditimit publik", me autor Prof.Ass.Dr.Recai Akyel, Ish-President i Gjykatës Turke të Llogarive

Një qeverisje e mirë përfshin një sërë elementësh, ku përmendim garantimin e përdorimit me efektivitet të burimeve publike, informimin e publikut mbi rezultatet bazuar në objektivat e qeverisë dhe dhënien e sigurisë se institucionet publike operojnë në përputhje me parimet e llogaridhënies dhe transparencës.

Nga: Prof.Ass.Dr.Recai Akyel, Ish-President i Gjykatës Turke të Llogarive

Hyrja

Bazat e teorisë së ekonomisë ndërlidhen me pyetjen "si mund të plotësohen kërkesat e palimitura, kundrejt burimeve të limituara?" Kjo pyetje vlen për sektorin publik dhe gjithashtu qeveritë. Sektori publik përballet me sfidën e vazhdueshme për përmbushjen e kerkesave në rritje, me burime të kufizuara. Ky kufizim bën që të shikohet me prioritet përdorimi efektiv i burimeve publike, në mënyrë që të ruhet qëndrueshmëria e shërbimeve publike. Në këtë pikë, Institucionet Supreme të Auditimit kanë një rol kryesor si institucione garantues të përdorimit me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë të burimeve publike. Qytetarët kanë pritshmëri të larta dhe kanë nevojë për garanci nga Institucionet Supreme të Auditimit mbi funksionimin efektiv të institucioneve publike dhe vetë qeverisë.

Nisur nga këto problematika, lind nevoja për forcimin e Institucioneve Supreme të Auditimit që ata të funksionojnë në mënyrë të përshtatshme dhe efektive. Problemet ekonomike me të cilat shume qeveri po perballen vitet e fundit, janë duke nxitur edhe më tej rritjen e rëndësisë së Institucioneve Supreme të Auditimit për garantimin e një qeverisjeje të mire. Një qeverisje e mirë përfshin një sërë elementësh, ku përmendim garantimin e përdorimit me efektivitet të burimeve publike, informimin e publikut mbi rezultatet bazuar në objektivat e qeverisë dhe dhënien e sigurisë se institucionet publike operojnë në përputhje me parimet e llogaridhënies dhe transparencës. Gjithashtu, qëndruesh-mëria fiskale është një element i një qeverisjeje të mirë dhe duhet të trajtohet së bashku me menaxhimin financiar dhe sistemin e kontrollit.

Ndryshimi i rolit të Institucionieve Supreme të Auditimit në sektorin publik

Në trajtimin e rolit të Institucioneve Supreme të Auditimit në sektorin publik, përmenden dy koncepte të pandashëm nga njëri tjetri: llogaridhënia dhe transparenca. Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme te Auditimit (ISSAIs) i përmendin gjithashtu këto dy koncepte, duke shtuar se ato janë elementet kryesorë të një qeverisjeje të mirë. Transparenca lidhet me dhënien e informacionit të mjaftueshëm mbi aktivitetet publike për t'i dhënë mundësi qytetarëve dhe publikut të gjerë t'i shqyrtojnë ato. Në anën tjetër, llogaridhënia është garantimi i monitorimit të vazhdueshëm të institucioneve publike dhe përformancës së tyre. Standartet Ndërkombëtare të Auditimit përcaktojnë se promovimi i llogaridhënies dhe transparencës së aktiviteteve publike është një përgjegjësi e Institucionit Suprem të Auditimit.

Në një botë dhe ekonomi të globalizuar, përveç kërkesave së llogaridhënies dhe transparencës, shtetet e zhvilluara janë duke u përballur me çështjen e qëndrueshmërisë fiskale. Në vijim të kufizimeve të përmendura më sipër si kufizimi i burimeve dhe rritja e kërkesave, ekziston gjithashtu një kufizim për garantimin e shërbimeve publike të së njëjtës cilësi. Krizat financiare që ndikojnë qeveritë e bëjne edhe me të vështirë arritjen e objektivit për ruajtjen e të njëjtit nivel të shërbimeve publike në të njëtin nivel cilësie me limite të arsyeshme borxhi. Qeveritë përballen me problematikat e rritjes së kostove të shërbimeve publike dhe në disa raste nuk mund të arrijnë objektivat në përputhje me limitet buxhetore. Ky problem risjell në vëmendje çështjen e qëndrueshmërisë fiskale.

Në terma të përgjithshëm, qëndrueshmëria fiskale lidhet me garantimin e burimeve të nevojshme për një program specifik, sektor apo ekonomie në një hark kohor të përcaktuar. Qëndrueshmëria fiskale është aftësia e një qeverie për të menaxhuar shpenzimet aktuale në terma afatgjatë pa dëmtuar detyrimet apo shpenzimet e parashikuara. Ashtu siç kuptohet edhe nga këto përkufizime, qëndrueshmëria fiskale është një çështje që u përket të gjitha shteteve moderne, por pyetja më e rëndësishme është së si lidhet qëndrueshmëria fiskale me Institucionet Supreme te Auditimit.

Ndërlidhja e qëndrueshmërisë fiskale me Institucionet Supreme të Auditimit është një çështje e njohur dhe shumë e debatuar, veçanërisht në komunitetin e audituesve për shkak të rëndësisë së saj. Kjo çështje është trajtuar në një sërë konferencash deri tani. "Qëndrueshmëria Fiskale, Prezantimi i Llogarive dhe Llogaridhënia" ishte përzgjedhur si tematika kryesore në Konferencën EUROSAI-OLACEFS në 2007. Gjithashtu, një sërë deklaratash mbi këtë çështje

specike u mbajtën në Simpoziumin Ndërkombëtar, organizuar si pjesë e festimeve për Përvjetorin e 150-të të Gjykatës Turke të Llogarive (TCA) në Ankara, 2012. Ashtu siç u përmend në konferencën EUROSAI-OLACEFC në 2007, rëndësia në rritje dhe kapaciteti teknik në lidhje me praktikat e qëndrueshmerisë fiskale, këshillojnë forcimin e rolit të Institucioneve Supreme te auditimit në shtete të ndryshme. Në përmbyllje të kësaj konference, pjesëmarrësit ranë dakort se Institucionet Supreme të Auditimit duhet të ndërmarin iniciativa për garantimin e qëndrueshmërisë fiskale, meqënëse është një çështje e një rëndësie te madhe dhe nevojitet të trajtohet nga një institucion i pavarur dhe i respektuar.

Institucionet Supreme të Auditimit si garantues të qëndrueshmërisë fiskale

Duke njohur rëndësinë e rolit të Institucioneve Supreme si garantues të qëndrueshmërisë fiskale, lind pyetja se si ata duhet ta kryejnë këtë rol. Kjo është një çështje që është diskutuar për një sërë vitesh, veçanërisht pas krizave që prekën shtetet Europiane në 2007. Në ditet e sotme, shtetet Europiane janë duke u përballur me një krizë borxhi sovran, i cili e bën çështjen e qëndrueshmërisë fiskale edhe me të rëndësishme.

Meqënëse roli i Institucioneve Supreme të Auditimit për garantimin e qëndrueshmërisë fiskale është një tematikë relativisht e re, ekzistojnë ende disa paqartësi për metodat që Institucionet Supeme të Auditimit duhet të aplikojnë. Mund të themi se Institucionet Supreme të Auditimit funksionojnë si garantues të qëndrueshmërisë fiskale në tre rrugë të ndërlidhura me njëra tjetrën. Si fillim, Institucionet Supreme të Auditimit mund të monitorojnë aplikimin e dispozitave buxhetore bazuar në qasjen mbi rezultatet e arritura. Për të kuptuar këtë rol të Institucioneve Supreme të Auditmit, është me rëndësi sjellja në vëmendje e një prej masave reformuese më të rëndësishmë të ndërmara për garantimin e qëndrueshmërisë fiskale: zhvendosja e sistemit të kontabilitetit në sektorin publik nga ai me bazë monetare, në atë me bazë rrjedhëse. Ky ndryshim i lejoi qeverive të garantonin disiplinën fiskale, llogaridhënien dhe transparencën në përdorimin e burimeve publike. Reforma në sistemin e kontabilitetit solli dhe ndryshime në sistemet buxhetore, të cilat çuan në adoptimin e buxhetimit bazuar në performancë, i cili do të bazohej në përcaktimin e objektivave dhe qëllimeve si dhe përdorimin e burimeve publike lidhur me to. Këto reforma në sistemin e menaxhimit financiar publik u bazuan në përdorimin efektiv të burimeve publike duke sjellë përgjegjshmëri të tjera shtesë për Institucionet Supreme të Auditimit për garantimin e një qeverisjeje të mirë në menaxhimin financiar publik. Në përputhje me këto reforma, Institucionet Supreme të Auditimit pritet të japin mendim mbi implementimin e programeve publike dhe rezultateve apo përfundimeve të këtyre programeve për garantimin e llogaridhënies dhe transparencës, duke vepruar në mënyrë indirekte si garantues të ruajtjes së

qëndrueshmërinë fiskale. Këto lloje auditimi synojnë të promovojnë implementimin e suksesshëm të politikave publike dhe shtimin e vlerës së tyre. Gjithashtu, bazuar në mandatet respektive, Institucionet Supreme të Auditimit mund të paralajmërojnë për devijimet nga objektivat e përcaktuar dhe të japin rekomandime për veprimet e duhura. Kjo mund të ndihmonte qeveritë të shikonin parregullsitë dhe t'i korrigjonin ato në kohën e duhur, dhe në këtë mënyrë mund të kontribuonin në garantimin e stabilitetit buxhetor.

Së dyti, Institucionet Supreme të Auditimit mund të shërbejnë si garantues në ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale nëpërmjet auditimit të borxhit publik. Ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë nëpërmjet qëndrueshmërisë fiskale dhe borxhit publik. Përkufizimi i qëndrueshmërisë fiskale veçanërisht përcakton se qëndrueshmëria për qeveritë lidhet me ofrimin e të njëtit nivel të shërbimeve në hark kohor afatgjatë duke mbrojtur nivelin e aftësisë për të paguar. Pra, si institucione të auditimit të jashtëm publik, Institucionet Supreme të Auditimit mund të komentojnë mbi volumin e borxhit publik dhe qëndrueshmërisë së tij sipas mandateve të tyre. Kjo do të ishte e një rëndësie të madhe bazuar në reputacionin e pavarur dhe të besueshëm të Institucioneve Supreme të Auditimit. Siç është përmendur edhe në Simpoziumin Ndërkombëtar në Ankara, Maj 2012, pozicioni i pavarur i Institucioneve Supreme të Auditimit dhe marrëdhënies së tyre me Parlamentin, i jep SAI-ve statusin e duhur për t'u angazhuar me borxhin publik. ISSAI 5430 përcakton: "Institucionet Supreme të Auditimit, bazuar në limitet e fuqisë dhe përgjegjësive të tyre mund të nxisin qeveritë të ndërmarrin praktika për vlerësimin, raportimin financiar, buxhetimin dhe mbikqyrjen e ekspozimit fiskal të shtetit. Institucionet Supreme të Auditimit gjithashtu mund të dëshirojnë të informohen dhe të suportojnë adoptimin e praktikave më të mira për trajtimin e riskut".

Gjithashtu, në të njëjin standart përmendet se "duke marë parasysh çështjet komplekse dhe konceptuale lidhur me eskpozimet fiskale, Institucioneve Supreme të Auditimit mund t'u duhet të zhvillojnë aftësitë e nevojshme së brendshmi si dhe përmes qeverive të tyre". Mbikqyrja e borxheve, garancive dhe sigurimeve, dhe rishikimi i implikimeve buxhetore afatgjate mund të përmenden si shembuj të mbikqyrjes së ekspozimeve fiskale. Metoda që implementon çdo Institucion Suprem Auditimi varion në bazë të mandatit të tyre dhe kushteve lidhur me to. Megjithashtë, ajo çka është e rëndësishme, është auditimi i borxhit publik dhe dhënia e rekomandimeve për qeveritë mbi këtë çështje në mënyrë që të ruhet qëndrueshmëria fiskale.

Mënyra e tretë që Institucionet Supreme të Auditimit mund të kontribuojnë në

qëndrueshmërinë fiskale do të ishte puna e tyre për ruajtjen e një qeverisjeje të mirë. Institucionet Supreme të Auditimit janë institucionet kyçe për garantimin e një qeverisjeje të mirë nëpërmjet gjetjeve të tyre nga auditimi dhe rekomandimeve. Një qeverisje e mirë kërkon monitorim dhe auditim në mënyrë që të garantojë implementimin e politikave të vendosura në mënyrë të arsyeshme dhe përmbushjen e qëllimeve strategjike. Një mjet për të kontribuar në një qeverisje të mirë mund të jetë dhënia e mendimit mbi kontrollin e brendshëm. Disa Institucione Supreme Auditimi kanë autoritetin të japin mendim mbi efektivitin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm në institucionet publike. Ky fuksion do të ndihmonte institucionet publike dhe sektorin publik për t'u njohur me të metat e kontrollit të brendshëm në mënyrë që të bëhen përmirësimet respektive. Në këtë mënyrë, do të ishtë e mundur arritja e një qeverisjeje të mirë në sektorin publik nëpërmjet kontributeve të Institucioneve Supreme të Auditimit me gjetjet e tyre dhe rekomandimet. Ky kontribut, do të shërbente sigurisht në mënyre indirekte si një mjet për ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale.

Konkluzione

Ashtu sic u përmend më parë, qëndrueshmëria fiskale është një sfidë ndërkombëtare e zakonshme në ditët e sotme. Për ta kapërcyer këtë sfidë, qeveritë kanë adaptuar reforma në sektorin publik, të cilat janë ende në proces. Në të njëjtën linjë, Institucionet Supreme të Auditimit duhet gjithashtu të mbështesin këto reforma dhe të përshtatin metodologjitë e tyrë me to.

Institucionet Supreme të Auditimit janë përgjegjëse për auditimin e përdorimit efektiv, ekonomik dhe eficient të burimeve publike dhe ky funksion është një mënyrë mbikqyrjeje për garantimin e qëndrueshmërisë fiskale. Çdo Institucion Suprem Auditimi duhet të përcaktojë rolin e tij në promovimin e qëndrueshmërisë fiskale në vendet e tyre. Nuk ekziston një metodë e përcaktuar për kryerjen e ketij roli, por bazuar në implementimet aktuale, është e mundur të themi se ai mund të kryhet në tre mënyra të ndryshme: duke audituar dhe duke dhënë mendim mbi rezultat dhe përfundimet e objektivave të politikave buxhetore, duke audituar borxhin publik dhe duke dhënë rekomandimet përkatëse, dhe duke audituar dhe dhënë mendim mbi efektivitetin e sistemeve të kontrollit të brendshem. Këto janë metodat nga të cilat Institucionet Supreme të Auditimit mund të zgjedhin të përdorin bazuar në mandatin e tyre respektiv, por sigurisht nuk janë precize apo të përfunduara. Meqënëse kjo është një çështje relativisht e re për Institucionet Supreme të Auditimit, është e sigurtë që ata do të zhvillojnë metodat e tyre për të menaxhuar qëndrueshmërinë fiskale në kohën e duhur.

Për ta përmbyllur, roli i Institucioneve Supeme të Auditimit për ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale është i një rëndësie të madhe për qeveritë.

Megjithatë, shtrirja dhe metoda për kryerjen e këtij roli ende nuk është përcaktuar. Për këtë arsye, është mjaft e rëndësishmë ndarja e eksperiencave ndërmjet Institucioneve Supreme të Auditimit për të gjetur nje mënyre të përbashkët dhe të aplikueshme për të trajtuar këtë çështje. Institucionet Supreme të Auditimit duhet të shkëmbejnë informacion dhe të vazhdojnë të ndajnë eksperienca, metodologji dhe rezultate, në mënyrë që ata të shërbejne efektivisht si garantues për ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale.

Përktheu: Joana Troqe, Audituese

Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit

Nga: Prof.Ass.Dr.Recai Akyel, Ish-President i Gjykatës Turke të Llogarive

MIRËKUPTIMI DHE BASHKËPUNIMI KUSHT I DOMOSDOSHËM PËR OPTIMIZIMIN E STRATEGJIVE, STRUKTURAVE, PROJEKTEVE DHE MARRËDHËNIEVE MIDIS TYRE

Natyrisht kur mirëkuptimi dhe bashkëpunimi synon vendimarrjen ose zgjidhjen e një problemi të rëndësishëm shoqëror, ekonomik, politik, mjedisor, optimizimi, risku, menaxhimi etj., krijimi dhe zbatimi i modeleve matematike për arritjen e rezultatit të kërkuar qëndron në thelb të studimit dhe vlerësimit të vendimarrjes përkatëse.

Nga: Dr.Bujar Leskaj, Prof.Dr.Skënder Osmani, Prof.Asoc.Dr.Nevton Kodhelaj

Abstrakt

Mirëkuptimi është një problem që ngërthehet në familje, shkollë, punë, komunitet, institucione publike apo private e shumë më gjerë, sa herë dy ose më shumë palë janë të interesuara të ndajnë ose jo gjykime për një vendim të rëndësishëm apo optimizimin e zgjidhjes së një problemi të rëndësishëm. Në një kuptim akoma më rigoroz mirëkuptimi (apo solidariteti për të bashkëpunuar) në aspektin teorik mund të trajtohet në disa aspekte ndër të cilat optimizimi (i parë në plan shumë të përgjithshëm), teoria e lojërave matematike etj., kanë një rol të rëndësishëm. Në kushtet kur vendi ynë vazhdon të mbetet tejet i politizuar dhe me nivel të lartë të varfërisë, shtjellimi i kësaj kategorie mirëkuptimi individual, instrumental, periodik etj., zë një vend të veçantë qoftë si potencial zhvillimi, ashtu edhe në prapambetje. Që nga krijimi i shtetit e deri më tani ka pasur mjaft premisa zhvillimi "pozicioni gjeopolitik e gjeostrategjik, burimet natyrore dhe ambientaliste, klima, bujqësia, turizmi etj.", megjithatë të gjithë këta faktorë nuk kanë arritur të pasqyrojnë "performancën e tyre" dhe kjo ka ndodhur sepse nuk kemi pasur asnjëherë strategji të mirëfillta mirëkuptimi dhe bashkëpunimi. Mirëkuptimi dhe bashkëpunimi për krijimin dhe realizimin optimal të tyre nuk ka qenë në nivelin e kërkesave dhe kritereve të zhvillimit të vendit. Natyrisht kur mirëkuptimi dhe bashkëpunimi synon vendimarrjen ose zgjidhjen e një problemi të rëndësishëm shoqëror, ekonomik, politik, mjedisor,

optimizimi, risku, menaxhimi etj., krijimi dhe zbatimi i modeleve matematike për arritjen e rezultatit të kërkuar qëndron në thelb të studimit dhe vlerësimit të vendimarrjes përkatëse. Disa konsiderata mbi këto çështje përbëjnë thelbin e këtij punimi.

Fjalë kyçe: *Lojë, kooperative (bashkëpunim), mirëkuptim, bashkëpunim, kontradiktë, strategji, strukturë, reformë, sistem, projekt, optimizim*

1. Sensibilizim mbi Optimizimin, Mirëkuptimin dhe Bashkëpunimin

Përse atëherë duhet nxitur opinioni të diskutojë mbi këtë temë? Përvoja në menaxhim na mëson që nuk mjaftojnë shembujt dhe objektet konkrete për të argumentuar vlerat e tyre menaxheriale, por duhet një punë më e gjerë, jo individuale, madje as në rang Departamenti apo Fakulteti, por institucionale e gjithëpërfshirëse. Kësisoj po të ishim mirëkuptuar institucionalisht edhe aq më tepër, nëse do të mbështeteshin fuqimisht çështje të tilla, punët do shkonin ndryshe. Themi kështu sepse me çdo kurs menaxhimi shtrohen disa probleme: sa klasa duhet të ketë shkolla, sa nxënës duhet të ketë klasa, sa degë (d.m.th. Departamente) duhet të ketë Universiteti, sa Universitete duhet të ketë vendi. Po ashtu, në një komunitet lokal apo rajonal, shtrohen pyetje lidhur me ndarjen territoriale, sa qarqe duhet të ketë vendi, sa ministri duhet të ketë shteti, sa njësi prodhuese, sa njësi shërbimesh, cili do te ishte numri maksimal i banorëve që nuk prek kufirin e varfërisë në një zonë urbane apo rurale e kështu me rradhë, etj.

Problemet e mësipërme u kthyen në strategji shtetërore mbas afro 13 vitesh në reformat arsimore, ndarjen administrative, etj. Pyetja që bëhet është: kështu do të vazhdohet edhe me Menaxhimin dhe Reformat?

Nëqoftëse ky është një slogan dhe jo një temë që hap me dhjetra disertacione në shumë fakultete e pse jo edhe institucione si Departamenti, Instituti apo Qendra e Menaxhimit, diskutimi dhe sipërmarrjet duhen vlerësuar mirë, qoftë edhe negativisht. Kjo temë duhet vlerësuar për investimin që mund të bëhet, si nga më efektivet në rang vendi, natyrisht pas një diskutimi dhe argumentimi shkencor për reformat, projektet, kontratat, prokurimet, aktivitetet e kompanive e veprave më të rëndësishme, etj. Po me të njëjtin sy duhen parë edhe marrëdhëniet bashkëpunuese të shkollës dhe institucioneve shtetërore përkatëse të linjave, etj. Sot ka ardhur koha që çdo politikan (menaxher, vendimarrës, lidership, etj.) përpara se të ulet në karrigen e tij të pyetet cili është problemi dhe zgjidhja që pritet, si do të realizohet produkti i projektit, cili është kontributi i tij, me çfarë, kur, ku, etj., do të arrihet ky produkt dhe cilat janë vlerat e tij. Shkurt, Ai (vendimarrësi) duhet t'i përgjigjet pyetjeve që bëjnë "Baballarët e Menaxhimit". I përmendim këto sepse që nga fillimet e Demokracisë e deri më sot politika ka vepruar jashtë qarqeve

shkencore, madje duke i izoluar ato. Ky qëndrim ka qenë një humbje e madhe kombëtare, madje më e madhe se vetë rrjedhja e trurit të kombit. Por deri kur kështu? Në formimin menaxherial të një analisti, strategu, politikani, vendimarrësi (publik, jo publik), projektuesi, zbatuesi, monitoruesi, vlerësuesi është i domosdoshëm formimi i mirë në fushën e shkencës, të disiplinave njerëzore, të teknologjisë bashkëkohore të informacionit, të programimit, optimizmimit, etj. (mjaft të thuhet se në teorinë e menaxhimit gjejmë mishërim aplikativ mbi 25 disiplina matematike). Menaxhimi është zbatimi i kërkimit operacional në Praktikën Inxhinierike, Burimeve Ekonomike, Financiare, Mjedisore, etj. Ky argument bëhet aq më i mprehtë, sa më të rëndësishme të jenë burimet dhe proceset e zbatimit të tyre, shkurt sa më të mëdha të jenë vlerat e përgjithshme të burimeve që menaxhohen.

Nga sa më sipër del një pyetje: mund të jetë një objektiv për t'u realizuar bashkësia e detyrave që ngërthehen në çështjen Menaxhimi dhe Reformat për Njësinë Bazë/Departamentin? Natyrisht që kërkohet një studim i detajuar, i gatshëm për zbatim, nga një grup i posaçëm që duhet të konkretizojë nënobjektivat apo nënsistemet përkatëse në kuadrin e reformës arsimore.

Në qoftë se një punë e tillë do të niste mund të trajtoheshin ose shqyrtoheshin edhe këto aspekte:

- Burimet njerëzore (pedagogë, studentë), burimet teknologjike, burimet financiare, burimet mësi-more (tekstet, pajisjet laboratorike, procesorët, infrastruktura (bashkëlidhja e burimeve njerëzore e komunikimi i tyre), strukturat (bashkëlidhja e Departamentit) me nënstrukturat e tjera);
- Mirëkuptimet dhe mosmarrëveshjet: ç'fitojmë dhe ç'humbasim për çdo objekt burimor dhe strukturor. Cilët janë risqet dhe faktorët që i prodhojnë ato? Ç'duhet të bëjmë për përmirësimin e tyre?
- Teknologjia dhe lëndët rigoroze (dhe të tjera sipas rastit) themele të sistemit dhe nënsistemit të tij;
- Çfarë kemi, e çfarë prodhojmë dhe si do t'i optimizojmë proceset që realizojnë optimumin e përgatitjes të studentëve për formimin (eficiencën, efektivitetin, etj.) dhe sigurinë në jetë të përgatitjes së tyre.

Çështjet që mund të shqyrtoheshin në fillim mund të ishin:

- Strategjia e Departamentit (objekti-vat);
- Alternativat e strategjisë dhe kriteret përkatëse;
- Projekti i zbatimit, Rezultati, Risku;
- Marrëdhëniet institucionale të Departamentit dhe eventualisht ndryshimi i tyre duke patur parsysh burimet egzistuese dhe infrastrukturën e tij etj.

Kur bëhet fjalë për marrëdhënie mirëkuptimi dhe bashkëpunimi ato duhet

të konsiderohen institucionale dhe jo individuale, subjektive e të rastit, shkurt institucionalisht të domosdoshme për t'u realizuar. Në këtë kontekst jo vetëm Universitetet, por edhe të tjera institucione kanë shumë për të thënë kur vjen puna e këtyre marrëdhënieve me sistemin shtetëror dhe nënsistemet e tij, qofshin këto pozitive apo negative, bashkëpunimi apo "*lënë me një anë*" etj. Përmendim kalimthi që mirëkuptimi dhe bashkëpunimi është një lëmë i gjerë në fushën e optimizimit dhe më gjerë në atë të menaxhimit sepse ato ngërthejnë edhe mjaft çështje që dalin edhe jashtë institucionit tonë, por që lidhen me veprimtarinë e tij, si p.sh. mirëkuptimi institucional, mirëkuptimi dhe risku, mirëkuptimi dhe efektiviteti, mirëkuptimi dhe varfëria, bashkëpunimi, efektiviteti dhe shteti, bashkëpunimi dhe lideri, ligji i riskut për burimet natyrore dhe njerëzore, mirëkuptimi dhe komunikimi, proje-ktet dhe optimizimi, sindikata, sistemi dhe shteti, reformat specifike dhe të përgjithshme, Shkolla dhe teknologjia e informacionit, Reformat dhe strukturat, Reformat dhe burimet, Reformat dhe Teknologjia, Dija, Vendimarrja dhe Zhvillimi etj. Natyrisht që kërkohet një studim i gjerë për trajtimin e tyre, e të tjerave si këto, megjithatë, po prekim vetëm njerën prej tyre.

2. Mirëkuptimi dhe bashkëpunimi normë institucionale në optimizimin dhe vendimarrjen e strategjive dhe projekteve (të rëndësishëm)

Dihet roli dhe vendi i mirëkuptimit dhe bashkëpunimit në zhvillimin e shoqërisë njerëzore, si një nga potencialet për rritjen e performancës të zhvillimit dhe zvogëlimin e riskut, pra në optimizimin apo përcaktimin e zgjidhjeve eficiente në strategjitë dhe projektet përkatëse. Të paktën tre çmime Nobel janë dhënë në këto dekadat e fundit (duke filluar nga Nashi e deri tek Lloyd 2012) që janë dhënë në Ekonomi për lojrat matematike e zbatimet e tyre. Nga autorë të ndryshëm teoria e lojrave matematike quhet ndryshe edhe teoria e bashkëveprimit, në të cilën një vend qendror zënë lojrat kooperativiste me bazë grupi, që kanë një rëndësi të madhe në vendimarrje, jo vetëm në ekonomi (burime financiare), por edhe në sociologji, politikë, marrdhënie ndërkombëtare, etj.

Ashtu siç mund të kuptohet në lojërat kooperativiste, lojtari që luan është grupi, departamenti, universiteti, komuniteti, grupi ekonomik, politik, etj. dhe kur një grup nuk luan siç duhet vendimarrja është një risk që peshon mjaft, veçanërisht në sektorët strategjikë, energji, burime, infra-strukturë, politikë, etj. Në këtë vështrim lojërat matematike janë pjesë themelore e teorisë së optimizimit.

Në mënyrë të përmbledhur mirë-kuptimi dhe bashkëpunimi është faktor i fuqishëm potencial në optimizim dhe vendimarrje që konsiderohet nga shumë specialistë si shpirti i menaxhimit, shkurt i jetësimit të strategjive dhe projekteve. Duke hedhur një sy, jo aq racional, këtij problemi që nga fillimet e Demokracisë e deri më sot, të paktën në rang Departamenti, ka mjaft probleme që janë shprehje e një mirëkuptimi dhe bashkëpunimi që kanë

prekur, cënuar, ndoshta shpërdoruar efektivitetin e veprimtarisë së tij, madje edhe më gjerë, të paktën në domenin e optimizimit dhe të riskut. Le të shohim disa prej tyre:

- Sa strategji dhe projekte janë optimizuar në mënyrë të mirëfilltë gjatë këtyre 25 viteve, ndoshta edhe më tej, pas projektit të v.b. Gorisht, i cili u hartua në 13 variante?
- Bëhet projekti i Rrugës së Kombit, apo ai i Rrugës Tiranë-Elbasan, në të cilët të paktën optimizimi i tuneleve me metodën e elementeve të fundëm është pikë nevralgjike e projekteve dhe në këtë vështrim asgjë për profesionistët e fushës;
- Ka ndodhur që në vitet e fundit të kemi mjaft përmbytje, veçanërisht në zonën e Shkodrës, Lezhës etj., e për këto jo vetëm që nuk ka një mirëkuptim për bashkëpunim, por edhe kur ofrohet zyrtarisht ndihma e profesionistëve të fushës, nuk merret asnjë përgjigje, madje kjo ka ndodhur edhe në raste të tjera, shkurt ajo është bërë rrugë;
- Përfundojmë me Projektin TAP, pasi siç dihet në mjaft raste, për disa arsye për tubacione të fuqishëm gazi, bëhet edhe studimi i ruajtjes së gazit (injektimi i tij) në shtresa nëntokësore, çka nuk duket të jetë bërë në këtë rast.

Për këto probleme e shumë të tjera si këto, lind pyetja: a ka qenë mirëkuptimi dhe bashkëpunimi i Departamentit me Ministrinë etj., në nivelin e kërkesave të kohës? Natyrisht që jo sepse ka ngërthyer risqe, madje edhe të padukshëm, që në ndonjë rast edhe nxjerrin kokën e bëjnë "bam" siç është rasti i dëmtimeve në zonën e Zharrëzës, kur ka disertacione për deformacionet e sforcimet në burimet naftëmbajtëse si edhe për burimet minerare. Këtu ka një problem moral dhe institucional, pasi edhe ofron disa herë ndihmë "nuk begenisesh", vështirë se ta bën goja të flasësh edhe një herë për problemin që bën "bam", sepse menjëherë përgjigja do të ishte: "U lodhëm duke folur në vesh të shurdhër". Themi institucional sepse mirëkuptimi dhe bashkëpunimi jo gjithmonë është individual (Dua-s'dua, kam dëshirë-s'kam dëshirë) veçanë-risht për probleme pune e në mënyrë kategorike për ato strategjike dhe projektuese ku lëvizin "fitime" ose "dëme" të mëdha. E në këtë mënyrë mirëkuptimi dhe bashkëpunimi në rrethana të caktuara duhet institucionalizuar me ligj. Sot projektimi, optimizimi, risku, modelimi janë fronte të rëndësishme zhvillimi, ku ende jemi shumë mbrapa e kjo prapambetje fillon nga shkolla, vazhdon deri në vendimarrjet me intuitë apo vetëm me përvojën e pamjaftueshme, për më tepër që ajo nuk argumentohet fort dhe me baza teorike.

Në qoftë se pranohet ideja që vendimarrja (politika) shtetërore apo publike (jo publike) nis nga shkolla, por njëkohësisht nëse nuk ka mirëkuptim apo bashkëpunim për konsulta, ekspertiza të ligjshme dhe, pse jo, shkolla të jetë pjesë e vendimarrjes, dëmet do të jenë të pallogaritshme. Natyrisht që për këto duhet mbajtur përgjegjësi deri më një. Kjo

është një çështje thelbësore, prandaj veprimet e nevojshme për juridiksionin përkatës janë e duhet të jenë në rend të ditës, përndryshe risqet e heshtura dhe aktive do të vazhdojnë pa ju futur "ferra në këmbë" asnjërit për suksesin e duhur të projekteve, prokurimeve, reformave etj.

Menaxhimi po të kapi, të kap mirë në kohë, kur nuk të kap të izolon, madje të injoron fare, por me risk shumë të madh. Ai flet shumë sot në fushën e mirëkuptimit, bashkëpunimit për optimizimin në vendin tonë, si një kusht pa një pa dy për çdo veprimtari, veçanërisht në fushën e strategjive dhe projekteve.

3. Qendra e Menaxhimit

Në çdo veprimtari njeriu udhëhiqet nga disa qëllime, për të cilat "ndërton" alternativat për arritjen e qëllimeve dhe më pas zgjedh, mbi bazën e kritereve të caktuara, alternativën më të mirë. Në vijim të kësaj të fundit ai përpiqet ti vejë në jetë, d.m.th. të marrë rezultatin më të mirë të mundshëm dhe sa më të sigurtë. Siç vërehet, dy janë veprimtaritë themelore për realizimin e qëllimit (qëllimeve):

- Hartimi (ndërtimi) i alternativave ose varianteve, d.m.th. strategjia;
- Përzgjedhja e alternativës më të mirë, d.m.th. projekti dhe;
- Zbatimi i projektit në praktikë që përfundon me realizimin e outputit (rezultatit).

Nga kjo pikëpamje uniteti i strategjisë dhe i projektit quhet menaxhim, pak më ndryshe menaxhimi është veprimtaria (mendore, fizike) për realizimin e qëllimit, d.m.th. përftimin e rezultatit të tij. Në këtë kontekst strategjia dhe projekti janë kushte të domosdoshëm për realizimin e çdo qëllimi: shoqëri, politik, ekonomik, industrial, bujqësor, mjedisor, etj. Meqenëse çdo qëllim i realizuar supozohet "ndryshim pozitiv" atëherë ai është faktor zhvillimi, apo e thënë pak më ndryshe vendimarrja për strategjinë ose edhe projektin përkatës është kusht i domosdoshëm zhvillimi - nuk ka zhvillim "*të mirëfilltë*" pa projekt.

Që këtej lind nevoja e projektizimit (e zhvillimit mbi bazë projektesh) të shoqërisë. Theksojmë që këtu është fjalë "e mirëfilltë" ka kuptimin "më të mirë ose eficiente", ose në një kuptim më rigoroz "afërsisht optimale e sigurtë". Nga sa më sipër del që kur në një periudhë kohe nuk është arritur pritja e planifikuar e zhvillimit, ai duhet kërkuar në një nga komponentët kryesorë të tij, d.m.th. tek strategjia ose tek projekti, ose së bashku tek të dy komponentët e tij.

Në qoftë se për konkretizim, analizojmë zhvillimin e vendit që nga koha e Zogut e deri më sot dhe na rezulton që ky zhvillim i arritur nuk ka qenë në pritjen e parashikuar, atëherë mos zhvillimi i duhur (Risku) ka patur dy faktorë mjedisorë të mundshëm - strategjinë dhe projektin. Meqënëse ose çdonjëri prej këtyre janë objekte të krijuara nga njeriu, del që ky i fundit është njëherësh subjekt dhe objekt

i riskut, d.m.th. vendimarrja e tij nuk ka qenë në nivelin e dijeve të kërkuara.

Që këtej mund të ngrihet një pyetje e çuditshme: kemi shumë veprimtari shoqërore, individuale, kolektive, komunitare, etj., që nuk kanë patur projekt të mirëfilltë, e megjithatë ato kanë dhënë "zhvillim". Kësisoj pse duhet që projektin ta konsiderojmë kusht të nevojshëm zhvillimi?

- ***Së pari***, çdo njeri, në rrethana të caktuara, realizon qëllimin e tij pa patur një projekt "të shkruar" në letër, megjithatë në mendjen e tij e ka të "skalitur" projektin që do të zbatojë, me të gjitha projektet që bëjnë "Baballarët e Menaxhimit". Çfarë është kjo veprimtari, Pse bëhet, Si bëhet, Kur bëhet, Ku bëhet, Me çfarë bëhet, Sa kushton, Sa efektive është, Sa e sigurtë është, etj. Kësisoj kur veprimtaria është e thjeshtë dhe përgjigjet e këtyre pyetjeve nuk kërkojnë ndonjë racionalitet apo argumentim të domosdoshëm, njeriu me këto e krijon veprimtarinë "përmendësh" pa qenë nevoja për partiturën e kompozimit të tij, pra për projekt të një veprimtarie;
- ***Së dyti***, kur bëjmë fjalë për projekt, nënkuptojmë me marrëveshje një aktivitet që realizohet nga shumë individë për rrjedhim nuk është e thjeshtë, ka komplekse dhe si e tillë ajo, domosdoshmërisht, duhet hedhur në letër e që shkencërisht përmban përgjigjet e të gjitha pyetjeve që i bëjnë Baballarët e Menaxhimit, e ndër këto sa i mirë është produkti (outputi) i projektit apo sa eficient, apo sa efektiv, apo sa optimal dhe sa i sigurtë është produkti në fjalë.

Tani kur produkti në fjalë nuk realizohet do të thotë që projekti nuk ka qenë "në rregull" për një ose disa shkaqe që kanë të bëjnë me:

- Shtrimin e problemit;
- Të dhënat e problemit;
- Metodën e zgjidhjes, etj.

Ose "projekti" është mbështetur më shumë në përvojë, intuitë, perceptim pa argumentim të shëndosh teorik. Kuptohet që në rastin e fundit Risku është i pritshëm dhe pothuajse i sigurtë. Që këtej kuptohet që projekti (sistemi) është kusht i domosdoshëm i zhvillimit të shoqërisë, është format themelor dhe i patjetërsueshëm.

4. Departamenti i Menaxhimit Praktika e deritanishme në fushën e menaxhimit ka treguar që:

- Në planin universitar, në përgjithësi nuk kemi të përgatitur menaxherë me formim solid, për rrjedhim ekonomia është drejtuar kryesisht nga specialistë me përvojë praktike;
- Opsioni universitar në Fakultetin Gjeologji-Miniera, viti 2000-2008 nuk ka qenë përgjithësisht i suksesshëm dhe ka patur disa anë negative: përgatitje e dobët fillestare e studentëve, kualifikim i kuadrit, infrastruktura, kurikulat, projektet, diplomat, burimet financiare etj;

– Tregu ka kërkesa të larta për specialistë, menaxherë në shumë struktura të qeverisjes, qendrore, lokale, publike, veçanërisht në projekte, e-projekte, strategjinë kombëtare, projektizimin, e sistematizimin kombëtarë, reformat e ndryshme dhe veçanërisht për reformën e përgjithshme GO TO GROWTH ku vihet re një prapambetje e madhe relative e vendit tonë, veçanërisht në zhvillimin afatmesëm e afatgjatë, sepse ritmet drejt projektizimit e sistematizimit, integrimit dhe globalizimit të ekonomisë sipas shumë gjasave do të vijnë duke e përshpejtuar me kalimin e kohës, veçanërisht nga zhvillimi spektakolar i teknologjisë së informacionit, të inteligjencës etj;

– Është rritur shumë numri i institucioneve universitare për përgatitjen e mena-xherëve jashtë shtetit, madje për disa prej tyre ka mjaft kërkesa nga studentët. Përmendim kalimthi që kualifikimi i menaxherëve jashtë shtetit është i kushtueshëm, madje edhe për periudha të shkurtra (2 javë 3000 USD në Boston, 10 ditë – 3000 paund në UK etj).

Nga sa më sipër del e domosdoshme që të merren masat e duhura për përgatitjen universitare të mena-xherëve në Fakultetin e Gjeologjisë ose në përgjithësi në Universitetin Politeknik me kurrikula të ndara ose jo të ndara me pjesëmarrjen e një ose disa fakulteteve nga Universiteti Politeknik dhe jashtë tij.

5. Instituti i Menaxhimit Duke patur parasysh:

– Vendin dhe rolin e menaxhimit dhe të studimeve përkatëse në zhvillimin kombëtar (strategji, sisteme, proje-kte, reforma, arsim, teknologji, burime, energji, mbrojtje mjedisi në shumë sektorë strategjikë);

– Nevojën për një zbatim sa më efektiv të tij duke përdorur teknologjitë bashkëkohore si teknologji informa-cioni, komunikimi, rrjete infor-matike, intelegjencë artificiale etj.

– Standardet, normat dhe strategjitë e komunitetit ndërkombëtar veçanë-risht në fushën e reformave dhe të tekonologjisë dixhitale deri në vitin 2030;

– Rolin e metodave të ndryshme që gjejnë zbatim të qenësishem e efektiv në mënyrë të veçantë ato matematike, informatike, të struktu-rave bazave të megabazave të informacionit, teorinë e sistemeve, kategorive, teorinë e vendimmarrjes, riskut;

– Standardet që kërkon koha dhe veçanerisht ato të BE, ku vendi ynë aspiron për një anëtarësim sa më të shpejtë.

Del nevoja e krijimit të Institutit të Menaxhimit.

Kjo është një domosdoshmëri kombëtare duke patur parasysh që vendi ynë ka një prapambetje relativisht të madhe, madje dhe rolin e projektizimit, të menaxhimit, modelimit, optimizimit, riskut për

zhvillimin e vendi duke patur parasysh shumë faktorë si:

- Strategjia kombëtare, projektizimi, e-projektet, pasuria dhe asetet kombëtare, kontratat e rëndësishme;
- Reformat, në mënyrë të veçantë GO TO GROWTH, bazat e mega bazat e të dhënave, strategjitë e energjisë, ICT, mbrojtjes së mjedisit etj.;
- Strategjitë e rotacioneve politike, ato të marëdhënieve me të tjerët;
- Reformat e ndryshimet graduale në qeverisje e politikë, vendimarrje;
- Prapambetje e madhe në teknologjinë e informacionit (përvoja në programim).

Në fund investimi në menaxhim është nga më të rëndësishmit jo vetëm në fushën e arsimit por edhe me gjerë në diagnostikimin, vlerësimin efektiv të burimeve, teknologjive, në projekte, qeverisje, mjedis, politikë etj.

6. Projektizimi

Lind pyetja? Ç'mund të thuhet për zhvillimin e vendit tonë mbi bazë projektesh? Natyrisht që për këtë duhet një studim i mirëfilltë e në mënyrë të veçantë për sektorë strategjikë si Arsimi, Ekonomia, Energjia, Industria, Bujqësia, Turizmi, Infrastruktura, Komunikimi, etj. Pa u futur në detaje, projekti nuk është normë standarte e aq më pak e institucionalizuar e zhvillimit tonë shoqëror, p.sh. konkretisht cilët janë projektet e zhvillimit të Fakultetit, po të Departamenteve të tij, etj. Sa i përgjigjen ato kërkesave (pyetjeve) të Baballarëve të Menaxhimit, po rezultatet e monitorimit të tyre çfarë tregojnë, sa të sigurtë janë rezultatet e parashikuara në to? Të marrim në konsideratë e të analizojmë vetëm riskun në procesin mësimor e dijet për të. Pa u futur në detaje kemi pothuajse pak ose aspak disiplina mësimore për riskun, shkurt kemi një proces mësimor pothuajse deterministik. Kësisoj në qoftë se shteti fillon me funksionin, e ky me shkollën, kuptohet se si mund të jetë gjendja e projekteve të institucioneve shtetërore për riskun e parashikimin e tij. Pa u zgjatur kemi shumë punë për të bërë për projektizimin e aktivitetit tonë universitar, në mësim, studim, kërkim, e mbi të gjitha në reformën arsimore që na pret, veçanërisht për grumbullimin e informacionit dhe përpunimin e tij, studimet për strategjitë, projektet, strukturën, objektet, teknologjitë e burimet e informacionit, financiare, etj. e mbi të gjitha për burimet njerëzore, përgatitjen e kualifikimin e tyre, etj. Nga sa më sipër del nevoja e projektizimit në Universitetin Politeknik në shumë nënsisteme të tij.

7. Studime strategjike

Thuajse çdo departament në Politeknik mbulon në përgjithësi një sektor të rëndësishëm zhvillimi të vendit tonë energji, industri, miniera, mekanik, ndërtim, elektronikë, teknologji informacioni etj. Këto sektorë zhvillohen mbi bazën e strategjive e projekteve përkatëse. Në kushtet kur në kuptimin e mirëfilltë duhet një strategji shkencore përkatëse, Departamentet janë institucionet nga ku mund e duhet të nisë

puna për to, ato duhet të jenë furnizuesit kryesorë për hartimin e strategjive të zhvillimit në sektorët përkatës. Në rrethanat konkrete kur mungon pothuajse tërësisht një bashkëpunimi dhe bashkëveprimi i Departamenteve me Dikasteret përkatëse e aq më pak kur ai nuk është i institucionalizuar, risqet që burojnë nga mos egzistenca e strukturave bashkëpunuese janë të një rendi "dëmi" të konsiderueshëm, kur në vendin tonë nuk egzistojnë institutet përkatëse studimore shkencore. Është e kuptueshme që detyrat studimore e shkencore nuk mund t'i mbulojë dikasteri përkatës.

8. Strukturimi

Shumë nga reformat e kryera në vendin tonë nuk janë kryer mbi bazën e studimeve të plota paraprake, apo në një numër alternativash e variantesh etj. Shpesh herë ato kanë qenë veprimtari me karakter organizativ, empirik, me bazë përvoje, analogjie, intuite dhe jo të mbështetura mbi studime fizibiliteti, skema e paraprojekte, me të dhënat e informacionet e duhura etj. Po kështu ato i janë referuar më shumë përmbajtjes së objekteve të tyre se sa bashkëlidhjes (strukturimet) së tyre. Në këtë kontekst strukturimi i vendit mbi bazë institucionesh nuk është një problem i mbyllur dhe i ezauruar, përkundrazi ai është i hapur dhe ka nevojë për studime të thelluara veçanërisht për struktura më të përgjithshme, kompakte që çojnë në optimizimin e burimeve në përgjithësi dhe atyre njerëzore në veçanti, në dikastere, qarqe, bashki, etj. Në këtë këndvështrim studimi i strukturave egzistuese dhe i marrëdhënieve të tyre institucionale për modernizimin dhe efektivitetin e tyre mendojmë se është një problem, jo vetëm i reformave specifike, por edhe asaj të zhvillimit të vendit në përgjithësi që sot në mjaft vende të tjera kanë filluar e që njihen me emrin GO TO GROWTH.

9. Metrologjia, Burimet e Informacionit, Teknologjia

Në hartimin, zbatimin dhe realizimin e projekteve tona një vend rol të dorës së parë kanë burimet e të dhënave e të informacionit në përgjithësi. Siç dihet cilësia e projekteve tona të studimeve dhe pse jo edhe të doktoraturës në mjaft raste lënë për të dëshiruar nga mungesa e të dhënave të plota e jo të sakta. Natyrisht kjo është një sëmundje jo vetëm për universitetet, por edhe për shumë institucione që i kanë rrenjët në mungesën e teknologjive e metodave të përparuara të matjeve (metrologjisë). Na ka rënë rasti të vizitojmë Universitete jashtë vendit dhe jo pak herë kemi vënë re të shkruara me gërma të mëdha *"E dhëna është Informacion", "Informacioni është Dije", "Dija është Fuqi"* dhe, në fund, shtojmë për studentët që *"Fuqia është Para".* Në këtë vështim, investimi për sigurimin e të dhënave (metrologjia), metodikave të përpunimit të tyre si dhe teknologjive përkatëse të informacionit është një nga detyrat më të rëndësishme për të kapur kohën e humbur në zhvillimin e shpejtë të Universiteteve. Çështjet e mësipërme dhe shumë të tjera si këto mund e duhet të jenë objekte studimi në

të ardhmen, në kuadrin e krijimit të institucioneve të reja të menaxhimit e në mënyrë të veçantë të Qendrës së Menaxhimit. Pavarësisht nga vendi dhe roli i tyre, zhvillimi i vendit mbi bazë projektesh shkencore, në çdo fushë e sektor, është domosdoshmëri e për këtë qëllim duhen marrë të gjitha masat e duhen bërë të gjitha investimet e nevojshme e aq më shumë, në prag të antarësimit të vendit në B.E., ku të gjitha bashkëpunimet bëhen mbi bazë të Projekteve (Sistemeve). Ndoshta ka ardhur koha që të mos lejohet vendimarrja për veprimtaritë që nuk paraqiten në trajtë projektesh të burimeve të ndryshme njerëzore apo natyrore, veçanërisht në sektorët strategjikë e në nivele të larta hierarkie dhe, brenda një kohe relativisht të shkurtër, vendimarrja të bëhet vetëm për veprimtari që paraqiten me projekte.

10. Përfundime

- Loja e bashkëpunimit, kriter i rëndësishëm zhvillimi;
- Mirëkuptimi dhe bashkëpunimi, baza e optimizimit të strategjive;
- Loja e kontradiktës rrit riskun e proceseve dhe ngadalëson ritmet e zhvillimit;
- Mund të eksperimentohet optimizmi i prokurimit të projekteve sipas propozimeve nga tre njësi administrative ose bashki.

Literatura

1) M. Ehrgott, 2005, *Multicriteria Optimisation*, Springer, Second Edition;

2) L.S. Shapley, 1953, A value for n-person game, Princeton University;

3) R. Serrano, 2007, Cooperative game: Core and Shapley Value, Springer;

4) V. Conitzer, 2012, Computing game – theoretical solutions and aplication to security;

5) J.F. Nash, 1953, Two persons cooperative game, Econometric 21;

6) V. Neumann, and V. Morgenestern, Theory and games and economic behaviour, Princeton University;

7) R.J. Aumman, 1987, Game Theory, Norton, New York, Harvard University, USA;

8) R.B. Mayerson, 1991, Game Theory, an analysis on conflicts;

9) S. Osmani, B. Leskaj, 2016, Performanca, sistemi, risku dhe vendimarrja fazi në grup me shumë kritere. Analiza e riskut, Konferenca e IV Shkencore, Revista Auditimi Publik, Nr.10;

10) S. Osmani, B. Leskaj, 2015, Vendimarrja dhe teknologjia inteligjente, Revista Auditimi Publik, Nr. 10;

11) B. Leskaj, 2013, Mirëqeverisja, paradigma e re në Administratën Publike, Revista Auditimi Publik, Nr. 5;

12) S. Osmani, Optimizimi, Programimi linear me zgjerime;

13) S. Osmani, 2017 (Përgatitur për botim), Optimizimi me shumë kritere;

14) S. Osmani, 2004, Metodat matematikkore në menaxhim.

Nga: Dr.Bujar Leskaj, Prof.Dr.Skënder Osmani, Prof.Asoc.Dr.Nevton Kodhelaj

ASPEKTE TEORIKO-PRAKTIKE NË MENAXHIMIN E RISQEVE DHE SHANSEVE

Në të gjitha fushat e aktivitetit njerëzor ekziston problemi i realizimit të objektivave të përcaktuara në linja projektesh me fillesë mbledhjen, përkatësisht krijimin e informacionit, administrimin, përpunimin, analizën e modelimin e tij për të ekspozuar më së fundi vlerat e përdorimit.

Nga: Prof. Dr. Gafur Muka & Prof.Dr.Thoma Korini, Fakulteti Gjeologjisë dhe Minierave, Universiteti Politeknik i Tiranës

Abstrakt

Në të gjitha fushat e aktivitetit njerëzor ekziston problemi i realizimit të objektivave të përcaktuara në linja projektesh me fillesë mbledhjen, përkatësisht krijimin e informacionit, administrimin, përpunimin, analizën e modelimin e tij për të ekspozuar më së fundi vlerat e përdorimit. Për një shqyrtim të standardizuar të vlerave të këtyre projekteve rekomandohet analiza e pikave të forta, pikave të dobëta, shanseve dhe risqeve (SWOT). Pra analiza SWOT konsideron në mënyrë të veçantë edhe shanset (opportunities) dhe risqet (threats). Ky konsiderim lidhet jo vetëm me njohjen dhe vlerësimin e tyre por edhe me menaxhimin, d.m.th. me atë sistem që përfshin të gjitha proceset projektuese e organizative për të identifikuar paraprakisht risqet në mënyrë që të ndërmerren sa më shpejt masa për zvogëlimin apo mënjanimin e tyre si dhe njohjen paraprake e realizimin në kohë të shanseve. Në literaturë ka plot raste kur risqet dhe shanset shihen si elementë të njëjtë por me kahje të ndryshme. Kjo ka çuar në atë që edhe rezultatet në menaxhimin e tyre të mos kishin vlerën e pritshmërisë së tyre. Në këtë material trajtohen disa aspekte teoriko-praktike lidhur me natyrën dhe karakteristikat e ndryshme të shanseve dhe risqeve si dhe marrjen parasysh të tyre në sistemet e menaxhimit.

1. Formulime konceptuale

Menaxhimi i risqeve dhe shanseve lidhet në rradhë të parë me një konceptim sa më të drejtë të tyre. Për ta arritur këtë duhet, që edhe risqet por edhe shanset të

shqyrtohen në kontekstin e fushës së referimit [1]. Parë kështu, dallohen formulimet për to në fushën e matematikës, teorisë së vendimmarrjes, psikologjisë, shkencave inxhinierike dhe atyre ambientale, shëndetësisë, ekonomisë etj. Sidoqoftë në të gjitha këto formulime krahas specifikave ekziston dhe ajo që është e njëjtë. Si e tillë konsiderohet mundësia e shfaqjes së riskut kur kemi ndodhje të bashkë-vendosur të rrezikimit (realizimi në kohë dhe hapësirë i rrezikut), ekspozimit (praninë e objektivave që dëmtohen) dhe vulnerabilitetit (masën e ndjeshmërisë së objektivave të ekspozuar ndaj dëmtimit). Pikërisht probabiliteti i ndodhjes së kësaj ngjarjeje quhet risk [4]. Përsa i përket shansit, po t'i referohemi kuptimit statistikë të tij, ai shihet si probabiliteti i ndodhjes së një ngjarje të favorshme [3]. Në këtë trajtesë ne interesohemi për lidhjen që ekziston midis riskut dhe shanseve për të realizuar menaxhimin e tyre në interes të zvogëlimit apo mënjanimit të dëmtimit (mosrealizimit) të objektivave në kushtet e shkallës së ndryshme të rrezikimit të tyre. Për të kuptuar dallimet midis tyre ekziston një numër i madh kriteresh. Në tabelën e mëposhtme [6] paraqiten disa kritere dallimi dhe cilësitë respektive të risqeve dhe shanseve.

Nisur nga kriteri i fundit, pra ndërveprimi ose ndërvarësia midis risqeve dhe shanseve përftohet vetëdija, që risqet gjithmonë fshehin shanse, ndërkohë që edhe shanset vetë përmbajnë risqe, kështu që realizimi i shanseve nuk mund të jetë i suksesshëm pa vlerësimin e riskut.

Për të realizuar një proces sa më të suksesshëm në menaxhimin e shanseve dhe risqeve rekomandohet ndërmarrja e katër hapave të mëposhtëm [5, 7]:

- Identifikimi
- Vlerësimi
- Administrimi (masat e trajtimit)
- Monitorimi dhe raportimi (fig. 1)

Tabela 1. Kritere dallimi dhe cilësitë respektive të risqeve dhe shanseve [6]

Kriteri dallimit	Cilësitë e risqeve	Cilësitë e shanseve
Probabiliteti i shfaqjes	Risqet kanë cilësinë e padëshirueshme të përsëritjes. Prandaj ka kuptim që për to të shqyrtohet probabiliteti i shfaqjes.	Shanset shpesh kanë cilësinë të jenë të njëhershëm dhe të vështirë për t'u njohur, më së shumti ekspozojnë një "vlerë në kohë" me tendencë rënieje dhe mund të realizohen vetëm në një periudhë kohe të dhënë. Prandaj thuhet që shansi humbet. Kush

		vjen vonë atë e dënon koha.
Vetëdija/perceptimi	Risqet mund të shfaqen pavarësisht nëse ne jemi apo jo të vetëdijshëm për to.	Shanset mund të shfrytëzohen vetëm kur ne jemi të vetëdijshëm për to.
Mundësia e ndërhyrjes	Referuar ekspozimit ndaj risqeve nuk ka zgjedhje. Në shumë raste risku vetëm mund të reduktohet. Një pjesë e riskut mbetet dhe, mundësia e tij për t'u përsëritur, nuk mund të pengohet.	Njeriu është i lirë për të marrë vendimin nëse ai do të përpiqet për të shfrytëzuar shansin. Menaxhimi i shanseve ka natyrë strategjike. Synohet në atë që të përcaktohet mënyra e veprimit dhe të merret vendimi sipas situatës. Këtu shtrohet pyetja: "çfarë duhet të arrihet në të ardhmen". Mundësia/ aftësia për të realizuar një shans, në princip nuk jepet. Prandaj realizimi i shanseve mbart risk.
Trajtimi	Trajtimi i risqeve: • Një risk mund të mënjanohet plotësisht • Mund të reduktohet probabiliteti i shfaqjes së një risku • Mund të reduktohet masa e pritshme e dëmit të një risku • Risqet mund të pranohen	Trajtimi i shanseve: • Një shans mund të realizohet plotësisht • Probabiliteti i realizimit të një shansi mund të rritet • Një shans mund të realizohet pjesërisht • Shanset mund të injorohen.
Ndërveprimi: Shanse/risqe	Risqet fshehin shanse	Shanset përmbajnë risqe. Pa vlerësim të risqeve nuk mund të realizohen shanset



Fig. 1. Skemë procedurale menaxhimi për risqet dhe shanset [7]

1.1 Identifikimi i risqeve dhe shanseve

Identifikimi i risqeve përfshin gjetjen dhe grumbullimin e të gjitha risqeve që kanë ndikim në aktivitetin e një sipërmarrjeje. Ai përbën fazën e parë dhe më të rëndësishme proceduriale të menaxhimit dhe realizohet me anë të metodave për identifikimin e risqeve. Qëllimi i identifikimit është të kapë dhe të evidentojë në mënyrë të plotë dhe të vazhdueshme të gjitha burimet e risqeve të sipërmarrjes si dhe sektorëve të punës së saj. Vetë metodat synojnë që identifikimi të jetë një proces sistematik, me procedim të strukturuar, me kapje si të risqeve të brendshëm ashtu edhe atyre të jashtëm, me objektiv krijimin e një profili risku që merr në konsideratë specifikat sektoriale si dhe sigurimin e monitorimit të vazhdueshëm të tyre [2].

Disa nga metodat të identifikimit të riskut janë:

1. me anë të inspektimeve në objektet e rrezikuar;
2. me anë të anketimit të ekspertëve dhe bashkëpunëtorëve (i hapur, i mbyllur, intervistim);
3. nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit ekzistues (Financa, Auditimi);
4. nëpërmjet ekspozimit dhe shqyrtimit të arsyetimeve (Brainstroming);
5. nëpërmjet protokollimit të arsyetimeve (Brainwriting);
6. duke u mbështetur tek konsiderimi i faktorëve të shpërfillur apo dytësorë (Synectics);
7. nëpërmjet shqyrtimit të të gjitha hallkave të prodhimit (Value Chain);
8. nëpërmjet shqyrtimit të zgjedhjeve specifike të hallkave me ndikim më të madh në proces, kontrolli dhe verifikimi i saktësisë së tyre;
9. nëpërmjet shqyrtimit të informacioneve të sistemeve të paralajmërimit;
10. Nëpërmjet gjykimit të listave të çekuara (Checklist).

Në të gjitha këto metoda identifikohen edhe shanset, të cilët natyrisht kanë vartësi shkakore prej risqeve.

2.1 Vlerësimi i shanseve dhe risqeve

Për të vlerësuar shanset dhe risqet merren në konsideratë shpeshtësia e shfaqjes dhe vlera e dëmit (për riskun) dhe shpeshtësia e ndodhjes së përfitimit dhe potenciali i ndikimit (për shansin). Këta faktorë varen nga fusha e aktivitetit

si dhe përvoja e ekspertëve të vlerësimit. Në këtë kuptim vlerësimi i shanseve dhe risqeve shihet si një detyrë e çdo sipërmarrjeje. Në diagramet e vlerësimit (fig 2, 3) tregohen respektivisht lidhja e shpeshtësisë së shfaqjes së riskut me vlerën e dëmit (fig 2) dhe lidhja e shpeshtësisë së ndodhjes së përfitimit me potencialin e saj për shansin. Siç shihet në figurën 2, risku klasifikohet në 5 klasa (shumë i lartë, i lartë, mesatar, i dobët dhe shumë i dobët me indeksimin përkatës 1, 2, 3, 4, 5), ndërkohë që mundësia e shfaqjes dhe vlera e dëmit janë grupuar me nga 4 vlerësime. Në figurën 3, shihet që shansi indeksohet me yje, dallimi midis të cilëve realizohet nëpërmjet ngjyrës, përkatësisht-shumë i mirë (3 yje me një ngjyrë), i mirë (2 yje me të njëjtën ngjyrë dhe një me ngjyrë tjetër), mesatar (një yll me ngjyrën e parë dhe 2 me ngjyrën e dytë) dhe pa shans (të tre yjet me ngjyrën e dytë).

Fig. 2. Lidhja e shpeshtësisë së shfaqjes së riskut me vlerën e dëmit. Ndikimi i riskut është vlerësuar me 5 klasa [6].

Vlera e dëmit				
Shumë e lartë (>150 000 Euro)	1	2	3	3
E lartë (50 000-150 000)	2	2	3	4
E vogël (10 000-50 000)	3	3	4	4
E papërfillshme (<10 000)	4	4	5	5
	Sh. Shpesh (< 1 vit)	Shpesh (2 - 5 vjet)	Rrallë (5 - 10 vjet)	Sh. Rrallë (> 10 vjet)
Shpeshtësia e shfaqjes së dëmit - ndodh mesatarisht 1 herë në –x- vjet				

Fig .3. Lidhja midis shpeshtësisë së përfitimit nga shanset dhe potencialit të përfitimit. Dobia e shansit jepet me tre yje.[6]

Potenciali (vlera e përfitimit)				
Shumë i lartë (>150 000 Euro)	★★★	★★★	★★★	
I lartë (50 000-150 000)	★★☆	★★★	★★★	
I vogël (10 000-50 000)	★☆☆	★☆☆	★☆☆	
Nuk ekziston				
	Sh. Shpesh (< 1 vit)	Shpesh (2 - 5 vjet)	Rrallë (5 - 10 vjet)	Sh. Rrallë (> 10 vjet)
Shpeshtësia e ndodhjes së përfitimit (përdorimit) të shansit - ndodh mesatarisht 1 herë në –x- vjet				

Për klasifikimin e shanseve dhe risqeve rekomandohen disa metoda [7], të cilat marrin në konsideratë:

- Referimin e situatës së treguesve financiarë aktivë ndaj tre pozicioneve, rastit më të pëlqyeshëm (Most Like Case, MLC), rastit më të keq (Worse Case, WC) dhe rastit më të mirë (Best Case. BC) (fig. 4,a);
- Referimin e situatës së treguesve financiarë aktivë ndaj atyre të planifikuar (fig 4,b).
- Vlerësimin me anën e një skeme bazuar në fitimin dhe humbjet (fig. 4,c);
- Integrimin e tyre në skemën e rezultateve financiare si EBIT (të ardhurat para përfshirjes së interesit bankar dhe ngarkesës fiskale-Earnings Before Interest, Tax) ose fitimin neto (fitimi bruto minus shpenzimet operative minus shpenzimet bankare minus taksat) si dhe në tregues të tillë si vlera e shtuar ekonomike
- (Economic Value Added) dhe vlera e shtuar në kesh (Cash Value Added) (fig. 4,d).

Të gjitha këto metoda i konsiderojnë shanset dhe risqet si elementë që kushtëzojnë njeri tjetrin në aktivitetin e çdo sipërmarrjeje (fig. 5), ndërkohë që probabiliteti i shfaqjes së tyre lidhet me ndikimin mbi tregues të tillë si EBIT, fitimi neto, EVA, CVA (fig 6).



Fig. 4. Paraqitje skematike e metodave të vlerësimit të shanseve dhe risqeve [7]



Fig. 5,6. Konceptimi i shanseve dhe risqeve mbështetur në shpërndarjen dhe probabiliteti i shfaqjes si raste ndikimi mbi treguesit financiarë. [7]

3.1 Administrimi i shanseve dhe risqeve

Në linjën e procedimit për menaxhimin e shanseve dhe risqeve, administrimi përfshin tërësinë e masave që synojnë [8]:

- Shmangien e riskut;
- Zvogëlimin (reduktimin) e riskut;
- Transferimin e riskut;
- Pranimin e riskut;

- Zbulimin (njohjen) dhe përdorimin e shanseve.

Shmangja e riskut zbatohet në ato raste kur nga identifikimi dhe vlerësimi i tij konstatohet që vlera e dëmit është aq e madhe sa është më mirë të ndërpritet aktiviteti që mbart riskun. Nga analiza e shanseve ka dalë gjithashtu që nuk ekziston asnjë shans, potenciali i të cilit ta tejkalojë vlerën e dëmit. Si shembull për këtë mund të përmendet shfrytëzimi i pasurive nëntokësore poshtë objekteve me vlerë që e kapërcejnë vlerën që do të sillte shfrytëzimi i mineralit. Në këtë rast minerali do lihej si kolonë mbrojtëse për objektin, përkatësisht objektet.

Zvogëlimi (reduktimi) i riskut përfshin të gjitha masat për reduktimin e tij deri në atë masë sa, krahasuar me potencialin e shanseve, vlera e dëmit bëhet më e vogël. P.sh. gjatë shfrytëzimit nëntokësor të mineraleve madhësia e dëmit në kushtet e shfaqjes së riskut mbetet më e vogël se sa vlera e riparimit të objekteve. Në këtë rast si shans duhet konsideruar mundësia e riparimit të objekteve duke mundësuar mos ndërprerjen e funksionimit të tyre.

Transferimi i riskut. Ky është kryesisht rasti i siguracioneve. Në këto kushte risku merret përsipër nga shoqëritë e sigurimeve. Edhe kontratat koncensionare mund të konsiderohen si raste të transferimit të riskut tek të tretët pasi, në kushtet e pamundësisë së përdorimit të resurseve, dëmtohet zhvillimi ekonomik e social i vendit. Vetë kontratat duhet të vlerësohen si shanse për zvogëlimin e dëmeve që vijnë nga mungesa e përdorimit të vlerave të resurseve.

Pranimi i riskut përdoret si masë administrimi në të gjitha rastet kur dëmet që vijnë nga ndodhja e tij janë të papërfillshme ose në vlera të tilla që nuk pengojnë funksionimin e aktivitetit (aktiviteteve). Kështu p.sh. në qoftë se gjatë shfrytëzimit të mineraleve vlera e dëmeve është brenda deformimeve të lejuara, apo dëmtohen vetëm pak objekte, riparimi i të cilëve nuk përbën problem, atëherë jemi në kushtet e pranimit të riskut.

Të gjitha masat e përmendura lidhen me një stad aktual të identifikimit dhe vlerësimit të risqeve dhe shanseve. Por këto fenomene janë dinamike. Ato zhvillohen si në kohë ashtu edhe në hapësirë duke induktuar masa të ndryshme dëmtimi dhe potenciale të ndryshëm përfitimi. Pranuar kështu, lind nevoja e monitorimit të tyre në mënyrë që të ruhet koherenca në përdorimin e sistemit (sistemeve) të menaxhimit. Prandaj këto sisteme përmbajnë edhe monitorimin si një fazë, nga njëra anë përmbyllëse e një procedure dhe, nga ana tjetër prodhuese e një cikli të ri procedural për menaxhimin.

1.4 Monitorimi i shanseve dhe risqeve

Ky proces përfshin tërësinë e masave për vëzhgimin dhe raportimin e ndryshimeve në zhvillimin e risqeve dhe shanseve. Në përgjithësi nevoja për monitorimin lidhet me disa faktorë nga të cilët përmendim [7]:

- Pamundësinë e identifikimit dhe vlerësimit shterues të risqeve dhe shanseve. Kjo edhe për faktin se metodat e trajtuara përmbajnë gjithsesi një dozë të caktuar subjektivizmi;
- Risqet nuk lidhen vetëm me faktorë të brendshëm. Ata lindin edhe për shkak të veprimit të faktorëve të jashtëm, ndikimi i të cilëve duhet konsideruar në mënyrë të vazhdueshme. P.sh. në qoftë se blerësit ofrojnë çmime më të ulëta për shitjet atëherë krijohet një situatë që mund të çojë deri në bllokimin e shitjeve. Identifikimi në kohë i këtij risku kërkon monitorim të pandërprerë të konjukturës së tregjeve dhe gjetjen e një shansi të ri për ç'bllokimin e situatës;
- Ndryshimi i detyruar i situatës së aktivitetit për shkak të ndryshimit të kuadrit ligjor ose futjes së teknologjive të reja. Në këto kushte duhen konsideruar ndryshime në sistemin e menaxhimit të risqeve dhe shanseve pasi ndikimi i tyre lidhet jo vetëm me rezultate të tjera nga ato të situatës së mëparshme por edhe me domosdoshmërinë për rishikim të disa treguesve si p.sh. planit të investimeve, masës së shpenzimeve etj;
- Monitorimi i risqeve dhe shanseve ka edhe funksion kontrolli për sistemin e përdorur të menaxhimit.

2. Përdorimi praktik i një sistemi menaxhimi me hartografim të shanseve dhe risqeve

Siç është trajtuar më sipër, procesi i menaxhimit kalon nëpër të katër fazat respektive. Ai është specifik sepse lidhet me veçoritë e fushave të aktivitetit të sipërmarrjes. Në përpjekjen për ta dokumentuar në mënyrë sa më funksionale këtë proces dhe për të lehtësuar përshtatjen sipas fushave të aktivitetit është futur koncepti i hartografimit të shanseve dhe risqeve [4, 6]. Ky koncept lidhet me mundësinë e vizualizimit si të masës së dëmit nga ndodhja e riskut ashtu edhe të potencialit të përfitimit nga realizimi i shansit. Për ta konkretizuar këtë procedurë po marrim shembullin e mëposhtëm.

Zgjedhim si fusha interesimi dy aktivitete të një sipërmarrjeje: **investimet** dhe ***shitjet***.

Në procesin e identifikimit të riskut është konkluduar që për fushën e parë risku lind nga *mosrealizimi i investimeve për blerjen e pajisjeve që sjellin përmirësime në teknologjinë e prodhimit* ndërsa për fushën e dytë nga *mosrealizimi i të ardhurave të planifikuara nga shitjet.* Si shanse për rastin e parë shihet *gjetja e tregjeve më të favorshme për blerjen*, për rastin e dytë *gjetja e tregjeve më të favorshme për shitjen*. Në fazën e vlerësimit secili nga risqet identifikohet me 5 tregues (1 deri 5) ndërkohë që probabiliteti i shfaqjes dhe vlera e dëmit klasifikohen në 4 klasa respektivisht:

- Për probabilitetin e shfaqjes në kohë të riskut (1 herë në - x vjet): shumë shpesh, shpesh, rrallë, shumë rrallë;
- Për vlerën e dëmit: shumë e lartë, e lartë, e vogël, shumë e vogël.

Këtyre klasifikimeve, bazuar në përvojën e ekspertëve, u vihen pranë vlerat përkatëse. Me këto të dhëna ndërtohet grafiku si në fig. 2.

Përsa u përket shanseve ata po i identifikojmë me yje, numrin e të cilëve po e pranojmë 3 ndërkohë që mundësia e realizimit në kohë dhe potenciali i përfitimit klasifikohen po ashtu në 4 klasa respektivisht:

- Për mundësinë e realizimi në kohë të shansit (1 herë në –x vjet): shumë shpesh, shpesh, rrallë, shumë rrallë;
- Për potencialin e përfitimit: shumë i lartë, i lartë, i vogël, nuk ekziston.

Edhe në këtë rast këtyre klasifikimeve, mbështetur në përvojën e ekspertëve, u vihen pranë vlerat përkatëse. Me këto të dhëna ndërtohet grafiku si në fig. 3.

Bazuar në rezultatet e identifikimit, vlerësimit, masave që duhen ndërmarrë si dhe indeksimit ndërtohet e ashtuquajtura harta e shanseve dhe risqeve (fig. 7).

Kjo hartë, në kreun e saj, përmban emërtimin e fushës dhe paraqitjen e natyrës së aktiviteteve brenda saj. Pjesë e kreut janë edhe indeksimi i risqeve/ shanseve si dhe të dhëna për monitorimin. Më poshtë harta ekspozon, veçmas për risqet dhe shanset, të dhënat e përftuara në fazat përkatëse të menaxhimit. Ajo mbyllet me një vlerësim tërësor ku definohen indeksi për riskun dhe vlera për shansin që, për rastin e shqyrtuar, rezultojnë respektivisht: dëmi i lartë (2) dhe potencial i lartë (2 yje favorizues dhe një jo favorizues), (fig. 7).

Pas ndërtimit të hartës për të mundësuar monitorimin e zhvillimit në kohë si të risqeve ashtu edhe të shanseve ndërtohet matrica për monitorimin (fig. 8) e cila jep lidhjen midis probabilitetit të shfaqjes së risqeve dhe vlerës së dëmit, me artikulim të potencialit të shanseve. Monitorimi bazohet në një indeks të caktuar (p.sh. në rastin konkret bilanci ekonomik i firmës). Ndryshimet përkatëse, në kushtet e tejkalimit të vlerave të lejuara, raportohen tek njësia që merret me menaxhimin e shanseve dhe risqeve, e cila, rekomandon masat përkatëse qoftë për zvogëlimin e vlerës së dëmit qoftë për rritjen e potencialit të shanseve.

<table>
<tr><td rowspan="2">Emërtimi i fushës</td><td rowspan="2">Financa</td><td>Indeksimi i riskut/shanseve
2 ★ ★ ★</td><td>Monitorimi i riskut dhe shanseve</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Indikatori: Treguesit e bilancit, të dhënat e buxhetit
Personi: xxxxx
Pozicioni: xxxx
Raportuar tek:xxxx</td></tr>
<tr><td>Përshkrimi i aktiviteteve (investimet, shitjet)</td><td colspan="2">Investimet janë shpenzime ndërsa shitjet janë të ardhura që planifikohen në buxhet.</td></tr>
</table>

	Risqet			Shanset			
	Përshkrimi	**Formulimi zgjidhjes:**	**Statusi**	**Përshkrimi**	**Masat e marra**	**Statusi**	
Rriku 1	Nuk realizohen fondet në investime për blerjen e paisjeve që sjellin përmirësime në teknologjinë e prodhimit	Kërkimi i tregjeve të reja për blerjen e tyre	☐ Planifik. ☒ Realiz.	Gjetja e tregjeve më të favorshme për blerjen.	Studimi i konjukturës së tregjeve dhe sigurimi i ofertave	☐ Planifik. ☒ Realiz	Shansi 1
	Prob.shfaqjes ☐ Sh. i lartë ☐ I lartë ☒ I vogël ☐ Sh. vogël	**Dëmi** ☐ Sh. i lartë ☒ I lartë ☐ I vogël ☐ Sh. vogël		**Mundësia përfitimit** ☐ Sh. i lartë ☒ I lartë ☐ I vogël ☐ Sh. vogël	**Potenciali (vlera përfitimit)** ☒ Sh. i lartë ☐ I lartë ☐ I vogël ☐ Sh. vogël		

	Risqet			Shanset			
	Përshkrimi	**Formulimi zgjidhjes:**	**Statusi**	**Përshkrimi**	**Masat e marra**	**Statusi**	
Rriku 2	Nuk realizohen të ardhurat e parashikuara nga shitjet. Rrezikohet reduktimi i prodhimit dhe shkurtimi i fuqisë puntore	Forcimi i reklamës dhe kërkimi i tregjeve të reja	☐ Planifik. ☒ Realiz.	Gjetja e tregjeve më të favorshme për shitjen.	Studimi i konjukturës së tregjeve dhe sigurimi i kontratave	☐ Planifik. ☒ Realiz	Shansi 2
	Prob.shfaqjes ☐ Sh. i lartë ☒ I lartë	**Dëmi** ☐ Sh. i lartë ☒ I lartë		**Mundësia Përfitimit** ☐ Sh. i	**Potenciali (vlera përfitimit)** ☐ Sh. i lartë		

	☐ I vogël ☐ Sh. vogël	☐ I vogël ☐ Sh. vogël	lartë ☒ I lartë ☐ I vogël ☐ Sh. vogël	☒ I lartë ☐ I vogël ☐ Sh. vogël	

Vlerësimi tërësor i riskut: Për shak të ndikimit zgjidhet probabiliteti më i lartë i ndodhjes së riskut	**Treguesi i riskut:** 2	**Vlerësimi tërësor i shansit:** Realizimi i shanseve ka potencial të lartë ndikimi në aktivitetin e firmës	**Vlera e shansit** ★ ★ ★

Fig. 7. Harta për menaxhimin e shanseve dhe risqeve



Fig. 8. Matrica e hartës

3. Përfundime

- Përdorimi i sistemeve të menaxhimit të risqeve dhe shanseve në aktivitetin e sipërmarrjeve duhet të marrë në konsideratë veçoritë specifike të aktivitetit.
- Risqet dhe shanset duhet të shqyrtohen si mundësi që e përmbajnë njëra tjetrën. Çdo risk fsheh shanse dhe çdo shans përmban risqe.
- Risqet dhe shanset duhet të dallohen njëri nga tjetri, në mënyrë që trajtimi i tyre në sistemet e menaxhimit të jetë sa më efektiv për aktivitetin e sipërmarrjes. Përballë vlerës së dëmit që shkakton ndodhja e riskut duhet të

qëndrojë potenciali i përfitimit që vjen nga realizimi i shansit.

- Në çdo sistem menaxhimi duhet të konsiderohet që procedimi në 4 faza (identifikim, vlerësim, administrim (trajtimi dhe monitorim) është realizim vetëm i një cikli ku faza e monitorimit e përmbyll atë ndërkohë që rezultatet e saj shërbejnë për ciklin tjetër.
- Përdorimi i hartave të menaxhimit të risqeve/shanseve krijon mundësinë e disponimit të një dokumentacioni, simbiologjia e të cilit qartëson grafikisht faktorët ndikues dhe masën e ndikimit si dhe ndihmon vendimmarrjen, për të shmangur në kohë efektet negative, që vijnë nga ndodhja e riskut dhe konkretizuar potencialet përfituese që vijnë nga realizimi i shanseve.
- Si pjesë përbërëse e sistemit SWOT shanset dhe risqet rekomandohet të përfshihen në të gjitha aktivitetet projektuese e zbatuese, për të rritur sigurinë në parandalimin e ndodhjes së dëmeve si dhe për të përdorur potencialet përfituese të shanseve në zvogëlimin apo mënjanimin e tyre.

4. Literatura

[1] https://de.wikipedia.org/wiki/Risiko.

https://de.wikipedia.org/wiki/Risikomanagement

https://de.wikipedia.org/wiki/Chancenmanagement

[4] Muka G., "Assessment and Mapping of Georisk in Mining Areas Above Abandoned

Chrome Mines in Albania, IJSR - INTERNATIONAL JOURNAL OF SCIENTIFIC

RESEARCH (IJSR), Volume 5 Issue 3, March 2016, 110 – 112.

[5] Secricon GmbH, Risk & Security Consulting: "Chancenmanagement versus

Risikomanagement" Zuerich 2011

[6] Wiedemann, A., et al.: "Risiken als Chansen verstehen", Wissenschafts-management 5 •

September/Oktober • Ausgabe 2013

[7] Exner-Merkelt, Karin., et al.: "Risiko- und Chancenbewertung als erfolgskritisches

Element", CFOaktuell, August 2007

[8] Dipl.-Ing. Roland König: "Management betrieblicher Risiken bei produzierenden

Unternehmen", Doktorarbeit, S. 31-36, Koeln, 2008

***Nga:** Prof. Dr. Gafur Muka & Prof.Dr.Thoma Korini, Fakulteti Gjeologjisë dhe Minierave, Universiteti Politeknik i Tiranës*

VLERËSIMI I EFICIENCËS SË BIZNESIT: KOSTO E KAPITALIT PËR BIZNESET E MËDHA NË SHQIPËRI

"Sipërmarrjet e biznesit me kapital të huaj zotërojnë avantazhe strukturore në kapitalin e investuar, potencialisht me eficiencë më të madhe sesa sipërmarrjet e biznesit me kapital shqiptar, në sajë të mirëdiversifikimit të kostos mesatare të kapitalit".

Nga: Dr. Llesh Lleshaj, Prof. Asoc. Dr. Edlira Luçi, Doc. Dr. Alban Korbi, Departamenti i Financës, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës

Abstrakt

Vlerësimi i eficiencës së biznesit në aspektin financiar matet me anë të kostos së kapitalit dhe aftësisë së biznesit për të diversifikuar koston e kapitalit. Në kushte kufizimi të të dhënave seri kohore dhe transparencës financiare të raporteve financiare, ky punim analizon një kampion prej 123 kompani me nivel shitjesh më të lartë, për vitin 2014, në tregun shqiptar (përjashtuar sistemi financiar). 48 nga këto kompani janë me kapital të huaj dhe 75 janë me kapital shqiptar. Kompanitë janë të shtrira në të gjithë sektorët bazë të ekonomisë. Kampioni i punimit përbën 14.8% të popullatës dhe hipoteza madhore e punimit është: "*sipërmarrjet e biznesit me kapital të huaj zotërojnë avantazhe strukturore në kapitalin e investuar, potencialisht me eficiencë më të madhe sesa sipërmarrjet e biznesit me kapital shqiptar, në sajë të mirëdiversifikimit të kostos mesatare të kapitalit".* Analiza statistikore e të dhënave është bërë me anë të formës së modeleve të regresionit të shumëfishtë për të vlerësuar strukturën optimale të kapitalit, më pas është vlerësuar kosto e kapitalit reale dhe potenciali diversifikues. Variabli i varur është: struktura e financimit me borxh (raporti borxh total/Asetet totale). Ndërsa variablat e pavarur janë: asete të trupëzuara të qendrueshme (asete fikse/Asetet totale), shkalla e përfitimit (EBIT/Asetet totale, ku EBIT është fitimi para interesave dhe tatimit), risku i fitimit (shkalla e levës financiare), rritja e kompanisë [(asete totale – kapitalin aksioner + vlerën e tregut të aksioneve)/ asetet totale]dhe

madhësia e kompanisë (logaritmi i aseteve totale). Bizneset me kapital shqiptar dhe kapital të huaj kanë qëndrueshmëri statistikore të strukturës së tyre të kapitalit. Kjo strukturë nuk është optimale për bizneset me kapital shqiptar sepse kosto e kapitalit të investuar potencialisht është 12.44%, ndërsa për bizneset me kapital të huaj është 10.08%. Kjo tregon që bizneset me kapital të huaj janë më eficientë në diversifikimin e kostos së kapitalit krahasuar me kompanitë me kapital shqiptar. Kjo tregon potencialin konkurrues që kanë investitorët e huaj sidomos për ato kompani ose filiale të kompanive të huaja. Në këto kushte, investitorët e huaj janë më të aftë që të konkurrojnë në lidhje me çmimin dhe cilësinë, në çmimet premium, në zbatimin e projekteve me interval më të gjerë rentabiliteti, etj.

Fjalë kyçe: *biznes me kapital të huaj dhe shqiptar, potenciali i kosto së kapitalit.*

Kodet e klasifikimit JEL: *C58, G12 dhe G32.*

1. Hyrje

Një nga aspektet ekonomike më të rëndësishme që karakterizon çdo investim është vlerësimi i eficiencës së tyre. Teorikë ekonomike sugjerojnë forma alternative të vlerësimit të biznesit, por në këndvështrimin financiar ata konvegjojnë në një pikë të përbashkët. Vlerësimi i efiçensës së biznesit nuk është një pikë kritike e aktivitetit, por është ekuilibri i gjetur mes kostove shtesë me të ardhurat shtesë. Kjo pikë ekuilibri ndikohet ndjeshëm nga struktura e kapitalit të biznesit. Të gjithë bizneset gjatë fazës së tyre të ciklit të jetës, kanë sjellje të ndryshme rreth financimit dhe investimit, për pasojë edhe struktura e tyre e kapitalit ndryshon. Nëse strukturën e kapitalit të investuar në biznes e mesatarizojmë me kostot e secilit burim financimi, kemi njehsuar kështu koston mesatare të kapitalit (WACC). Kjo kosto tregon sa i kshton investimi një biznesi të parë në kompleks me të gjitha burimet e financimit. Tashmë efiçenca e një biznesi është e ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë më WACC e tij. Përcaktimi i WACC së një kompanie është dukuri financiare që integron peshat e çdo burimi financimi me kostot e tyre, dhe bën vlerësime nga ato kontraktuale në ato dinamaike (kthimi i aksioneve në bursë), të lidhur me riskun. Vlerësimi i përfitueshmërisë së aksioneve të listuara në bursë bëhet sipas modelit të vlerësimit të çmimit të mjetit kapital (CAPM), njihet edhe me termin vlerësimi në kushte eficiente tregu. Ky model për herë të parë u hartua nga Traynor (1961) dhe Sharpe (1964). Modeli CAPM është një model i përdorur gjerësisht edhe në ditët tona, ai lidh normën e kërkuar të kthimit të një mjeti, me riskun e tij të matur nga koefiçenti “beta”. Koefiçenti “beta” mat riskun sitematik (d.m.th riskun e pareduktueshëm nga kompozimi i titujve financiar në një portofol titujsh).

Qëllimi i këtij punimi është që të analizohet struktura optimale të kapitalit

të biznesit privat në Shqipëri (përjashtuar ndërmjetësit financiar) dhe të vlerësohet kosto e kapitalit, duke treguar edhe nivelin e maksimizimit të pasurisë së investitorëve që ofron tregu shqiptar. Gjithashtudo të synohet që të krahasojmë nivelin e diversifikimit të kostos së kapitalit (minimizimin e saj) dhe lidhjen me pronësinë (shqiptare apo e huaj). Metoda e cila i përafrohet më mirë realitetit shqiptar është bazuar në raportet financiare të kompanisë. Ndonëse dobia e përcaktimit të kostos mesatare të kapitalit është baza e çdo vendimi investimi, në tregun shqipar WACC është ende një aspekt teorik financiar. Prandaj përmes këtij punimi synohet për herë të parë të bëhet një matje e WACC, për tju ardhur në ndihmë: menaxherëve financiar të bizneseve, hartuesve të planeve të bizneseve, analistëve të kredive dhe riskut në banka, dhe çdo grupi tjetër të interesit.

Megjithatë mbetet për tu analizuar në vijm nga një studim më i thelluar në këtë fushë, kosto e kapitalit të investitorëve vendas dhe të huaj,në Shqipëri, duke e analizuar në nivel sektori jo të ekonomisë në tërësi, kjo për arsye se sektorët ekonomik nga prodhim në shërbim, etj, kanë diferenca të rëndësishme në kosto dhe përfitime. Ndoshta studimi do të ishte më i plotë nëse do të analizohej në aspektin e serive kohore. Këto kufizime janë rrjedhojë e drejtpërdrejtë e të dhënave dhe transparencës së tyre, që karakterizon ekonominë shqiptare.

2. Rishikim literature

Në kontekstin e krizave financiare të kohëve moderne, një nga studiuesit e krizave financiare, (Fosberg (2012) ka analizuar se si kriza financiare e vitit 2008 solli reduktimin e emetimit të letrave me vlere nga kompanitë dhe reduktimin e kredive (dhe forma të tjera të huave) nga institucionet financiare. Por si rezultat edhe i uljes së vlerës së tregut të aksioneve të kompanive në bursa, raportet e strukturës së kapitalit ndryshuan ndjeshëm tek kompanitë, duke rritur peshën e borxhit, e njëkohësisht edhe të riskut financiar të kompanive. Në këto rrethana shumë kompani përjetuan ndryshime të strukturës së kapitalit, duke u larguar nga struktura optimale e teorive financiare.

Struktura e kapitali është ajo që i jep avantazh ose e ndëshkon një kompani, sepse struktura kapitali është përcaktuesi i kostos të kapitalit, në kushtë të alternativave të njohura dhe të thjeshta të financimit, siç realiteti shqiptar. Të gjendët niveli optimal i strukturës së kapitalit do të thotë të arrihet qëllimi i maksimizimit të pasurisë së kompanisë në lidhje me riskun, fitimin dhe vlerën. Në këtë kontekst struktura e kapitalit pëson ndryshime gjatë jetës së kompanisë dhe si e tillë ajo nuk mund të jetë një raport i fiksuar, siç pretendohet nga teoritë klasike. Që pas viteve 50-të kjo teoria e një strukture të fiksuar është hedhur poshtë nga Modigliani-Miller në 1958, që bazohet në parimin se struktura optimale kapitali sjell maksimizimin e pasurisë së aksionerëve të kompanisë, atëherë gjetja e nivelit optimal analizohet njëkohësisht

me fitimin dhe riskun.Megjithatë pranohet se në një ekonomi, apo degë ekonomie, kompanitë lider janë ato që kanë arritur të optimizojnë strukturën e tyre dhe njëkohësisht të minimizojmë koston mesatare të kapitalit. Nëse marrim në analizë një ekonomi, kompanitë me performancë më të lartë dhe me nivel më të madh të seteve, dhe që kanë shumë kohë që performojnë si më të mirat në treg, themi se kanë arritur të optimizojnë strukturën e tyre financiare. Kuptohet që kompanitë e tjera në atë treg do të synojnë të ndjekin këta lidera.

Se cila është lidhja midis strukturës së kapitalit dhe vlerës së kompanisë, përgjigja e parë u dha nga Modigliani and Miller (1958). Më vonë filluan të bëheshin studime të strukturës së kapitalit të kompanive nga Leland dhe Pyle (1977), Rajan dhe Zingales (1995), etj. Struktura optimale e kapitalit nënkupton gjetjen e raportit të borxhit dhe kapitalit të vet me qëllim maksimizimin e vlerës së kompanisë me risk minimal (Myers, 1984). Duke zhvilluar modelin e Modigliani-Miller dhe duke korrigjuar asimetrinë e informacionit, Heinkel (1982) ishte i mendimit që nivelet optimale dhe ekuilibër të strukturës së kapitalit janë të lidhura me pritshmëritë e investitorëve.Për të analizuar faktorët përcaktues së strukturës së kapitalit të kompanive, me anë të treguesve financiar, një studim i tillë i plotë u realizua nga Rajan dhe Zingales (1995), ku identifikohen këto faktorë në gjetjen e një strukture optimale: (1) Asete fikse/Asetet totale; (2) Shkalla e përfitimit (EBIT/Asetet totale); (3) Risku i fitimit (koefiçenti i variacionit të EBIT); (4) Rritja e kompanisë [(Asete Totale– Kapitalin aksioner + Vlerën e tregut të aksioneve)/ Asetet totale] dhe (5) Madhësia e kompanisë (logaritmi i shtitjeve ose aseteve). Treguesi EBIT është fitimi para interesave dhe tatimit.

Një tregues financiar që përafrohet me normën e skontimit të aksioneve të një kompanie është treguesi financiar ROE (ROE = fitim neto/kapital i vet mestar), (Velez-Pareja, 2000).Vlera e WACC nga raportet e pasqyrave financiare (interesi i kredive afatgjata, ROE, etj.), dhe me WACC nga kapitalizimi bursier (modeli i tregut CAPM), ka një korrelacion me lidhje pozitive 0.5 – 0.6 (Ketchum dhe Kim, 2013).

Gjithashtu është vrojtuar që ekziston një lidhje e qëndrueshme dhe e rëndësishme statistikore të treguesit ROE me normën e skontimit të aksioneve për kompanitë e listuara në bursë (Hevert, 2014). Ky përafrim do të na ndihmojë për të llogaritur vlerën e kostos të kapitalit të bizneseve në tregun shqiptar, në kushte të mungesës së bursës së letrave me vlerë.

3. Metodologjia dhe të dhënat

Për të analizuar këtë lidhje të treguesve financiar me strukturën optimale të kapitalit, do ti referohemi studimeve të disa autorëve: Titman dhe Wessels (1988); Harris dhe Raviv (1990); Rajan dhe Zingales (1995); Ross dhe Westerfield dhe Jaffe (2002); Gitman dhe Zutter (2010); Fama & French (2012); Strebulaev, I., & Whited, T. (2012); etj. Sipas këtyre studimeve do të identifikojmë, për

realitetin e bizneseve të mëdha në Shqipëri, këto variabla:

Variabël i varur: *Struktura e financimit me borxh = Borxh total/Asetet totale*. Zëri i borxhit total përfshin çdo lloj detyrimi të kompanisë (afatshkurtër dhe afatgjatë).

Variablat e pavarur:

Asete të trupëzuara të qëndrueshme = Asete fikse/Asetet totale. Zëri asete të trupëzuara janë: toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje dhe çdo zë tjetër aktiv material në kompani. Ky tregues ruan vlerën e kompanisë, pasi asetet jo-fikse të tillë si emri i mirë e humbasin lehtësisht vlerën, pra asetet fikse janë më të qëndrueshëm (veçanërisht për rastet kur kompania është në vështirësi financiare). Asetet fikse janë pjesë e investimit afatgjatë. Ky variabël pritet të ketë lidhje pozitive me variablin e varur.

Shkalla e përfitimit = EBIT/Asetet totale, (EBIT është fitimi para interesave dhe tatimit).Ky tregues mat nivelin e përfitimit para interesave dhe tatimit për kompaninë i standardizuar në raport me asetet e kompanisë. Kjo e bën shumë të rëndësishëm analizën e këtij treguesi në strukturën e kapitalit.Ky variabël pritet të ketë lidhje negative me variablin e varur.

Risku i fitimit = koefiçenti i variacionit të EBIT. (d.m.th raporti devijim standard i variablit EBIT ndaj mesataren e vlerave të variablit EBIT).EBIT duhet të matet si një mesatare të tregut, për një seri kohore të dhënash financiare. Ky tregues mat riskun e aktivitetit operativ të biznesit, meqenëse studimi ynë është me vlerësime pikësore, atëherë variabli risk financiar do të zëvendësohet me shkallën e levës financiare (Gitman dhe Zutter, 2010). Shkallë e levës financiare "DFL" njehsohet me anë të raportit financiar: DFL = EBIT/[EBIT – Interesa – (dividendë të preferuar)/(1 – tatimin mbi fitimin)]. Ky variabël pritet të ketë lidhje pozitive me variablin e varur.

Rritja e kompanisë = [(Asete Totale – Kapitalin aksioner + Vlerën e tregut të aksioneve)/ Asetet totale]. Në kushte të mungesës së bursës së letrave me vlerë (rasti i Shqipërisë), vlera e tregut të aksioneve është e pamundur që të vlerësohet në çdo moment dhe merret Kapitalin aksioner = Vlerën e tregut të aksioneve.Ky tregues mund të vlerësohet vetëm kur kemi shit-blerje të kompanisë. Në kushte të tjera normale të biznesit ekspertët kontabël e vlerësojnë sa vlera e kapitalit aksioner nga bilancet e tyre. Ky variabël e humbet rëndësinë e përfshirjes në model.

Madhësia e kompanisë = Ln(shitje neto) ose Ln(aseteve totale).Ky tregues shërben për të analizuar edhe lidhjen e madhësisë me riskun e biznesit. Sa më e madhe të jetë madhësia e biznesit aq më i vogël risku i biznesit. Kompanitë e vogla nuk kanë mundësi të financohen me obligacion dhe forma të tjera financimi alternative, kështu që e kanë më të kushtëzuar ndryshimin e strukturës së kapitalit. Ky variabël pritet të ketë lidhje pozitive me variablin e varur.

Nisur nga të dhëna dhe raporte financiare të kompanive në Shqipëri do të ndërtojmë modele regresioni me shumë variabla të

trajtës lineare dhe logaritmike për të vlerësuar strukturën e kapitalit të investuar: $y = b_0 + b_1*x_1 + b_2*x_2 + ... + b_n*x_n + \varepsilon$

Simbolika e përdorur në këto lloje modelesh shpjegohet më poshtë: y = *variabli i varur* (në këtë studim kemi vetëm një variabël të varur i cili është struktura e kapitalit të investuar ose raporti i borxhit).

x_i= *variabli i pavarur* për $i = 1, 2, ..., n$ dhe secili prej tyre është një bashkësi pikësore vrojtimi, (në këtë studim variablat e pavarur janë raporte financiare të kompanive).

b_i= parametrat e modelit, ose koefiçentët e variablave të pavarur në model, për $i = 1, 2, ..., n$ (në këtë studim regresiv, ndryshimi i variablit të varur Δy shpjegohet në lidhje me këto koefiçentë b_i kur $\Delta x_i = + 1$ *njësi*, në kushtet "*ceteris paribus*").

ε = quhet mbetja e regresionit, ose termi i gabimit, është i vetmi variabël që nuk parashikohet ose të shpjegohet nga modeli dhe ai duhet të jetë stokastik. Ky term gabimi njihet si gabimi statistikor i modelit (është një bashkësi faktorësh të tjerë ndikues të pa përfshirë në model).Për të bërë vlerësimin e parametrave b_i, do të përdoret metoda e zakonshme e katrorëve më të vegjël (Dougherty, 2007). Por që ky vlerësim të shërbejë për të nxjerrë përfundime me besueshmëri të lartë statistikore, do të bazohemi në të gjitha supozimet bazë të Teoremës Gauss-Markov (Gujarati, 2004). Sipas kësaj teoreme që një model regresioni të jetë më i miri statistikisht dhe i dobishëm për analiza ekonomike duhet të përmbushë disa kushte:

Kushti i parë: modeli duhet të jetë linear ose logaritmik që të zbatohet metoda e katrorëve më të vegjël. Linearitetet duhet të jetë sipas parametrave b_i.

Kushti i dytë: modeli duhet t'a ketë të përcaktuar në mënyrë të vetme parametrin b_0 (i quajtur ordinata në origjinë), d.m.th pritja matematikore e mbetjeve është $E(\varepsilon) = 0$.

Kushti i tretë: modeli duhet ta ketë variancën e mbetjeve ε konstante, d.m.th nuk duhet të ketë heteroskedasticitet sepse parametrat b_i janë të pazhvendosur.

Kushti i katërt: modeli nuk duhet të ketë autokorrelacionit të mbetjeve, d.m.th kovarianca $Cov(\varepsilon_i;\varepsilon_j) = 0$ për çdo $i \neq j$.

Kushti i pestë: modeli nuk duhet të ketë multikolinearitet, d.m.th korrelacion të rëndësishëm statistikor midis variablave të pavarur x_i ndërmjet tyre ose variablave dhe mbetjeve ε së modelit, për çdo $i = 1, 2, ..., n$.

Pasi të vlerësojmë strukturën optimale të kapitalit sipas modelit të regresionit me shumë variabla, do të njehsohet edhe vetë kostoja mesatare e kapitalit (WACC). Kjo kosto do të llogaritet mbi kampionin e kompanive të marrë në studim, veç për kompanitë me kapital shqiptar dhe veç për kompanitë me kapital të huaj në Shqipëri. Duke ditur që struktura optimale e kapitalit të investuar në një kompani ndahet në dy bashkësi: (1) financim me borxh dhe (2) financim me kapital të vet,

do të bënte të mundur vlerësimin e WACC. Formula e WACC në këtë rast është (Gitman dhe Zutter, 2010):

$$\mathrm{WACC} = \mathrm{W_E} \cdot \mathrm{K_E} + \mathrm{W_D} \cdot (1 - \mathrm{t}) \cdot \mathrm{K_D}$$

Ku: W_E është shënuar nga pesha që zë financimi me kapital të vet të kompanisë në raport me totalin e pasiveve.

W_D është shënuar nga pesha që zë financimi me borxh i kompanisë në raport me totalin e pasiveve.

K_E është norma e skontimit të kapitalit të kompanisë, në studimin tonë është marrë raporti financiar *fitim neto/kapital i vet i kompanisë* (ROE).

K_D është kosto e financimit me borxh për kompaninë e cila përafrohet me normën e Obligacioneve të Thesarit, në Shqipëri lidhet me normën e Bonove të Thesarit (Banka e Shqipërisë, 2015) dhe i shtohet primi i riskut të kredive, ose me mesataren e tregut të secilit burim financimi me borxh. Normë bono thesari me maturitet 12 muaj + primi i riskut të kredive = 3.415% + 5.55% = 8.965%.

t është norma e tatim-fitimit të bizneseve në Shqipëri e cila aktualisht është 15%.

Në këtë punim janë përdorur të dhëna *pikësore sasiore*, të cilat përfaqësohen vetëm nga të dhëna financiare të bizneseve të analizuara në punim. Baza e këtyre të dhënave janë pasqyrat financiare të raporteve vjetore të kompanive me kapital 100% në pronësi vendase dhe kompani me kapital mbi 50% kapital në pronësi të huaj. Janë përdorur të dhënat e vitit 2014 si vrojtime pikësore për disa tregues financiar. Në punim janë shfrytëzuar të dhënat e të gjitha pasqyrave financiaretë 123 bizneseve të mëdha në Shqipëri dhe që në 2014 janë pjesë e 200 bizneseve "VIP"[1], d.m.th kanë patur nivelin më të lartë të shitjeve vjetore në shkallë kombëtare. Nga këto 200 kompani 60 janë me kapital të huaj dhe 140 me kapital vendas (ose me përqindje shumë të vogël të huaj), bazuar në vlerësime të ekspertëve të ekonomisë dhe specifikisht ekspertë kontabël, u pranuan si zgjedhje e analizave në vijim 48 kompani të huaja dhe 75 kompani me kapital shqiptar. Kompanitë e përfshira në studim janë të shpërndara në të gjithë sektorët bazë të ekonomisë. Përzgjedhja e kompanive ishte subjekt i besueshmërisë dhe transparencave të rezultateve financiare të deklaruara (d.m.th u përzgjodhën kompanitë me shkallë më të ulët të vlerësuar të informalitetit).Këto pasqyra financiare janë të audituara dhe të hartuara sipas Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit[2]. Kampioni përbën 123/830 = 14.8% e popullatës. Hipoteza madhore e punimit është:

"*sipërmarrjet e biznesit me kapital të huaj zotërojnë avantazhe strukturore në kapitalin e investuar, potencialisht me efiçencë më të madhe sesa sipërmarrjet e biznesit me kapital shqiptar, në sajë të morëdiversifikimit të kostos mesatre të kapitalit*

---

[1] Sipas Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, numërohen rreth 830 biznese të mëdha të kategorizuara VIP, d.m.th xhiroja e tyre vjetore është mbi 250 milion Lekë.

[2]Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2006, "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

$(WACC_{(potenciale),IHD} < WACC_{(potenciale),IB})$"

Në strukturën e kapitalit integrohen të gjitha vendimet me natyrë financuese afatgjatë. Në këtë kontekst struktura e kapitalit është e ndikuar nga shumë variabla dhe sidomos në një vend si Shqipëria, arsyet që e vështirësojnë ose e kufizojnë këtë llogaritje janë:

Së pari, të dhënat e kompanive në Shqipëri janë në kuadrin e pasqyrave financiare dhe përfitueshmëria e kompanive ka qenë dhe vazhdon të jetë pre e evazionit fiskal apo informalitetit ekonomik duke rritur marzhin e gabimit në llogaritjen e vlerave. Ndonëse kompanitë më të mëdha e kamë më të reduktuar shkallën e informalitetit.

Së dyti, të dhënat e kompanive në Shqipëri janë vetëm ato të pasqyrave financiare, d.m.th të dhëna statike me periodicitet një vit (mungon një matje dinamike). Në Shqipëri nuk ka ende një bursë të letrave me vlerë që të jetë të kuotuara kompanitë.

Së treti, pas viteve 90-të Shqipëria hyri në rrugën e zhvillimit të ekonomisë së lirë dhe tregtisë së lirë me jashtë (para viteve 90-të ishte pjesë e regjimit Komunist). Kjo tregon që bizneset në Shqipëri janë të reja dhe vazhdojnë të përjetojnë fazën e hyrjes në treg apo mungesën e specializuar të departamentizimit dhe menaxhimit, që të mendohet edhe për diversifikim të strukturës së kapitalit.

Së katërti, si rezultat i një tregu të lirë të ri, alternativat e financimit të bizneseve në Shqipëri janë të kufizuara përfshirë këtu edhe kulturën e financimit të bizneseve që besojnë vetëm në sektorin bankar. Nga ana tjetër edhe infrastruktura ligjore ka qenë shpesh herë pengesë në zhvillimin e instrumenteve të reja të financimit të bizneseve.

Së pesti, shumë kompani me reputacion të mirë me marrëdhëniet me bankat, ose të suksesshme në treg (por edhe nga pikëpamja e treguesve financiar) marrin borxh në emër të tyre dhe e përdorin për të financuar një kompani tjetër të lidhur me të parën[3], e cila ka probleme financiare. Në këtë mënyrë nuk mund të matet efekti dhe ndikimi strukturor i kapitalit real i kompanisë huamarrëse.

Së gjashit, një kufizim metode që shoqëron punimin është projeksioni i kostos potenciale të huave dhe normës marxhinale të tatim-fitimit, bazuar në vlerën e 2015.

Së fundi, analiza e vendimeve të menaxherëve të projekteve në kompanitë e tregut tonë, në shumë raste janë të projektuara dhe të analizuar mbi gjykime të ngjashmërive dhe intuitës, dhe jo sipas një plani biznesi që ka në konsideratë përputhjen me strukturën e kapitalit.

4. Analiza empirike e punimit

Nisur nga karakteristikat e kostos mesatare të kapitalit për realitetin shqiptar, kufizimet që shoqërojnë vlerësimin e saj, etj, analiza në vijim synon të masë koston e kapitalit të investuar nga

[3] *Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve – Legjislacioni Tatimor 2015, Udhëzim nr. 6, datë 30.01.2015.*

bizneset me pronësi të huaj dhe me pronësi shqiptare në vend.

4.1 Analiza e bizneseve me kapital të huaj

Bizneset me kapital të huaj kanë këtë paraqitje strukturore përshkruese si në tabelën 1:

	Raporti i borxhit total RBT	Raporti i borxhit me kosto RBK	Raporti i borxhit afatgjatë RBGJ	Përpjesa e asetve të qëndrueshme AQT	Leva financiare LEV	Shkalla e përfitimit SHP	Madhësia, log(asete) MA	Kthimi nga kapitali ROE
Mesatarja	0.53	0.25	0.19	0.54	0.75	0.16	9.36	0.23
Mediana	0.56	0.21	0.12	0.54	0.23	0.13	9.27	0.19
Maksimumi	0.88	0.69	0.69	0.94	4.81	0.62	10.68	0.70
Minimumi	0.13	0.00	0.00	0.00	0.00	0.01	7.98	0.00
Dev. Stand.	0.26	0.22	0.20	0.21	1.02	0.15	0.63	0.18
Jarque-Bera	4.30	4.14	7.30	0.29	52.83	20.04	0.27	5.19
Nr. vrojtimeve	48	48	48	48	48	48	48	48

Burimi: Punuar nëEviews 8 nga autorët.

Nga 48 kompani me kapital të huaj në vendin tonëdhe që renditen në grupin e 200 kompanive me nivel më të lartë të shitjeve neto, e kanë raportin e borxhit mesatarisht 53%. Kjo do të thotë që 53% e nivelit të investimit të tyre (afatgjatë dhe afatshkurtër) është me borxh. Ndonëse raporti i borxhit është një tregues i strukturës së kapitalit të një kompanie, për specifikat që merr ekonomia shqiptare, kemi bërë ndarjen e tij në raport borxhi me kosto (çdo lloj borxhi që ka biznesi dhe që paguan interes) dhe raport borxhi afatgjatë (çdo burim financimi të huazuar me afat të gjatë shlyerje). Nga tabela 1 më lart, shikojmë që raporti i borxhit me kosto dhe ai afatgjatë kanë një diferencë më të vogël sesa krahasuar me raportin e borxhit total. Kjo tregon që bizneset janë financuar me burime të tjera si: llogari të pagueshme, parapagime, etj. Ky ndryshim është tregues i një fokusi financimi të investimeve të huaja jo me perspektive shumë afatgjatë. Duke u bazuar në vlerën e testit Jarque-Bera, shumica e treguesve (sidomos ato të përfshitë në modelet e strukturës) janë me shpërndarje normale, kjo dukuri e lehtëson përdorimin e vlerësimeve me metodën e zakonshme të katrorëve më të vegël.

Tabela 2. Vlerësimi statistikor i parametrave të strukturës së kapitalit, kapital i huaj.

Dependent Variable: RBT
Method: Least Squares
Sample (adjusted): 2 48
Included observations: 47 after adjustments
Convergence achieved after 14 iterations

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	1.699004	0.457563	3.713157	0.0006
AQT	-0.388482	0.131600	-2.951979	0.0052
LEV	0.183088	0.029980	6.106959	0.0000
MA	-0.104844	0.049335	-2.125143	0.0396
SHP	-0.670270	0.172681	-3.881546	0.0004
AR(1)	0.229093	0.155047	1.477572	0.0147

R-squared	0.643320	Mean dependent var	0.525535
Adjusted R-squared	0.599822	S.D. dependent var	0.260645
S.E. of regression	0.164883	Akaike info criterion	-0.648420
Sum squared resid	1.114640	Schwarz criterion	-0.412231
Log likelihood	21.23787	Hannan-Quinn criter.	-0.559541
F-statistic	14.78977	Durbin-Watson stat	1.809340
Prob(F-statistic)	0.000000		

Inverted AR Roots	.23

Burimi: Llogaritja nëEviews 8 nga autorët.

Bazuar në testin nga tabela 2 më lart dhe pasi janë bërë të gjitha testet e rregullimit të mbetjes së modelit, si: autokorrelacioni, heteroskedasticiteti, multikolinearitetі dhe normaliteti i mbetjeve (Aneksi Nr. 1), modeli i vlerësimit të strukturës optimale të kapitalit të bizneseve të huaja,është:

$$RBT = 1.67 - 0.39*AQT + 0.18*LEV - 0.10*MA - 0.67*SHP + 0.23*\varepsilon_{i-1} + \varepsilon_i$$

Modeli ka një nivel koefiçenti përcaktueshmërie jo shumë të lartë por të pranueshëm për studimet e tregut, me vlerë 64% ose 60% të korrigjuar. Ndërkohë sipas testit Fisher modeli është statistikisht i rëndësishëm me nivel gabimi

α < 1% dhe parametrat e modelit janë statistikisht të rëndësishëm sipas test të shpërndarjes studenti me nivel gabimi α < 5%. Modeli i bizneseve me kapital të huaj e ka raporin e borxhit të lidhur pozitivisht me:

- Levën financiare (niveli i borxhit dhe risku i financimit me borxh, qëështë leva financiare, duhet të ketë lidhje pozitive midis tyre).

dhe lidhje negative me:

- Përqindjen e aseteve fikse ndaj totalit të aseteve (sepse pjesa më e madhe e borxhit është me natyre afatshkurtër),
- Madhësinë e biznesit si total asete (kjo tregon që borxhi ka zënë një peshë të konsiderueshme në biznes),
- Shkallën e përfitimit (përdorimi i borxhit aktual nga bizneset, nuk ka ndikim pozitiv në shtimin e përfitimit operativ).

Ajo çfarë është karakteristikë e modelit është tendenca e përgjithshme e qëndrueshmërisë së parametrave të tij edhe në afatgjatë. Ky përfundim mbështetet tek testet e stabilitetit të parametrave të modelit "Cusum" dhe "Cusum of Squares":



Burimi: Llogaritje në Eviews 8 nga autorët.

Fig. 1. Ilustrimi i stabilitetit të parametrave modelit i bizneseve të huaja.

Në këto kushte parametrat e modelit janë një vlerësim i mirë i strukturës optimale të kapitalit, për bizneset me pronësi të huaj, në vendin tonë.

1.1 Analiza e bizneseve me kapital shqiptar

Në vijim të logjikës nga çështja më lart, do të bëjmë edhe një analizë të kostos së kapitalit edhe për bizneset me kapital me pronësi shqiptare. Fillimisht po pasqyrojmë një përmbledhje të statistikave përshkruese të treguesve financiar si në tabëln 3:

Tabela 3. Treguesit financiar kryesor të strukturës sëkapitalit, bizneset me kapital shqiptar.

	Raporti i borxhit total RBT	Raporti i borxhit me kosto RBK	Raporti i borxhit afatgjatë RBGJ	Përpjesa e asetve të qëndrueshme AQT	Leva financiare LEV	Shkalla e përfitimit SHP	Madhësia, log(asete) MA	Kthimi nga kapitali ROE
Mesatarja	0.61	0.31	0.16	0.29	0.66	0.09	9.39	0.17
Mediana	0.64	0.29	0.09	0.24	0.20	0.07	9.40	0.13
Maksimumi	0.92	0.79	0.76	0.79	4.28	0.32	10.74	0.57
Minimumi	0.10	0.00	0.00	0.00	0.00	0.01	8.16	0.02
Dev. Stand.	0.20	0.22	0.18	0.21	0.94	0.06	0.49	0.12
Jarque-Bera	4.16	3.69	23.70	4.83	62.89	40.65	0.83	21.99
Nr. vrojtimeve	75	75	75	75	75	75	75	75

Burimi: Punuar nëEviews 8 nga autorët.

Nga 75 kompani me kapital të huaj në vendin tonë dhe që renditen në grupin e 200 kompanive me nivel më të lartë të shitjeve neto, e kanë raportin e borxhit mesatarisht 61%. Nga tabela 3 më lart, shikojmë që raporti i borxhit me kosto dhe ai afatgjatë kanë një diferencë më të vogël sesa krahasuar me raportin e borxhit total, por më të theksuar sesa rasti i bizneseve me kapital të huaj. Ky ndryshim është tregues i një fokusi financimi të investimeve nga ato me pronësi shqiptare në pronësi të huaj, ku dallohet vizioni afatshkurtër i financimit. Në tabelën 4, më poshtë tregohet modeli i vlerësimit të strukturës së kapitalit.

Tabela 4. Vlerësimi statistikor i parametrave të strukturës së kapitalit, kapital shqiptar.

Dependent Variable: RBT
Method: Least Squares
Sample (adjusted): 2 75
Included observations: 74 after adjustments
Convergence achieved after 7 iterations

Variable	Coefficient	Std. Error	t-Statistic	Prob.
C	1.089790	0.348012	3.131474	0.0026
AQT	-0.375824	0.086080	-4.366003	0.0000
LEV	0.097039	0.018282	5.307916	0.0000
MA	-0.037320	0.037027	-1.007910	0.3171
SHP	-1.034434	0.261556	-3.954921	0.0002
AR(1)	0.438418	0.109262	4.012529	0.0002

R-squared	0.655573	Mean dependent var	0.606982
Adjusted R-squared	0.630248	S.D. dependent var	0.203668
S.E. of regression	0.123845	Akaike info criterion	-1.261970
Sum squared resid	1.042952	Schwarz criterion	-1.075154
Log likelihood	52.69290	Hannan-Quinn criter.	-1.187447
F-statistic	25.88590	Durbin-Watson stat	1.921124
Prob(F-statistic)	0.000000		
Inverted AR Roots	.44		

Burimi: Llogaritja nëEviews 8 nga autorët.

Bazuar në testin nga tabela 4 më lart dhe pasi janë bërë të gjitha testet e rregullimit të mbetjes së modelit, si: autokorrelacioni, heteroskedasticiteti, multikolineariteti dhe normaliteti i mbetjeve (Aneksi Nr. 2), modeli i vlerësimit të strukturës optimale të kapitalit të bizneseve me pronësi shqiptare, është:

$$RBT = 1.09 - 0.38*AQT + 0.10*LEV - 0.04*MA - 1.03*SHP + 0.44*\varepsilon_{i-1} + \varepsilon_i$$

Modeli ka një nivel koefiçenti përcaktueshmërie të pranueshëm në kushte të realitetit, me vlerë 66% ose 63% të korrigjuar. Ndërkohë sipas testit Fisher modeli është statistikisht i rëndësishëm me nivel gabimi $\alpha < 1\%$ dhe parametrat e modelit janë statistikisht të rëndësishëm sipas test të shpërndarjes studenti me nivel gabimi $\alpha < 5\%$, me përjashtim të variablit MA që nuk është statistikisht i rëndësishëm. Modeli i bizneseve me kapital shqiptare ka raportin e borxhit të lidhur pozitivisht me levën financiare dhe lidhje negative me:përqindjen e aseteve fikse ndaj totalit të aseteve; dhe shkallën e përfitimit. Arsyet e këtyre lidhjeve janë siç u shprehëm më lart (modeli i bizneseve me kapital të huaj).

Në ndryshim me modelin e bizneseve me kapital të huaj, modeli i strukturës optimale të kapitalit për bizneset shqiptare është me parametra plotësisht të qëndrueshëm. Ky përfundim mbështetet tek testet e stabilitetit të parametrave të modelit "Cusum" dhe "Cusum of Squares":



Burimi: Llogaritje në Eviews 8 nga autorët.

Fig. 2. Ilustrimi i stabilitetit të parametrave modelit i bizneseve shqiptare.

Ky model vlerësimi i strukturës optimale karakterizon qëndrueshmërinë strukturore të borxhit dhe kapitalit për bizneset me pronësi shqiptare.

Duke marrë si gjendje reale nivelin mesatar të raportit të borxhit total nga zgjedhja e bizneseve dhe nivel potencial rezultatin mesatar të raportit të borxhit të përftuar nga modeli (duke e zbatuar për secilin biznes), kemi:

Tabela 5. Struktura reale dhe potenciale e kapitalit të investuar nga bizneset.

Pronësia e biznesit	*Rezultati real (mesatar)*		*Rezultati potencial (mesatar)*	
	Borxh	*Kapital i vet*	*Borxh*	*Kapital i vet*
E huaj	53%	47%	55%	45%
Shqiptare	61%	39%	58%	42%

Burimi: Llogaritje të autorit.

Diferenca midis nivelit potencial dhe real për bizneset e marrë në analizë pritet të jetë shumë e vogël, sepse kampioni ynë përfaqëson kompanitë më të mira (lidër) në treg, dhe potencialet e tregut tonë më mirë sesa këto kompani nuk shfrytëzohen nga biznes tjetër. Nga ana tjetër vetë modeli i vlerësimit të gjendjes potenciale është derivuar nga këto kompani (prandaj metoda e vlerësimit të potencialit "brenda zgjedhjes" është e kritikueshme shpesh herë). Por modelet e gjetura të regresionit janë të vlefshme që të analizojë kompani të tjera të tregut të cilat nuk kanë pjesë e zgjedhjes dhe në këtë rast merr kuptim më të plotë analiza reale dhe potenciale. Megjithatë për të matur vlerën e kostos së kapitalit midis llojeve të pronësisë, analiza tani është e thjeshtë, pasi struktura e kapitalit është e njohur.Nëse shikojmë vlerën e stokut të IHD-ve gjatë 2014 në

Shqipëri është shumë e përqendruar, e shpërndarë në shtetet:

Tabela 6. Vlera e stokut të IHD-ve në Shqipëri, 2014.

Shteti	*stoku i IHD-ve (milion Euro)*	*Përpjesa*
Greqi	1169	26%
Kanada	755	17%
Itali	526	12%
Holandë	505	11%
Turqi	394	9%
Austri	357	8%
Gjermani	128	3%
Qipro	117	3%
SHBA	88	2%
Zvicër	82	2%
Francë	68	2%
Të tjera	249	6%

Burimi: Banka e Shqipërisë, 2015.

Kjo përqindje e stokut të IHD-ve sipas shteteve do të përdoret për efekt të ponderimit të normave të interesit të borxhit dhe normës së tatim-fitimit.Meqenëse bizneset janë lidër në treg, atëherë mesatarisht tregu si real, si potencial, është i përafruar në vlerat e kthimit të kapitalit, ROE. Sipas publikimeve vjetore të Bankës Botërore, kosto e financimit me hua (në afatmesëm) për bizneset është 8.7%, ndërsa norma mesatare e huasë për disa nga shteteve: Greqi,Kanada,Itali,Holandë,Turqi, Austri, Gjermani, Qipro,SHBA, Zvicër dhe Francë(jo të gjithë shtetet e kanë të publikuar nga Banka Botërore këtë tregues), është 3.5% (kjo normë është potenciale për investitorët e huaj).Në llogaritjen e kostos mesatare të kapitalit një rol të rëndësishëm luan norma marxhinale e tatimit mbi fitimin. Sipas publikimeve vjetore të Bankës Botërore për Shqipërisë kjo normë është 9.5% në 2014 dhe 14.1% në 2015 (pra realiteti është 9.5%, por potenciali duhet të jetë perspektiva pra 14.1%). Ndërsa norma mesatare e ponderuar marxhinale e tatimit mbi fitimin sipas shteteve të listuar në tabelën 6 më lart, është 15.5% në 2014 dhe 15.7% në 2015 (vlera potenciale, me supozimin që kështu do të qëndrojë në afatmesëm në vazhdim).

Tabela 7. Kosto e kapitalit reale dhe potenciale për bizneset shqiptare ose të huaj.

Pronësia e biznesit	*Rezultati real (mesatar)*			*Rezultati potencial (mesatar)*		
	Kosto e borxhit K_B	*Kthimi i kapitalit ROE*	*Kosto mesatare e ponderuar*	*Kosto e borxhit K_B*	*Kthimi i kapitalit ROE*	*Kosto mesatare e ponderuar*
E huaj	8.7%[4]	19.3%	12.97%	3%	19.3%	10.08%
Shqiptare	9.7%	19.3%	12.88%	8.7%	19.3%	12.44%

Burimi: Llogaritje të autorit.

[4] *Supozohet se investitorët e huaj dinë të kombinojnë burimet e financimit në sajë të eksperiencës nga vendet e tyre të origjinës.*

Tabela 7 është plotësuar duke ndjekur supozimet dhe llogaritje si më vijim:

- Kthimi i kapitalit (ROE) = 23%*(48/123) + 17%*(75/123) = 19.3%, mesatarja e kthimit të gjitha kompanive sëbashku (sepse të 123 kompanitë e zgjedhura në studim, renditja e tyre sipas ROE nuk favorizon vetëm investimet e huaja). Kjo ROE do të jetë edhe potenciale sepse përfaqëson kompanitë më të suksesshme të tregut.
- Duke zbatuar formulën e saj, WACC (reale) për investitorët me kapital të huaj është 8.7%*(1-0.155)*0.53 + 19.3%*0.47 = 12.97%.
- Kosto e borxhit potenciale për investitorët me kapital të huaj, është marrë norma mesatare e financimit në vendet e origjinës së tyre me vlerë rreth 3% (nëse të gjitha burimet e financimit të investitorëve të huaj do të ishin nga vendet e origjinës).
- Duke zbatuar formulën e saj, WACC (potenciale) për investitorët me kapital të huaj është 3%*(1-0.157)*0.55 + 19.3%*0.45 = 10.8%.
- Kosto e borxhit në Shqipëriështë marrë norma e kreditimit 12-mujor në Shqipëri me vlerë 9.7% (Banka e Shqipërisë, Raporti Statistikor 6-mujor, 2015). E vetmja formë financimi në Shqipëri e përdorur gjerësisht nga bizneset është kredia për bizneset. Si normë vlerësimi është marrë norma e 3-mujorit të parë 2015, si vlerë më afër mbylljes së bilancit 2014.
- Duke zbatuar formulën e saj, WACC (reale) për investitorët me kapital shqiptar është 9.7%*(1-0.095)*0.61 + 19.3%*0.39 = 12.88%.
- Norma potenciale e kostos së financimit në Shqipëri është: normë bono thesari me maturitet 12 muaj (viti 2014) + primi i riskut të kredive = 8.7%.
- Duke zbatuar formulën e saj, WACC (potenciale) për investitorët me kapital shqiptar është 8.7%*(1-0.141)*0.58 + 19.3%*0.42 = 12.44%.

Tabela 7 më lart, vërteton hipotezën e punimit, ku bizneset e të njëjtit sektor me përfitueshmëri,kanë potencial më të madh konkurrues ata që janë me kapital të huaj, që të diversifikojnë koston e kapitalit krahasuar më kompanitë me kapital shqiptar. Kjo tregon potencialin konkurrues që kanë investitorëte huaj sidomos për ato kompani ose filiale të kompanive të huaja. Në këto kushtë, investitorët e huaj janë më të aftë që të konkurrojnë në lidhje me çmimin dhe cilësinë, në çmimet premium, në zbatimin e projekteve me interval më të gjerë rentabiliteti, etj.

5. Përfundime

Matja e kostos mesatare të kapitalit për bizneset e mëdha në Shqipëri, që u realizua përmes këtij punimi u kushtëzua nga shumë kufizime që janë rrjedhojë e tregut shqiptar, të tilla si: tregu i pamaturuar, mungesa e transparencës së të dhënave financiare (informaliteti ekonomik), mungesa e bursës së letrave me vlerë, kufizimet në alternativat e

financimit, risku politiko-ligjor, etj. Ndonëse kapmpionimi është bërë për 123 kompani lidër në treg (në aspektin e shitjeve vjetore) dhe përbën 123/830 = 14.8% e popullatës, ku 48 kompani janë me kapital të huaja dhe 75 kompani me kapital shqiptar. Sërish kufizimet e tregut në Shqipëri e rrisin shkallën e gabimit të rezultateve, por matjet në këtë punim shprehin nivelet më të sakta për metodën e ndjekur.Gjatë analizë së punimit arritëm në përfundimin që:

Së pari, bazuar në rezultatet e pasqyrave financiare të kompanive: bizneset me pronësi kapital të huaj kanë një raport borxhi (53%),d.m.th më të ulët sesa biznese me kapital shqiptar (61%), por me vlera jo shumë të shmangura nga niveli potencial. Ndërsa raporti i borxhit afatgjatë është shumë më i vogël sesa raporti i borxhit total (kjo sidomos për bizneset shqiptare), duke treguar për një prirje financimi me natyrë jo afatgjatë dhe të qëndrueshëm.

Së dyti, në ndryshim nga bizneset me kapital të huaj, bizneset me kapital shqiptar karakterizohen me një qëndrueshmëri statistikore të strukturës së tyre të kapitalit, por kjo strukturë nuk është optimale, sepse kosto e kapitalit të investuar nga bizneset shqiptare potencialisht është 12.44%, d.m.th kushton më shumë sesa për bizneset me kapital të huaj që është 10.08%. Bizneset me kapital të huaj kanë një avantazh shumë të rëndësishëm në efiçencë, që është diversifikimi i kostos së kapitalit, duke bërë që investitorët e huaj (filiale të kompanive të huaja mëmë) të jenë më të afta për të konkurruar në standarde prodhimi ose shërbimi dhe me politikën e çmimeve, si dhe duke qenë të aftë që të zbatojnë projekte me rentabilitet të ulët por fitimprurës për ta (ndërsa bizneset me kapital shqiptardo të dilnin me humbje nga këto projekte).

Duke vlerësimuar strukturën optimale të kapitalit dhe qëndrueshmërinë statistikore të parametrave të saj, si dhe me përcaktimin e vlerës së kostos mesatare të kapitalit si për bizneset me kapital të huaj ashtu edhe për bizneset me kapital shqiptar, ky punim ju vjen në ndihmë:

Së pari, menaxherëve financiar të bizneseve, për të ndërmarrë vendime efiçente investimi të analizuar nga kosto e kapitalit dhe lehtësisht të krahasueshëm me konkurrentët, apo përmbushjen e strategjive zhvillimore të biznesit dhe politikat përkatëse të financimit.

Së dyti, hartuesve të planeve të bizneseve, konsulencën financiare të kenë një metodë analize bazuar në koston e kapitalit e cila është baza e vendimeve financiare të teknikave të buxhetimit të kapitalit të investuar nga klientët e tyre.

Së treti, analistëve të kredive dhe riskut në banka,që të mos fokusohen vetëm në target-in e dhënies së kredive, por të jenë të kujdesshëm në analizat e financimit dhe kthimit të projekteve nga huamarrësit.

Gjithashtu ky studim i vjen në ndihmë edhe grupeve të tjera të interesit si: plotikave të qeverisjeve qëndrore dhe lokale, për të vlerësuar efiçencën e tregut

nga investimet e bizneseve, për të hartuar politika më konkrete dhe të matshme në efektivitetin e tyre.

Ky studim mbetet i hapur për analiza më të thelluara të kostos së kapitalit të investitorëve vendas dhe të huaj, në Shqipëri, duke e analizuar në nivel sektori dhe për madhësi të ndryshme të bizneseve, si dhe të shtrirë në kohë.

Referenca

Banka e Shqipërisë (2015). Raporti Statistikor.

Dougherty C. (2007); "Introduction to Econometrics". (3th ed.), Oxford Press.

Fama, E., & French. K. (2012). Capital Structure Choices. *Critical Finance Review*. Vol. 1, pp. 59 – 101.

Fosberg, R. (2012). Capital structure and the financial crisis. Journal of Finance and Accountancy. http://www.aabri.com/manuscripts/121213.pdf

Gitman, L., & Zutter, C. (2010). Principles of Managerial Finance. 13th Edition. Prentice Hall

Gujarati, D. (2004). Basic Econometrics. Fourth Edition. The McGraw−Hill.

Harris, M., & Raviv, A. (1990). Capital Structure and the Informational Role of Debt. The Journal Finance. Vol. 45, No. 2, pp. 321 – 349.

Heinkel, R. (1982). A Theory of Capital Structure Relevance under Imperfect Information. The Journal of Finance, Vol. 37, No. 5, pp. 1141 – 1150.

Hevert, R. (2014). In the matter of the application of public service company of New Mexico for revision of its retail electric rates pursuant to advice notice. No. 14-00332-UT. http://www.pnmresources.com/~/media/Files/P/PNM-Resources/rates-and-filings/11-dec-2014/32-direct-testimony-and-exhibits-of-robert-hevert.pdf

Ketchum, W., & Kim, J., (2013); "Determinig the Required Return on Equity (ROE) Value for Regulated Eletric Utilities: Challenges and Opportunities for Designing Regulatory Decision Support Tools". http://dukespace.lib.duke.edu/dspace/bitstream/handle/10161/6862/KetchumKim_MP.pdf?sequence=1

Leland, H., & Pyle, D. (1977). Informational Asymmetries, Financial Structure, and Financial Intermediation. *The Journal of Finance*, Vol. 32, No. 2, pp. 371 – 387.

Modigliani, F., & Miller, M. (1958). Corporate Income Taxes and the Cost of Capital: A Correction. *The American Economic Review*, Vol. 53, No. 3, pp. 433-443.

Modigliani, F., & Miller, M. (1958). The Cost of Capital, Corporation Finance and the Theory of Investment. *The American Economic Review*, Vol. 48, No. 3, pp. 261-297.

Myers, S. (1984). Capital structure puzzle. *The Journal of Finance*, Vol. 39, No. 3, pp. 574 - 592.

Rajan, R., & Zingales, L. (1995). What Do We Know about Capital Structure? Some Evidence from International Data. *The Journal of Finance*, Vol. 50, No. 5, pp. 1421-1460.

Ross, S., & Westerfield, R., & Jaffe, J. (2002). Corporate Finance. Sixth Edition. McGraw–Hill

Sharpe, W. F. (1964). Capital Asset Prices: A Theory of Market Equilibrium Under Conditions of Risk. *The Journal of Finance*, Vol. 19, No. 3, pp. 425 – 442.

Strebulaev, I., & Whited, T. (2012); "Dynamic Models and Structural Estimation in Corporate Finance". http://jrdonaldson.com/reading_group/Strebulaev-Whited.pdf

Titman, S., & Wessels, R. (1988). The Determinants of Capital Structure Choice. *The Journal Finance*. Vol. 43, No.1, pp. 1 – 19.

Treynor, J. L. (1962). "Toward a Theory of Market Value of Risky Assets". Unpublished manuscript. A Final version was published in 1999, in Asset Pricing and Portfolio Performance. Risk Books, pp. 15 – 22.

Vélez-Pareja, I., &Tham., J. (2000). A Note on the Weighted Average Cost of Capital WACC. Working Paper No. 10. http://pruss.narod.ru/WACC.pdf

ANEKSI NR. 1. Struktura e kapitalit, bizneset me kapital të huaj

Emërtimi i testit	*Rezultati i testit*
Multikolineriteti, testi: VIF (Variance Inflation Factors)	Sipas testit VIF të gjithë faktorët janë me vlerë më të vogël sesa 10 (me përjashtim të variablit MA). Variabli MA nuk do të përjashtohet nga modeli sepse ai është statistikisht i rëndësishëm nga t-test, sipas modelit fillestar
Autokorrelacion, testi: LM (Breusch-Godfrey)	Duke bërë kontrollin e autokorrelacionit me dy vonesa kohore (që sugjeron vetë testi), rezulton që modeli ynë ka autokorrelacion të mbetjeve. Por ky autokorrelacion rregullohet duke identifikuar lidhjen e mbetjeve ε_i me ε_{i-1}, pra me AR(1).
Heteroskedasticitet, testi: Breusch-Pagan-Godfrey	Sipas testit mbetjet e modelit nuk kanë heteroskedasticitet, d.m.th janë me shpërndarje homogjene konstante dhe të njëjtë me variablat e modelit.
Shpërndarja normale e mbetjeve ε, testi: Jarque-Bera	Sipas testit pranohet H_0. Modeli ka shpërndarje normale të mbetjeve.

Burimi: Testet janë rezultatet e marra nga testimet në Eviews 8, nga llogaritjet e autorëve.

ANEKSI NR. 2. Struktura e kapitalit, bizneset me kapital shqiptar

Emërtimi i testit	*Rezultati i testit*
Multikolineriteti, testi: VIF (Variance Inflation Factors)	Sipas testit VIF të gjithë faktorët janë me vlerë më të vogël sesa 10 (me përjashtim të variablit MA). Variabli MA do të mbahet në model për të respektuar modelin e vlerësimit të strukturës së kapitalit (shiko kreun II të punimit).
Autokorrelacion, testi: LM (Breusch-Godfrey)	Duke bërë kontrollin e autokorrelacionit me dy vonesa kohore (që sugjeron vetë testi), rezulton që modeli ynë ka autokorrelacion të mbetjeve. Por ky autokorrelacion rregullohet duke identifikuar lidhjen e mbetjeve ε_i me ε_{i-1}, pra me AR(1).
Heteroskedasticitet, testi: Breusch-Pagan-Godfrey	Sipas testit mbetjet e modelit nuk kanë heteroskedasticitet, d.m.th janë me shpërndarje homogjene konstante dhe të njëjtë me variablat e modelit.
Shpërndarja normale e mbetjeve ε, testi: Jarque-Bera	Sipas testit pranohet H_0. Modeli ka shpërndarje normale të mbetjeve.

Burimi: Testet janë rezultatet e marra nga testimet në Eviews 8, nga llogaritjet e autorëve.

Nga: Dr. Llesh Lleshaj, Prof. Asoc. Dr. Edlira Luçi, Doc. Dr. Alban Korbi, Departamenti i Financës, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës

RAPORTI PËRFUNDIMTAR
VLERËSIM I PAVARËSISË SË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT NGA KOLEGËT E INSTITUCIONEVE HOMOLOGE
(Peer – Review)

Objektivi i vlerësimit nga institucionet homologe ishte t'i jepnin Kontrollit të Lartë të Shtetit një vlerësim të përputhshmërisë me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) në lidhje me pavarësinë e SAI-ve (ISSAI 10: Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAI-ve; ISSAI 11: Udhëzime dhe praktika të mira në lidhje me pavarësinë e SAI-ve) si dhe të jepnin rekomandime për të përmirësuar pavarësinë e SAI-ve.

Hyrje dhe historiku

Sic theksohet në Deklaratën e Limës (1977) dhe Deklaratën e Meksikës (2007), si dhe në Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara A/66/209 (2011) dhe rezolutën A/69/228 (2015) të miratuar kohët e fundit, pavarësia e Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI-ve) është vendimtare për të garantuar mundësinë e kryerjes së punës në mënyrë të lirë dhe të paanshme dhe për të kontribuar në këtë mënyrë në mirë qeverisje, transparencë dhe llogaridhënie.

Për këtë qëllim, partnerët: Sekretariati i Përgjithshëm i Organizatës Ndërkombë-tare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), Kontrolli i Lartë i Shtetit Shqiptar (KLSH), Gjykata Austriake e Auditimit (GjAA) si dhe Gjykata e Llogarive e Moldavisë (GjLIM) ranë dakord të kryejnë një vlerësim të pavarësisë. Marrëveshja për vlerësimin nga institucionet homologe bazohet në parimet e vullnetarizmit, partneritetit dhe besimit reciprok.

Objektivat e Vlerësimit nga institucionet homologe

Objektivi i vlerësimit nga institucionet homologe ishte t'i jepnin Kontrollit të Lartë të Shtetit një vlerësim të përputhshmërisë me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI) në lidhje me pavarësinë e SAI-ve (ISSAI 10: Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAI-ve; ISSAI 11: Udhëzime dhe praktika të mira në lidhje me pavarësinë e SAI-ve) si dhe të jepnin rekomandime për të përmirësuar pavarë-sinë e SAI-ve. Kështu, u shqyrtuan edhe elementë qendrorë të ISSAI 12: Vlera dhe Dobitë e Institucioneve Supreme të Auditimit – Të bësh ndryshimin në jetën e qytetarëve. Rëndësia e këtyre çështjeve është vërtetuar nga Kombet e Bashkuara (Rezoluta A/69/228 e miratuar në vitin 2015) në promovimin dhe kujdesin për efiçencën, llogaridhënien dhe

transpare-ncën e administratës publike duke forcuar SAI-t.

Vlerësimi u përqendrua në tetë parimet e pavarësisë, sipas Deklaratës së Meksikës:

- ekzistenca e një kuadri efektiv ligjor
- pavarësia e drejtuesve dhe anëtarëve të SAI-ve
- mandat i gjerë legjislativ dhe liri e plotë veprimi në kryerjen e funksioneve të SAI-ve
- akses i pakufizuar në informacion
- e drejta dhe detyrimi për të raportuar mbi rezultatet e auditimit
- liria për të vendosur mbi përmbajtjen dhe kohën e raporteve të auditimit
- ekzistenca e një mekanizmi për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve
- autonomi financiare/menaxheriale/ administrative dhe burime të përshtatshme

Vizita në KLSH e grupit të vlerësimit u krye në shkurt të vitit 2016. Grupi i vlerësimit u përqendrua në situatën aktuale dhe në zhvillimet gjatë viteve 2013 - 2015. Fak- tet u mblodhën nëpërmjet një pyetësori, përgjatë diskutimeve me përfaqësues të KLSH-së dhe nga studimi i dokumenteve dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga KLSH. Për shkak se në anglisht ishin të disponueshme vetëm burimet më të rëndësishme të informacionit me shkrim, siç është legjislacioni, intervistat dhe diskuti- met me punonjësit e KLSH-së përbënë burimin kryesor të informacionit për grupin e vlerësimit. Gjetjet u plotësuan edhe nga diskutimet me palët e jashtme të intere-sit (shihni Shtojcën I).

Raporti është strukturuar si më poshtë:

(.1) citon parimin përkatës të Deklaratës së Meksikës;

(.2) konturon faktet e gjetura nga grupi i vlerësimit;

(.3) përmban vlerësime të gjetjeve të grupit të vlerësimit dhe panoramën e SAI-t të marrë në shqyrtim

Figura 1: Harta e Shqipërisë

Të dhëna kyçe

Shqipëria			
Sipërfaqja	27,400 km^2		
	2	**2**	**20**
Popullsia	2.90 Mil.	2.90 Mil.	2.89 Mil.
Rritja e popullsisë	-	-	-
PBB	12,320 Mil.	12,781 Mil.	13,212 Mil.
PBB për frymë	4,248 US$	4,411 US$	4,564 US$
Inflacioni, çmimet e konsumit	2.	1.	1.6

Kontrolli i Lartë i Shtetit			
Themeluar në	1925		
Baza ligjore	Kushtetuta e Shqipërisë		
	Ligji nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit		
Mandati i kryetarit të SAI-t	7 vjet		
Emërohet/zgjidhet nga	Parlamenti, me propozim të Presidentit të		
Riemërimi, nëse është i mundur	Po, një herë		
	2	**2**	**20**
Buxheti i shtetit sipas viteve	2,924	3,260 Mil.	3,260 Mil. EUR
Buxheti i SAI-t sipas viteve	2.08	2.65 Mil.	2.50 Mil. EUR
Buxheti i SAI-t në përqindje të buxhetit të	0	0.0	0.06
Personeli i SAI-t (ekuivalenti me kohë të plotë	1	1	171
Personeli: meshkuj/femra	1	10	101/
Mosha mesatare	4	4	43
Audituesit (ekuivalenti me kohë të plotë pune)	1 0	1 1	1 2

Buxheti për personelin sipas viteve	1.58	1.64 Mil.	1.71 Mil. EUR
Buxheti për personelin si përqindje e buxhetit	7	6	68
Kodi i etikës, është ekzistent dhe në përdorim	Po		
Ditë trajnimi për person	2	2	2
Auditime në vit	1	1	1
Reporte në vit	2	2	2
Publikime të rezultateve të auditimit	Po		
Kohëzgjatja mesatare e auditimit	3.5 muaj		
Kostoja mesatare e auditimit	14,803 EUR		
Auditime performance	Po		
Auditime financiare	Po		
Auditime përputhshmërie	Po		

1) 166 punonjës + 5 vende të paplotësuara Banka Botërore

Burimet: KLSH (kursi i këmbimit: 1 Euro = 140 Lek);

Vëzhgime mbi tetë parimet e pavarësisë sipas Deklaratës së Meksikës

Parimi 1

Ekzistenca e kuadrit ligjor të përshtatshëm dhe efektiv si dhe zbatimi de facto i parimeve të këtij kuadri

1.1 Kërkohet ekzistenca e një ligji që përcakton me hollësi shtrirjen e pavarësisë së SAI-t.

1.2 (1) Pavarësia, mandati dhe organizimi i Institucionit Suprem të Auditimit në Shqipëri (Kontrollit të Lartë të Shtetit) sanksionohen dhe mbrohen nga Kushtetuta dhe nga Ligji nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" (këtu e më poshtë referuar si Ligji për KLSH-në).

(2) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është miratuar me referendum në 22 nëntor 1998 dhe është ndryshuar në 13 janar 2007. Sipas Kushtetutës, Kontrolli i Lartë i Shtetit (Institucioni Suprem i Auditimit, këtu e më poshtë refe- ruar si KLSH) është insitutcioni më i lartë i auditimit ekonomik dhe financiar. Kushtetuta e Shqipërisë përmban dispozita në lidhje me Parimet 2, 3 dhe 5[1] të Deklaratës së Meksikës.

[1] *Kushtetuta përcakton edhe të drejtën e Kryetarit për të çuar çështje në Gjykatën Kushtetuese.*

(3) Hollësi rreth strukturës organizative të KLSH-së si dhe kompetencave e detyrave të tij, përfshirë mandatin e auditimit, përcaktohen në Ligjin për KLSH- në.

Ligji i ri për KLSH-në hyri në fuqi në shkurt 2015 dhe zëvendësoi ligjin e mëparshëm të vitit 1997[2].

(4) Ligji i ri për KLSH-në përmban dispozitat e mëposhtme:

Kreu I i titulluar "Dispozita të Përgjithshme" përfshin fushën dhe parimet e veprimtarisë së KLSH-së, përkufizimin e termave, rregullat e autonomisë buxhetore, të bashkëpunimit me institucione të tjera dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve lidhur me kompetencat e KLSH-së. Neni 4 i Ligjit për KLSH-në përcakton pavarësinë e KLSH-së dhe përcakton se ai i ushtron kompetenca në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. Neni 4 gjithashtu përcakton se KLSH-ja është organ i depolitizuar dhe nuk është i varur nga asnjë parti politike (Shihni Parimin 8).

Kreu II, i titulluar "Kompetencat, të drejtat dhe detyrat" përcakton që KLSH- ja vendos për planin e auditimeve në mënyrë të pavarur. Ky kapitull përfshin mandatin e KLSH-së dhe llojet e auditimeve (auditimin financiar, të performancës, të përputhshmërisë dhe auditimin e TI-së). Gjithashtu, përcakton të drejtat, kompetencat dhe detyrat e KLSH-së, marrëdhënien me auditin e brendshëm dhe sistemet e kontrollit. KLSH ka të drejtë të rekomandojë ndryshime apo anulime të akteve ligjore që janë në kundërshtim me njëri– tjetrin apo nuk janë në përputhje me një akt ligjor të një niveli më të lartë ose me Kushtetutën e Shqipërisë[3].

KLSH-ja ka gjithashtu të drejtë të informojë drejtuesit e entit të audituar apo të institucioneve më të larta rreth shkeljeve ligjore materiale dhe të hartojë rekomandime, p.sh.: të ndërmarrë masa strukturore e organizative, përfshirë nisje të procedurës administrative apo disiplinore. Për më tepër, KLSH-ja ka të drejtë t'u drejtohet organeve të hetimit penal apo gjykatës për procedim penal.

– Ky kre gjithashtu parashikon bazën ligjore për raportin vjetor mbi zbatimin e buxhetit të shtetit dhe mekanizmin e ndjekjes nga KLSH (shihni Parimet 3, 5 dhe 7).

Kreu III, i titulluar "Kryetari i KLSH-së" përcakton zgjedhjen dhe mandatin e Kryetarit, kriteret e përzgjedhjes, imunitetin, mandatin dhe përgjegjësitë e tij (shihni Parimin 2).

Kreu IV, i titulluar "E drejta e disponimit të dokumenteve dhe informacionit" përcakton të drejtat e KLSH-së në lidhje me subjektet e audituara përsa i përket disponimit të informacionit dhe dokumentacionit që konsiderohet i nevojshëm për kryerjen e punës së saj. Ky kapitull përfshin hollësi rreth trajtimit të çështjeve që përfshijnë sekrete shtetërore apo informacion kon- fidencial. KLSH ka të drejtën e disponimit të të gjitha dokumenteve zyrtare që konsiderohen të

[2] *Ligji nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit"*

[3] *E drejta e KLSH-së për të nisur procedim në Gjykatën Kushtetuse shprehet në nenin 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.*

nevojshme për ushtrimin e kompetencave dhe detyrave ligjore. Në rastin e akteve apo përjashtimeve që janë në shkelje të këtyre të drejtave apo në rast se veprimtaria apo puna e KLSH-së pengohet, KLSH-ja ka të drejtë t'i referojë çështjet tek organi më i lartë administrativ ose në organet e pushtetit gjyqësor (shihni Parimet 3 dhe 4)

Kreu V, i titulluar "Raportet e kontrollit" trajton çështje që lidhen me të drejtat e subjekteve të audituara për të dorëzuar komentet dhe observacionet e tyre si dhe me raportin e KLSH-së që paraqitet në Kuvend dhe në institu- cione të tjera të interesuara (shihni Parimet 3, 5, 6 dhe 7)

Kreu VI, i titulluar "Organizimi, struktura dhe statusi i punonjësve" trajton çështje që lidhen me të drejtat dhe detyrimet e punonjësve të KLSH-së, kriteret dhe procedurat për rekrutimin e këtyre punonjësve, të drejtën për të kontraktuar përkohësisht ekspertë të jashtëm si dhe rregullat për shman- gien e konfliktit të interesit (shihni Parimet 3 dhe 8).

Kreu VII, i titulluar "Dispozita përfundimtare" përfshin dispozita që lidhen me miratimin e rregulloreve, manualeve, udhëzimeve, Kodin e Etikës, si dhe shfuqizimin e Ligjit të mëparshëm nr. 8270 dhe hyrjen në fuqi të ligjit të ri të KLSH-së (shihni Parimin 3).

(5) Në përmbledhje të sa më sipër, Kushtetuta dhe Ligji për KLSH-në mbulojnë të gjitha Parimet e Deklaratës mbi Pavarësinë e Institucioneve Supreme të Auditimit. Zbatimi de facto i dispozitave të këtij kuadri është i përcaktuar shumë mirë. Hollësi të mëtejshme do të shtjellohen në pjesët që trajtojnë specifikisht secilin parim.

1.3 Grupi i Vlerësimit vuri re se pavarësia, kompetencat dhe organizimi i KLSH-së janë ligjërisht dhe de facto të përcaktuara dhe të mbrojtura nga Kushtetuta dhe nga Ligji për KLSH-në. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për KLSH-në në vitin 2015, KLSH konstatoi një përmirësim të konsiderueshëm në krahasim me përcaktimet e ligjit të mëparshëm. Grupi i Vlerësimit gjeti një kuadër të miratuar ligjor të përshtatshëm dhe të efektshëm, në përputhje me Deklaratën e Meksikës.

Megjithatë, Grupi i Vlerësimit vuri re se disa çështje kyçe që garantojnë pavarësinë e KLSH-së parashikohen në Ligjin e KLSH-së, në vend që të jenë të sanksionuara në Kushtetutën e Shqipërisë. Çështje të tilla si: aksesi i pakufizuar i informacionit, pavarësia në përzgjedhjen e temave të auditimit, kërkesat e raportimit apo pavarësia financiare nuk parashikohen në Kushtetutë, por në Ligjin e KLSH-së.

Meqenëse Kushtetuta është më pak e prirur ndaj ndryshimeve për shkak të kërkesës më strikte të miratimit me shumicë votash, Grupi i Vlerësimit rekomandon që të gjitha parakushtet që konsiderohen të doemos-doshme për pavarësinë e KLSH-së të përfshihnien në Kushtetutë, siç kërkohet nga Deklarata e Limës, Seksioni 5, paragrafi 3

Parimi 2

Pavarësia e drejtuesve dhe anëtarëve (të institucioneve kolegjiale) të SAI-ve, përfshirë sigurinë e kohës së qendrimit në detyrë dhe imunitetin ligjor në kryerjen normale të detyrave të tyre

2.1 Legjislacioni i zbatueshëm duhet të specifikojë kushtet për emërimin, ri – emërimin, punësimin, shkarkimin dhe daljen në pension të Kryetarit të KLSH-së (dhe anëtarëve të institucioneve kolegjiale), i cili/e cila:

- Emërohet, ri emërohet apo shkarkohet nëpërmjet një procesi që garanton sigurinë e tij/saj/tyre nga ekzekutivi;
- Emërohet për mandate mjaftueshëm të gjata dhe fikse që i mundëson atij/ asaj/atyre të kryejnë detyrën pa pasur frikë nga ndëshkimet; dhe

– Gëzon imunitet ndaj ndjekjes penale për çdo veprim të shkuar apo aktual që rezulton nga kryerja normale e detyrave të tij/saj/tyre, sipas rastit. 2.2

2.2 (1) Neni 162 paragrafi 2 i Kushtetutës parashikon emërimin dhe shkarkimin e Kryetarit të KLSH-së nga Kuvendi me propozim të Presidentit të Republikës. Kuvendi vendos për emërimin e Kryetarit të KLSH-së me shumicë të thjeshtë votash[4].

Ligji i KLSH-së, në nenet 20 deri në 25 të tij, përcakton më tej rregullat për emërimin, të drejtat dhe detyrat si dhe shkarkimin e Kryetarit; neni 23 nuk përcakton në mënyrë të qartë numrin e saktë të shumicës së votave që kërkohen.

(2) Kriteret e përzgjedhjes së Kryetarit përcaktojnë nivelin e arsimimit dhe një përvojë të caktuar profesionale si dhe kërkesën për dëshmi të pastër penaliteti dhe integritet të lartë moral dhe profesional. Ky ligj nuk parashikon procedurën zyrtare për konstatimin e përmbushjes ose jo të këtyre kritereve, por ia le këtë vlerësim deputetëve të Kuvendit.

3) Ligji i KLSH-së përcakton se funksioni i Kryetarit të KLSH-së është i papajtueshëm me funksione politike apo punësim në subjekte publike apo private, me përjashtime të vogla të përcaktuara qartë të mësimdhënies, botimeve dhe veprimtarive kulturore dhe sportive, me kusht që këto aktivitete të mos cënojnë paanshmërinë dhe pavarësinë e Kryetarit.

(4) Neni 19 i Ligjit për KLSH-në specifikon më tej se Kryetari drejton dhe përfaqëson KLSH-në dhe se paga e tij është e barabartë me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë që do të thotë se paga e Kryetarit është e barabartë me 120% të rrogës së një ministri.

(5) Mbarimi i mandatit të Kryetarit rregullohet specifikisht me nenin 23 të Ligjit për KLSH-në, në paragrafin e parë të së cilit shprehen arsyet e mbarimit automatik të mandatit[5] dhe në paragrafin e dytë shprehen arsyet për të cilat Kuvendi mund të shkarkojë Kryetarin nga detyra, me propozim të Presidentit[6].

[4] *Neni 78 i Kushtetutës parashikon gjithashtu se Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së 140 anëtarëve të tij.*

[5] *Arsyet për përfundimin e mandatit automatikisht janë: mbarimi i afatit shtatëvjeçar të qendrimit në detyrë, një vendim i i formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një krimi, mosparaqitje në detyrë për shkaqe të paarsyeshme, dorëheqja e Kryetarit, vendim gjykate i formës së prerë që e deklaron të paaftë për të vepruar, mbushja e moshës së pensionit, vdekja.*

[6] *Një vendim i tillë mund të merret në rast se Kryetari shkel Kushtetutën ose shkel rëndë*

Dispozitat ligjore janë të ngjashme me ato të shkarkimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, megjithatë, ka ndryshime të dukshme: neni 23 paragrafi 1 i Ligjit për KLSH-në ka një mbivendosje për faktin që parashikon përfundimin automatik të mandatit të Kryetarit kur dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, megjithatë neni 23 paragrafi 2 i Ligjit për KLSH-në i jep gjithashtu të drjetën Kuvendit të shkarkojë Kryetarin në një rast të tillë.

Neni 23 i Ligjit për KLSH-në gjithashtu parashikon mbarimin e mandatit të Kryetarit në rastin e mosparaqitjes në detyrë pa arsye. Megjithatë, kjo dispozitë nuk parashikon një periudhë kohore të kësaj mungese të paarsyeshme, ndërkohë që në Kushtetutë dhe në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese përcaktohet periudha kohore prej gjashtë muajsh mosparaqitjeje në detyrë për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese.

Pas përfundimit të mandatit, Kryetari qendron në detyrë deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri. Ai ka të drejtë të rikthehet në detyrën e mëparshme ose në një detyrë të barasvlershme me të (neni 24 i Ligjit për KLSH-në).

(7) Sipas nenit 22 të Ligjit për KLSH-në, Kryetari gëzon të njëjtin imunitet si gjyqtari i Gjykatës së Lartë dhe më tej shtohet se imuniteti i Kryetarit shtrihet deri në mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij. Sipas ligjit, Kryetari nuk mund të arrestohet apo t'i hiqet liria, përveçse nëse kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi; në raste të tilla vihet menjëherë në dijeni Gjykata Kushtetuese, e cila jep pëlqimin për arrestim brenda 24 orëve. Mosdhënia e pëlqimit nga Gjykata Kushtetuese çon në lirimin e Kryetarit.

(8) Dy Kryetarët e mëparshëm të KLSH-së kanë qenë në detyrë për mandate të plota shtatëvjeçare; deri më tani nuk ka patur raste të ndërprerjes së parakohshme të mandatit apo të shkarkimit nga Kuvendi. Më tej, asnjëri nga dy Kryetarët e mëparshëm nuk është emëruar për një mandat të dytë.

2.3 Grupi i Vlerësimit vëren se kuadri ligjor mbulon të gjitha aspektet e emërimit, kryerjes dhe përfundimit të funksionit të Kryetarit të KLSH-së si dhe të karrierës së mëtejshme profesionale pas përfundimit të mandatit. Rregullat për emërimin, shkarkimin dhe kohëzgjatjen e mandatit përcaktohen në Kushtetutë, pra në nivelin më të lartë ligjor dhe Ligji për KLSH-në specifikon më tej aspekte të funksionit dhe mandatit të Kryetarit. Grupi i Vlerësimit vëren se rregullat për papajtueshmërinë e funksionit të Kryetarit me funksione të tjera politike dhe ekonomike gjithashtu shërbejnë për forcimin e transparencës dhe besimit të popullit në pavarësinë e Kryetarit të KLSH-së.

Dispozitat ligjore për zgjedhjen, rizgjedhjen dhe shkarkimin e Kryetarit me anë të votimit në Kuvend, me propozim të Presidentit

ligjin, cilësohet nga Gjykata me vendim të formës së prerë si i paaftë për të kryer detyrat e tij, në rast se dënohet nga gjykata me vendim të forms së prerë për kryerjen e një krimi, në rast se kryen akte ose sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e tij, dhe në rast se zbulohen raste të papajtueshmërisë së funksionit të Kryetarit.

parashikojnë pavarësinë e Kryetarit nga ekzekutivi. Grupi i Vlerësimit vëren se Ligji për KLSH-në nuk specifikon shumicën e votave që kërkohet për shkarkimin e Kryetarit. Megjithatë, KLSH gjykon se Kryetari gëzon të njëjtin lloj imuniteti si gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, shkarkimi i të cilëve bëhet me shumicë të cilësuar votash.

Përsa i përket kohëzgjatjes së mandatit, edhe pse mandati shtatëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje një herë, është më i gjatë se sa kohëzgjatja e një legjislature të rregullt, mandati i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë është nëntëvjeçar, megjithëse pa të drejtë rizgjedhjeje. Sidoqoftë, meqenëse Deklarata e Meksikës kërkon një mandat mjaftueshëm të gjatë dhe të përcaktuar, Grupi i Vlerësimit vëren se KLSH është në pajtueshmëri me Deklaratën e Meksikës.

Grupi i Vlerësimit vëren se rregulli, sipas të cilit Kryetari mund të rikthehet në funksionin e mëparshëm pas përfundimit të mandatit të plotë, është një masë për të forcuar pavarësinë e Kryetarit

Rregullat për shkarkimin e Kryetarit në rastin e mungesës së tij në detyrë si dhe në rastin e dënimit për kryerjen e një krimi, nuk duken mjaftueshëm të qarta e të sakta. Përfundimi automatikisht i mandatit të Kryetarit për shkak të mungesës së pajustifikuar për një periudhë të papërcaktuar duket problematik për shkak të pa- sigurisë juridike në rastin e një mungese në detyrë, pavarësisht kohëzgjatjes së saj. Për më tepër, pasojat ligjore të një dënimi për një krim të kryer nga Kryetari çojnë automatikisht në përfundimin e mandatit, por në të njëjtën kohë i japin Kuvendit të drejtën e shkarkimit të Kryetarit. Me synim rritjen e sigurisë juridike, Grupi i Vlerësimit rekomandon që KLSHtë rrisë ndërgjegjësimin rreth kësaj paqartësie me qëllim kërkimin e saktësimit të mëtejshëm të këtyre dispozitave.

Rregullat për imunitetin e Kryetarit korrespondojnë me ato për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe përmbushin kërkesat e Parimit 2 të Deklaratës së Meksikës.

Parimi 3

Mandat gjerësisht i mjaftueshem dhe liri e plotë veprimi në kryerjen e funksioneve të SAI-ve

3.1 SAI-të duhet të kenë mundësinë të auditojnë:

- Përdorimin e parave, burimeve apo pasurive publike nga marrësi apo përfitue- si i tyre pavarësisht natyrës së tij ligjore;
- Mbledhjen e të ardhurave nga qeveria apo subjektet publike;
- Ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e llogarive të qeverisë apo subjekteve publike;
- Cilësinë e menaxhimit dhe raportimit financiar; dhe
- Ekonomicitetin, efiçencën dhe efektivitetin e punës së qeverisë dhe subjekteve publike.

Përveçse kur kërkohet specifikisht me ligj, SAI-t nuk auditojnë politikat qeveritare apo politikat e subjekteve publike; puna e tyre është e kufizuar në auditimin e zba- timit të politikave.

SAI respekton ligjet e miratuara nga organet ligjvënëse, por është i çliruar nga dre- jtimi

apo ndërhyrja e organeve ligjvënëse apo ekzekutive, në

- përzgjedhjen e çështjeve të auditimit;
- planifikimin, programimin, kryerjen, raportimin dhe ndjekjen e auditimeve;
- organizimin dhe drejtimin e institucionit; dhe
- kërkimin e zbatimit të vendimeve të tij, kur mandati i mundëson zbatimin e sanksioneve.

SAI nuk duhet të përfshihet, apo të shihet që përfshihet në ndonjë mënyrë, çfarë- doqoftë ajo/ në mënyrën e drejtimit të organizatave që auditon.

SAI duhet të sigurohet që personeli i tij nuk zhvillon marrëdhënie shumë të afërta me subjektet që auditojnë, në mënyrë që të ruajnë dhe shfaqin objektivitetin.

SAI duhet të ketë liri të plotë në përmbushjen e përgjegjësive, duhet të bashkëpunojë me qeverinë dhe subjektet publike që punojnë për përdorimin dhe menaxhimin e fondeve publike.

SAI duhet të përdorë standarde të përshtatshme pune dhe auditimi si dhe një kod etike të bazuar në dokumentet zyrtare të INTOSAI-t, Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve si dhe të organeve të tjera të njohura të përcaktimit të standardeve.

SAI duhet të dorëzojë në organin ligjvënës dhe në organe të tjerë shtetërorë një raport vjetor të veprimtarisë së tij siç kërkohet në kushtetutë, statute apo në leg- jislacion dhe duhet ta bëjë atë të disponueshme për publikun.

3.2 (1) Detyrat e KLSH-së përcaktohen në Kushtetutë dhe gjithashtu në Ligjin për KLSH-në. Neni 163 i Kushtetutës përcakton se KLSH duhet të auditojë e shqyrtojë:

1. veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore dhe të enteve të tjerë ligjorë të shtetit;

2. përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e qeverisjes qendrore dhe asaj vendore;

3. veprimtarinë ekonomike të personave juridikë në të cilat shteti ka më shumë se gjysmën e interesit dhe huatë, kreditë dhe detyrimet e të cilave garanto- hen nga shteti.

(2) Mandati përcaktohet në nenin 10[7]e në vijim të Ligjit për KLSH-në. Për hollësi, shihni tabelën e mëposhtme:

[7] Neni 10 i Ligjit për KLSH-në përcakton se KLSH ka kompetencë:
a) auditimin e zbatimit të buxhetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, duke përfshirë llogaritë vjetore të buxhetit;
b) auditimin e mbledhjes së të ardhurave publike;
c) auditimin e përdorimit, administrimit dhe mbrojtjes së fondeve publike dhe pronës publike apo shtetërore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme;
d) auditimin e pasqyrave financiare për njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe dhënien e opinionit për to;
e) auditimin e sistemeve të auditimit të brendshëm të sektorit publik
f) auditimin e përdoruesve të fondeve publike të ofruara nga Bashkimi Evropian ose organizata të tjera ndërkombëtare, me përjashtim të rasteve kur është parashikuar ndryshe me ligj të veçantë;
g) auditimin e subjekteve të tjera, të përcaktuara në ligje të veçanta.

Tabela 1: Mandati i KLSH-së në lidhje me Parimin 3, paragrafin 1 dhe 2 të Deklaratës së Meksikës

SAI-t duhet të kenë mundësi të auditojnë...	Miratimi &Pasqyrimi	Përshkrimi	Zbatimi
... përdorimin e parave, burimeve apo pasurive publike nga marrësi apo përfituesi i tyre pavarësisht natyrës së tij ligjore;	Neni 15 i Ligjit për KLSH-në	(...) ente ku qeveria ka më shumë se 50% të aksioneve	në varësi të llojit të auditimit, shihni Manualet e përmendura më poshtë
... mbledhjen e të ardhurave nga qeveria apo subjektet publike;	Neni 10 i Ligjit për KLSH-në	është kompetencë e KLSH-së të auditojë mbledhjen e të ardhurave publike	në varësi të llojit të auditimit, shihni Manualet e përmendura më poshtë
... ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e llogarive të qeverisë apo subjekteve publike;	Neni 12 i Ligjit për KLSH-në	KLSH përcakton: a) nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në linjë me ligjin për buxhetin e shtetit, me aktet ligjore të përshtatshme dhe me pari-met e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të menaxhimit financiar në sektorin publik si dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik.	Manuali i Auditimit të Performancës është miratuar. Përkthimi, botimi dhe shpërndarja e ISSAI-ve
...cilësinë e menaxhimit dhe raportimit financiar	Neni 11 i Ligjit për KLSH-në (Auditimi financiar)	Auditim financiar nënkupton një vlerësim të pavarur që rezulton në një opinion me siguri të arsyeshme, nëse gjendja e raportuar financiare e një subjekti të audituar, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe në për- puthje me kuadrin ligjor të raportimit financiar.	Manuali ekzistues i Auditimit Financiar (jo në përputhshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare); Manuali i ri i Auditimit Financiar është miratuar, por nuk është vënë në zbatim. Përtkhimi, botimi dhe shpërndarja e ISSAI-ve

...Ekonomicitetin, efiçencën dhe efektivitetin e punës së qeverisë dhe subjekteve publike.	Neni 13 i Ligjit për KLSH-në (Auditimi i Performan cës)	KLSH duhet të vlerësojë nëse programet, organizimi i punës dhe proceseve, veprimtaritë dhe sistemet e menaxhimit të subjekteve të sektorit publik operojnë në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efiçencës dhe efektivitetit.	Treguesit e Performancës në vitin 2015, Manuali i Auditimit të Performan- cës; Përkthimi, botimi dhe shpërndarja e ISSAI-ve
Përveçse kur specifikisht kërkohet me ligj, SAI-t nuk auditojnë politikat qeveritare apo politikat e subjekteve publike; puna e tyre është e kufizuar në	KLSH-ja nuk auditon politikat qeveritare apo ato të enteve publike	Ligji për KLSH-në nuk përmban ndonjë dispozitë të veçantë në lidhje me auditimin e politikave	në veprimtarinë e saj audituese, KLSH përqendrohet në auditimin e zbatimit të politikave

(3) Kufizimet në lidhje me kompetencat gjenden në nenin 26 të Ligjit për KLSH-në:

KLSH-ja nuk ka kompetencë auditimi të disa prej enteve ligjore në të cilat shteti ka më pak se 50% të aksioneve. Si rrjedhojë, KLSH-ja nuk mund të auditojë partneritetet publike – private të enteve shtetërore me kompanitë private. Në këto raste KLSH mund të auditojë vetëm kontratat që kanë të bëjnë me partne- ritetin publik – privat, institucionin shtetëror kontraktues si dhe performancën e kontabilitetin e kontratës. Për më tepër, në Shqipëri disa shërbime publike u kalohen kompanive private në bazë të një kontrate.

Kompetencat e KLSH-së përfshijnë auditimin e administratës tatimore. Auditimi i çështjeve individuale tatimore është i përjashtuar. Kompetencat e KLSH-së gjithashtu përfshijnë auditimin e çështjeve që përmbajnë sekret shtetëror. Për më shumë hollësi shihni Parimin 4.

(4) KLSH-ja ka nisur kryerjen e auditimeve të performancës në vitin 2012 që çoi dhe në krijimin e departamentit të auditimit të performancës. Për të forcuar pozitën e tij brenda KLSH-së, ky departament u ngrit si njësi e specializuar nën varësi direkte të Kryetarit.

KLSH-ja ka nisur kryerjen e auditiveve të TI vetëm kohët e fundit.

Për më tepër, KLSH-ja nuk auditon partitë politike, edhe pse një gjë e tillë është në kompetencat e saj.

(5) Për më shumë hollësi në lidhje me kompetencat dhe planin e auditimit, shihni tabelën e mëposhtme:

Tabela 2: Kompetencat e KLSH-së në lidhje me Parimin 3, paragrafi 3 të Deklaratës së Meksikës

ISSAI 10 Parimi 3 SAI respekton ligjet e miratuara nga organet ligjvënëse, por është i çliruar nga drejtimi apo ndërhyr-ja e organeve ligjvënëse apo ekzekutive, në ...	Miratimi & Pasqyrimi	Përshkrimi	Zbatimi
...përzgjedhjen e çështjeve të auditimit.	Neni 9 i Ligjit për KLSH-në	KLSh-ja vendos në mënyrë të pavarur, në çdo moment lidhur me planin e aktiviteteve. Gjatë procesit, mund të marrë në konsideratë propozimet e subjekteve të tjera qeveritare.	Është proces i organizuar. Në përgjithësi, ka një analizë të bazuar në risk dhe nevojat e publikut mund të merren parasysh.
...planifikimin, programi-min, raportimin dhe ndjekjen e auditimit.	planifikimi: neni 9 kryerja: neni 26 raportimi: neni 31, neni 32, ndjekja: neni 30 i Ligjit për KLSH-në	Raportimi: në lidhje me auditime të caktuara, vetë KLSH i ka kërkuar Kuvendit t'i raportojë mbi veprimtarinë e saj përsa u përket gjetjeve dhe observa- cioneve të paraqitura në raport, në lidhje me nenin 31/2 Ndjekja: brenda 6 muajsh pas evadimit të raportit përfundimtar, subjekti i audituar i raporton KLSH-së në lidhje me masat e marra për përmbushjen e rekomandimeve të KLSH-së.	një vendim i brendshëm i Kryetarit; Ligji për KLSH-në pasqyron ISSAI 1260
...organizimin dhe drejtimin e zyrës.	Neni 25 i Ligjit për KLSH-në	Kryatri ka të drejtë të vendosë për strukturën e KLSH-së si dhe për kompetencat dhe detyrat e njësive organizative.	Rregullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së, nr. 85, datë 30.06.2015

... kërkimin e zbatimit të vendimeve të tij, kur mandati i mundëson zbatimin e sanksioneve.	Neni 15 i Ligjit për KLSH-në	(1) KLSH ka të drejtë të referojë çështje në prokurori, nëse çështje të tilla janë në kompetencë të prokurorisë; të drejtë të padisë në gjykatë; (2) KLSH ka të drejtë të përcaktojë afate kohore për raportimin brenda 20 ditëve pas datës së evadimit të raportit përsa u përket planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve; në rast mosveprimi ka të drejtë ta ngrejë çështjen deri në niveli më të lartë të autoriteteve shtetërore; (3) t'i propozojë Komisionit parlamentar për ekonominë dhe financën të hetojë më tej në lidhje me raporte auditimi të veçanta, etj.	

(6) Sipas nenit 9 të Ligjit për KLSH-në, KLSH vendos në mënyrë të pavarur për planin e veprimtarisë së tij. KLSH mund të marrë në konsideratë propozimet e bëra nga njësitë e tjera të qeverisjes së përgjithshme, por nuk është e detyruar të ndërmarrë veprime në lidhje me to; Kryetari ka të drejtë të vendosë nëse KLSH do t'i marrë në konsideratë apo jo këto propozime.

(7) Përsa i përket mospërfshirjes në drejtimin e organizatave të audituara, neni 21 i Ligjit për KLSH-në përcakton papajtueshmëritë e funksionit të Kryetarit me funksione të tjera. Për hollësi të mëtejshme shihni Parimin

Që të sigurohen se personeli i KLSH-së nuk ndërton marrëdhënie të afërta me subjektet e audituara, audituesit nuk mund të pranojnë kompetenca politike apo të jenë anëtarë aktivë të ndonjë partie a organizate politikedhe nuk duhet të kryejnë aktivitete me natyrë politike apo tregtare. Përjashtim nga ky kufizim bëjnë mësimdhënia, botimi dhe aktivitete kulturore e sportive, me kusht që ato aktivitete të mos dëmtojnë dinjitetin e institucionit dhe të mos cënojnë paansh-mërinë dhe pavarësinë e tij.

Kryetari është përgjegjës për nxjerrjen e vendimeve të brendshme në raste të jashtëzakonshme të papajtueshmërisë me funksionet e auditimit. Në rast se vi- hen re

këto lloj papajtueshmërish, nis procedura disiplinore. Audituesit duhet të kryejnë detyrën e tyre me skepticizëm profesional, në përputhje me kërkesat e Ligjit për KLSH-në, Rregulloren e Brendshme të KLSH-së, Standartet e Auditimit si dhe Kodin e Etikës.

(8) Sipas kodit të Etikës, audituesit kanë një detyrim njoftues. Përpara se të nisin një auditim, audituesit duhet të plotësojnë një deklaratë ku dëshmojnë që nuk kanë konflikt interesi, e cila bëhet pjesë e dosjet së auditimit. Kodi i Etikës është në përputhje me draftin e ISSAI-t të ri 30. Çdo punonjësi i ri duhet të lexojë Kodin e Etikës, ta diskutojë me kolegët e departamentit dhe gjithashtu për Kodin e Etikës flitet edhe në trajnimin për personelin e ri.

(9) Neni 164 i Kushtetutës[8] dhe neni 31 i Ligjit për KLSH-në përcaktojnë që KLSH paraqet në Kuvend raportin mbi veprimtarinë vjetore. Për hollësi të mëtejshme shihni Parimin 6.

3.3 Sipas mendimit të Grupit të vlerësimit, KLSH ka mandat të gjerë në përputhje me Deklaratën e Meksikës.

Grupi i Vlerësimit pyeti në lidhje me mundësinë e auditimit të kompanive private që kryejnë funksione e detyra publike dhe vëren se kjo nuk është në kompetencat e auditimit. Grupi i Vlerësimit i rekomandoi KLSH-së të rrisë ndërgjegjësimin e organit ligjvënës për boshllëkun e auditimit në raste të tilla.

Që me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, KLSH ka pasur mundësi të zgjedhë ndërmjet llojeve të ndryshme të auditimit, çka e ka bërë KLSH-në më të pavarur, veçanërisht në lidhje me planifikimin e auditimit dhe përzgjedhjen e çështjeve të auditimit. Grupi i Vlerësimit ishte në dijeni se KLSH-ja përpiqet të forcojë auditimet e performancës dhe për këtë qëllim, u ngrit departamenti i auditimit të performancës si një njësi e specializuar nën varësi në Kryetarit.

Grupi i Vlerësimit rekomandoi që KLSH të vazhdojë të forcojë kapacitetin dhe njohuritë e punonjësve për të fituar njohuri të tjera e forcuar përvojën praktike për llojet e reja të auditimit.

Grupi i Vlerësimit vëren se KLSH kohët e fundit ka filluar të kryejë auditime të TI-së dhe se KLSH nuk ka nisur të auditojë partitë politike, edhe pse një gjë e tillë është kompetencë e saj. Grupi i Vlerësimit rekomandon që auditimet e KLSH-së të mbulojnë të gjitha kompetencat e saj.

Grupi i Vlerësimit vëren se Manuali ekzistues i Auditimit Financiar nuk është tërësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe se një Manual i ri i Auditimit Financiar që është në përputhje me ISSAI-të është miratuar, por nuk është vënë ende në zbatim. Grupi i Vlerësimit rekomandon që KLSH të vendosë në zbatim Manualin e ri të Auditimit Financiar sa më shpejt të jetë e mundur.

---

[8] *Neni 164 i Kushtetutës thotë*
KLSH i paraqet Kuvendit:
a) raport për zbatimin e buxhetit;
b) mendim për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi
c) informacion për rezultatet e kontrolleve sa here që kërkohet nga Kuvendi.
KLSH i paraqet Kuvendit raportin vjetor të veprimtarisë së tij.

Grupi i Vlerësimit është në dijeni të faktit që Kodi i Etikës është në përputhje me ISSAI-n e ri 30 dhe se KLSH-ja ka disa mekanizma për të siguruar njohjen e të gjithë personelit të KLSH-së me Kodin e Etikës.

Parimi 4

Akses i pakufizuar në informacion

4.1 SAI duhet të ketë autoritet të mjaftueshëm për të patur akses në kohë, të papenguar, të drejtpërdrjetë dhe të lirë tek të gjitha dokumentet dhe informacioni i nevojshëm për përmbushjen në mënyrë të përshtatshme të të gjithë përgjegjësive të saj.

4.2 (1) Baza ligjore për aksesin e informacionit nga KLSH përcaktohet në nenet 26 deri në 28 të Ligjit për KLSH-në. Këto nene përcaktojnë se KLSH ka të drejtë për të pasur akses në të gjitha dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave si dhe në çdo informacion apo dokumentacion tjetër të subjekteve të audituara të parashikuara me ligj, që mund të përbëjë sekret shtetëror apo konfidencial dhe që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore. KLSH është e detyruar të mbrojë konfidencialitetin e informacioneve të siguruara nëse ato mbrohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

(2) Neni 26 i Ligjit për KLSH-në parashikon se KLSH mund t'i drejtohet organit më të lartë administrativ dhe/ose organeve të pushtetit gjyqësor në rast të hasjes së pengesave në aksesin për informacion nga ana e subjekteve të audituara. Në praktikë, KLSH në një rast të tillë ankohet tek enti/organizata epror(e) i subjektit të audituar; nëse kjo gjë nuk con në sigurimin e informacionit të nevojshëm, atëherë KLSH mund ta referojë entin në prokurori sipas nenit 235 të Kodit Penal, i cili e ndalon "kundërshtimin e një punonjësi, i cili kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik."

(3) Në krahasim me ligjin e mëparshëm, Ligji për KLSH-në ofron mundësinë për të audituar bartësit e informacionit dhe informacionin e marrë nga mediat, KLSH e konsideron të nevojshëm për auditimet e tij.

(4) Në përgjithësi, KLSH-ja ka akses tek ambjentet dhe infrastruktura e të gjitha subjekteve të audituara dhe tek të gjitha informacionet dhe dokumentacionet e nevojshme për kryerjen e auditimit.

(5) Gjatë një auditimi të nisur në vitin 2009 administrata tatimore pengoi KLSH-në të kryente punën e vet audituese. Administrata tatimore, në bazë të Ligjit "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" dhe detyrimet e saj për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit të taksapaguesve, refuzoi të jepte akses tek dokumente të caktuara që u kërkuan nga KLSH. KLSH-ja u ankua për këtë refuzim të aksesit dhe në vitin 2009 e çoi çështjen në Gjykatën e Apelit të Tiranës. Në vitin 2009, Gjykata e Apelit e refuzoi ankimimin e KLSH-së dhe KLSH e ankimoi këtë vendim në Gjykatën e Lartë. Në vitin 2011, Gjykata e Lartë e ktheu çështjen në Gjykatën e Apelit. Në tetor të vitit 2011, Gjykata e Apelit dha vendim në favor të KLSH-së duke deklaruar se refuzimi i aksesit në informacion nga ana

e administratës tatimore nuk ishte i justifikuar.

Ligji për KLSH-në që hyri në fuqi në vitin 2015, në mënyrë të qartë përmban një dispozitë sqaruese për dhënie aksesi në të gjithë informacionin e nevojshëm nga ku përjashtohet qartë informaconi rreth çështjeve të veçanta tatimore.

(6)Në maj të vitit 2014 KLSH-ja ndërmorri një auditim të një sipërmarrjeje shtetërore. Sipërmarrja refuzoi të vinte në dispozicion marrëveshjet me subjektet private duke argumentuar se marrëveshjet ishin konfidenciale. Në korrik të vitit 2014, KLSH-ja bëri kallëzim penal në Prokurori për personin që vepronte në emër të sipërmarrjes për sjellje në shkelje të nenit 235 të Kodit Penal, i cili ndalonte "pengimin e një punonjësi publik që kryen detyrë publike ose shërbim publik". Në shkurt të vitit 2016, çështja nuk ishte mbyllur ende.

4.3 Në bazë të vendimit të fundit të Gjykatës së Apelit të Tiranës, si dhe përmirësimeve ligjore të Ligjit për KLSH-në, e drejta e KLSH-së për të disponuar informacion u forcua. Grupi i Vlerësimit vëren se dispozitat ligjore i japin KLSH-së të drejtë të pakufizuar të aksesit në informacione. Grupi i Vlerësimit e konsideron aksesin e informacioneve në përputhje të plotë me Parimin 4 të Deklaratës së Meksikës.

Grupi i Vlerësimit gjithashtu vëren mundësinë e ankimimit në Prokurori për raste të pengimit të auditimit si një rregullim të mirë kundër ndërhyrjeve në të drejtën e aksesit të informacioneve.

Grupi i Vlerësimit rekomandon që KLSH të vazhdojë të mbrojë dhe të përdorë plotësisht të drejtat e tij për disponimin e informacionit. Gjithashtu, bazuar në për-vojën e shkuar të KLSH-së, Grupi i Vlerësimit rekomandoi që në rast refuzimi të aksesit në informacion, KLSH të përdorë të gjitha mjetet e disponueshme për të garantuar zbatimin e të drejtave të saj dhe në këtë mënyrë të krijojë precedentë për të ardhmen.

Parimi 5

E drejta dhe detyrimi për të raportuar mbi punën e tij

5.1 SAI nuk duhet të kufizohet në raportimin e rezultateve të punës së tij audituese.

Duhet të jetë kërkesë ligjore që raportimi mbi rezultatet e punës audituese të bëhet të paktën një herë në vit.

5.2 (1) E drejta dhe detyrimi i KLSH-së për të botuar raportin vjetor të saj parashi-kohen në Kushtetutë dhe gjithashtu edhe në Ligjin për KLSH-në.

Neni 164 i Kushtetutës përcakton që KLSH-ja paraqet në Kuvend raportet e mëposhtme:

- raport për zbatimin e buxhetit të shtetit;
- mendim për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi;
- raport vjetor të veprimtarisë së tij.

Neni 164 i Kushtetutës gjithashtu parashikon se me kërkesë të Kuvendit KLSH paraqet informacion për rezultatet e auditimeve dhe shqyrtimeve.

(2) Ligji për KLSH-në, në nenet 10 dhe 31 e në vijim, përcakton më tej rregullat për këto të drejta dhe detyrime. Neni 10 i Ligjit për KLSH-në përcakton se KLSH çdo vit paraqet raportin mbi zbatimin e buxhetit të shtetit. Ky raport përfshin dhe vlerësimin e bërë.

Neni 31 i Ligjit për KLSH-në gjithashtu përmban dispozitat kushtetuese rreth detyrimit të KLSH-së për të raportuar dhe thuhet se Kryetari i KLSH-së vendos nëse do t'i dërgojë Kuvendit raportet përfundimtare të auditimeve dhe se Kuvendi mund të kërkojë paraqitjen e raporteve përfundimtare të auditimeve. Më tej, neni 31 i ligjit për KLSH-në përmban edhe një klauzolë shtesë sipas së cilës Kryetari i KLSH-së mund t'i kërkojë Kuvendit, Komisionit për Ekonominë dhe Financat apo ndonjë komisioni tjetër në Kuvend që të dëgjohet dhe të raportojë për çështje që ai i çmon si të rëndësishme në funksion të veprimtarisë së tij institucionale.

Neni 32 i Ligjit për KLSH-në përcakton se KLSH ia paraqet raportet përkatëse subjektit të audituar dhe se Kryetari ka të drejtë të vendosë nëse është e nevojshme t'i paraqiten këro raporte edhe Presidentit të Republikës, Kryeministrit

Kryetarit të Kuvendit, kryetarëve të grupeve parlamentare apo Ministrit të Fi- nancave.

Neni 32 i Ligjit për KLSH-në gjithashtu përmban detyrimin ligjor të KLSH-së për t'i paraqitur Këshillit të Ministrave, autoriteteve të tjera shtetërore, organi-zatave jofitimprurëse me të cilat KLSH-ja ka marrëveshje bashkëpunimi, publikut dhe palëve të tjera të interesuara, kur e gjykon të nevojshme dhe në interes të shtetit dhe të publikut, raporte, studime dhe materiale të tjera që kanë të bëjnë me Këshillin e Ministrave, ministritë dhe institucione të tjera qendrore.

Nenet 33 dhe 34 të Ligjit për KLSH-në parashikojnë informimin e publikut të gjerë me anë të botimit të një buletini dhe të raporteve që paraqiten në Kuvend. Raportet e auditimit botohen në mënyrë elektronike, botimi i këtyre raporteve si dhe informacioni i botuar në konferencat për shtyp, dektaratat për shtyp si dhe informacioni që i jepet medias nuk mund të përmbajë informacion dhe materiale që përbëjnë sekret shtetëror, sekret tregtar apo informacion konfidencial.

(3) Çdo vit të periudhës së vlerësuar (2013–2015) KLSH ka botuar nga dy raporte vjetore, siç edhe e përcakton Kushtetuta. Këto ishin raporti për zbatimin e buxhetit të shtetit së bashku me mendimin e KLSH-së mbi raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar, që paraqiten në Kuvend si një raport i vetëm, raporti i veprimtarisë vjetore.

Për shembull, raporti i veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2014 përfshinte, përveç të tjerash, edhe kapituj me përshkrime të veprimtarisë së tij audituese si dhe të dobisë së rezultateve të auditimit, gjetjet kryesore të auditimeve si dhe përdorimin e burimeve të KLSH-së. Shtojcat përmbanin, përveç të tjerash, kapituj mbi dëmin ekonomik të zbuluar nga auditimet si dhe paditë penale që janë depozituar si rezultat i gjetjeve të auditimeve.

(4) Raporti për zbatimin e buxhetit të shtetit së bashku me Opinionin mbi Raportin e

Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar pa- raqiten në Kuvend nga Kryetari i KLSH-së, në muajin shtator ose tetor të çdo viti.

KLSH gjithashtu paraqet në Kuvend raportin mbi veprimtarinë e saj vjetore. Ky raport zakonisht paraqitet në muajin mars të çdo viti. Pasi paraqitet në Kuvend, raporti i plotë vjetor mbi veprimtarinë e KLSH-së botohet në faqen e internetit si dhe në formë libri.

(5) Komisioni për Ekonominë dhe Financat është një komision i përhershëm parlamentar që merret kryesisht me politikat ekonomike, buxhetin e shtetit dhe zbatimin e tij, financat publike, çështje të privatizimit si dhe sistemin bank- ar dhe KLSH paraqet në këtë komision kërkesën për buxhetin vjetor (shihni Parimin 8 – autonomia buxhetore). Si komision i përhershëm parlamentar, Komisioni për Ekonominë dhe Financat mund të mblidhet në çdo kohë[9]. Ko- misioni mblidhet nga kryetari apo me kërkesë të të paktën një të katërtës së anëtarëve të komisionit, ose me kërkesë të Kryetarit të Kuvendit.

(6) Sipas nenit 32 të Ligjit për KLSH-në, KLSH-ja u paraqet subjekteve të au- dituara raporte të hollësishme auditimi ku përshkruhen të gjitha gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e auditimit.

Në Rregulloren e Brendshme të miratuar të KLSH-së gjenden edhe rregulla dhe udhëzime për raportimin.

(7) Neni 33 i Ligjit për KLSH-në përcakton se KLSH boton rregullisht një buletin. Ky buletin duhet të përmbajë raportet përfundimtare dhe vjetore të auditimit, konkluzionet dhe rekomandimet e auditimeve me rëndësi të veçantë, llogaritë vjetore të KLSH-së, duke përfshirë edhe opinionin e audituesve për to. Më tej neni 34 i Ligjit për KLSH-në parashikon se KLSH, në respekt të detyrimit të tij ligjor për informimin e publikut, ofron informacion mbi punën e saj nëpërmjet publikimit të raporteve të paraqitura nga KLSH në Kuvendin e Shqipërisë, publikimit të raporteve të auditimit në mënyrë elektronike, konferencave për shtyp dhe publikimit të njoftimeve për shtyp si dhe çdo informacioni tjetër që përcaktohet nga Kryetari i KLSH-së.

Departamenti i auditimit të performancës (jo KLSH si institucion) ka një profil në Facebook, ku departamenti i auditimit të performancës boton informacion rreth veprimtarisë së departamentit dhe disa prej raporteve të tij.

(8) KLSH-ja zakonisht u paraqet raportet e plota të auditimeve vetëm subjektit të audituar dhe Ministrit përkatës. Kryetari vendos nëse është e nevojshme që raportet të paraqiten tek Presidenti i Republikës, tek Kryetari i Kuvendit, tek Kryetarët e Grupeve Parlamentare apo tek Ministri i Financave si dhe për boti- min e tyre në faqen e internetit të KLSH-së.

5.3 Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit për KLSH-në, KLSH nuk e ka vetëm detyrë të botojë rezultatet e punës audituese, por e ka edhe detyrim ligjor një gjë të tillë. Në këtë kontekst, Grupi i

[9] Kur Kuvendi është në seancë plenare, Komisioni i Përhershëm mblidhet vetëm me lejen e Kryetarit të Kuvendit.

Vlerësimit vëren se dispozitat ligjore e përmbajnë plotë- sisht Parimin 5 ë Deklaratës së Meksikës.

Grupi i Vlerësimit mori parasysh faktin se KLSH i boton rezultatet e auditimeve në faqen zyrtare të internetit.

KLSH publikon Raportin Vjetor të aktivitetit, Raportin vjetor të zbatimit të Buxhetit faktik dhe persa i përket raporteve te auditimit, ALSAI publikon në WEB të gjitha rezultatet e auditimeve te realizuara ne subjekte.

Parimi 6

Liria për të vendosur për përmbajtjen dhe kohën e raporteve të auditimit si dhe për botimin dhe shpërndarjen e tyre

6.1 SAI është i lirë të vendosë për përmbajtjen e raporteve të auditimit.

SAI është i lirë të japë vëzhgime dhe rekomandime në raportet e auditimit, duke marrë parasysh, nëse i sheh të përshtatshme pikëpamjet e subjektit të audituar.

Legjislacioni specifikon kërkesat minimale të raportimit të auditimit të SAI-t dhe aty ku është e përshtatshme, çështje specifike duhet të jenë objekt i një opinioni apo certifikimi zyrtar të auditimit.

SAI ka lirinë të vendosë rreth kohës së raporteve të auditimit përveç rasteve ku kërkesat specifike për raportim parashkruhen në ligj.

SAI mund të marrë parasysh kërkesa specifike për hetime për auditime nga organi ligjvënës në tërësi apo nga ndonjë nga komisionet e tij apo nga qeveria.

SAI është i lirë të botojë dhe shpërndajë raportet e tij pasi janë paraqitur zyrtarisht apo pasi janë paraqitur tek autoriteti i përshtatshëm siç e kërkon ligji.

6.2 (1) KLSH, e kryesuar nga Kryetari i tij është i lirë të vendosë për planifikimin e auditimit dhe përmbajtjen e çdo raporti. Neni 29 i Ligjit për KLSH-në specifikon më tej se subjektit të audituar duhet t'i krijohet mundësia për të komentuar mbi projekt – raportin, pra përpara se të përfundohet raporti; komentet e sub- jektit të audituar pasqyrohen në raportin përfundimtar.

KLSH-ja ka udhëzime të brendshme dhe manuale për përmbajtjen e raportit të auditimit ku përcaktohet se raporti i auditimit duhet të përfshijë objektivat e auditimit, fushën dhe metodologjinë si dhe rezultatet e auditimit, përfshirë gjetjet, konkluzionet, rekomandimet, referencën tek standardet dhe udhëzimet e zbatuara si dhe komentet kryesore të personave përgjegjës.

(2) Secili nga raportet e auditimit të KLSH-së përmban rekomandime, siç përcaktohet në nenin 30 të Ligjit për KLSH-në. Neni 29 i Ligjit për KLSH-në përcakton se KLSH i dërgon projektraportin subjektit të audituar për t'i dhënë mundësinë ta komentojë atë. Këto komente dhe vëzhgime të subjektit të au- dituar pasqyrohen në raportin përfundimtar.

(3) Kërkesat minimale të raportimit lidhen me raportet dhe opinionet që KLSH paraqet në Kuvend (shihni Parimin 5, Të drejtat dhe detyrimet për të raportuar mbi punën e KLSH-së).

(4) Neni 31 i Ligjit për KLSH-në përcakton të vetmin afat kohor për raportim duke përcaktuar se raporti vjetor mbi veprimtarinë e KLSH-së duhet të paraqitet në Kuvend brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës. Përveç këtij afati, KLSH vendos në mënyrë të pavarur për paraqitjen dhe/ose botimin e raporteve. (shihni Parimin 5, E drejta dhe detyrimi për të raportuar mbi punën e KLSH-së).

Raporti për zbatimin e buxhetit të shtetit paraqitet në Kuvend në të njëjtën kohë me mendimin mbi raportin e Këshillit të Ministrave mbi shpenzimet e vitit të mëparshëm financiar. KLSH-ja zakonisht i paraqet raportet në muajin shtator ose tetor.

(5) KLSH është e lirë të shqyrtojë kërkesa për auditim, por nuk është e detyruar të pranojë kërkesa të tilla pasi sipas nenit 9 të Ligjit për KLSH-në ka të drejtë të planifikojë veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur (shihni gjithashtu Parimin 3: Kompetencat e SAI-t).

(6) Kryetari ka gjithashtu të drejtë të vendosë nëse është e nevojshme që raportet të paraqiten tek Presidenti i Republikës, Kryeministri, Kryetari i Parlamentit, kryetarët e grupeve parlamentare apo tek Ministri i Financave. Neni 33 dhe 34 i Ligjit për KLSH-në parashikojnë edhe detyrimin e KLSH-së për të botuar raportet e auditimit përveç raporteve që përmbajnë sekret shtetëror, sekret tregtar apo informacion konfidencial.

KLSH nuk i boton të gjitha raportet e tij në versionin e plotë (shihni gjithashtu Parimin 5: E drejta dhe detyrimi i SAI-t për të raportuar mbi punën e tij).

(7) KLSH ka një Drejtori për Komunikimin, Botimin dhe Marrdhëniet me Jashtë, e cila është përgjegjëse për botimet. Drejtoria është pjesë e Departamentit të Politikave të Auditimit dhe ka pesë punonjës. Në janar të vitit 2016 të gjitha pozicionet e punës në këtë drejtori ishin të plotësuara.

6.3 Grupi i Vlerësimit vëren se sipas situatës aktuale ligjore, KLSH është e lirë të vendosë për përmbajtjen dhe kohën e secilit raport dhe në këtë mënyrë është në pa-jtueshmëri të plotë me Parimin 6 të Deklaratës së Meksikës. Për më tepër, KLSH është e detyruar t'i ofrojë publikut informacion rreth punës së saj dhe raportet e auditimit, përveç rasteve kur ato përmbajnë informacion sekret apo konfidencial. Grupi i Vlerësimit vëren se KLSH nuk i boton të gjitha raportet e auditimit në formë të plotë dhe i rekomandon KLSH-së të shqyrtojë mundësinë e botimit të të gjitha raporteve të plota për t'u dhënë personave të interesuar akses në to dhe për t'u mundësuar atyre një panoramë të vërtetë dhe të drejtë të raporteve të tyre.

Parimi 7

Ekzistenca e mekanizmave të efektshëm të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të SAI-t

7.1 SAI i paraqet raportet e tij në organin ligjvënës, një nga komisionet e tij, apo në një bord drejtues të subjektit të audituar, si të jetë e përshtatshme, për shqyrtim dhe ndjekje të rekomandimeve të

veçanta për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese.

SAI ka sistemin e vet të brendshëm të ndjekjes për t'u siguruar se subjektet e audituara i trajtojnë vëzhgimet dhe rekomandimet e tyre si dhe ato të organit lig- jvënës, njërit prej komisioneve të tij apo bordit drejtues të subjektit audites, sipas rastit.

SAI i paraqet raportet e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve në organin lig- jvënës, tek njëri nga komisionet e tij apo tek bordi drejtues i subjektit të audituar, sipas rastit, për shqyrtim dhe për veprim, edhe në rastet kur SAI ka autoritetin statutor për ndjekje të zbatimit dhe vendosjen e sanksioneve.

7.2 (1) Nenet 15 dhe 30 të Ligjit për KLSH-në ofrojnë bazën ligjore për mekanizmin e ndjekjes së KLSH-së. Neni 15 i Ligjit për KLSH-në përcakton që pasi KLSH njofton subjektin e audituar për rekomandimet e tij, subjekti njofton KLSH-në rreth planeve për të zbatuar rekomandimet brenda 20 ditëve. Neni 30 i Ligjit për KLSH-në përcakton që subjekti i audituar është i detyruar të raportojë tek KLSH rreth zbatimit të rekomandimeve brenda gjashtë muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit.

Në rast moszbatimi të rekomandimeve të KLSH-së, KLSH mund të njoftojë organet më të larta shtetërore kompetente për moszbatimin nga subjekti i audituar, siç parashikohet në nenin 15 të Ligjit për KLSH-në.

(2) Një udhëzim i brendshëm për ndjekjen dhe dokumentimin e zbatimit të rekomandimeve përmban informacion më të hollësishëm për zbatimin e me-kanizmit të brendshëm të ndjekjes.

(3) Në praktikë, përgjigjia që dërgohet nga subjekti i audituar brenda 20 ditëve nga data e njoftimit të rekomandimeve përmban masat e planifikuara apo të marra nga subjekti i audituar me qëllim zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së (për shembull, ngritjen e grupeve të punës, planet e zbatimit, programet me afate kohore, emrat e personave përgjegjës).

Pas gjashtë muajsh subjekti i audituar raporton mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.

Në fund të çdo viti, KLSH kryen auditime të veçanta për të kontrolluar nëse janë zbatuar rekomandimet e hartuara gjatë vitit. Këto auditime kryhen çdo vit dhe janë pjesë e programit të veprimtarisë së KLSH-së. Qëllimi i këtyre auditimeve është të monitorojë nëse rekomandimet janë zbatuar, janë zbatuar pjesësisht apo nuk janë zbatuar fare.

Bazuar në rezultatet e këtyre auditimeve, kryetari mund të vendosë të ri nxjerrë rekomandime për subjektet e audituara, të përfshijë çështje të caktuara në programin e ardhshëm të auditimit apo të njoftojë organin më të lartë kompetent për moszbatimin e rekomandimeve.

(4) Rezultatet e auditimeve për ndjekjen e zbatimit janë pjesë e Raportit Vjetor të veprimtarisë së KLSH-së që i paraqitet

Kuvendit dhe botohet brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës. Informacion i mëtejshëm rreth nivelit të zbatimit mund të gjendet edhe në buletinët e botuar të auditimeve.

(5) Zbatimi i rekomandimeve është një nga rekomandimet kyçe të performancës së KLSH-së. Tabela e mëposhtme tregon rekomandimet për vitet 2013–2015 si dhe zbatimin e tyre për çdo lloj auditimit:

	2013			2014			2015		
Lloji i masës	reko-mandimet	rekomandimet e zbatuara	përqindja	rekomandimet	rekomandimet e zbatuara	përqindja	rekomandimet	rekomandimet e zbatuara	përqindja
propozime për amendime të legjislacionit	82	16	19.5 %	88	37	42.0 %	35	9	25.7 %
masa organizative	2,003	977	48.8 %	2,603	1,748	67.2 %	2,510	817	32.5 %
masa administrative	236	153	64.8 %	302	211	69.9 %	276	94	34.1 %
masa disiplinore	925	652	70.5 %	1,135	918	80.9 %	1,314	703	53.5 %
Totali	**3,246**	**1,798**	**55.4 %**	**4,128**	**2,914**	**70.6 %**	**4,135**	**1,623**	**39.3 %**

Tabela tregon se niveli i zbatimit të rekomandimeve është rritur ndjeshëm, nga 55.4% në vitin 2013 në 70.6% në vitin 2014 dhe ka rënë në 39.3% në vitin 2015. Niveli mesatar i zbatimit gjatë viteve 2013 - 2015 shkon në 55%.

7.3

Ulja e përqindjes së rekomandimeve të zbatuara në vitin 2015 në krahasim me vitet e mëparshme mesa duket tregon se qeveria ka më pak vullnet për të zbatuar rekomandimet e KLSH-së.

(6) Pjesa më e madhe e auditimeve të viteve të mëparshme konsistonte në auditime përputhshmërie dhe auditime financiare. Megjithatë, një nga objektivat strategjikë të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së është rritja e cilësisë dhe numrit të auditimeve të performancës si dhe shndërrimi i auditimeve të perfor- mancës në një prej veprimtarive më të rëndësishme audituese të KLSH-së.

Grupi i Vlerësimit vëren se KLSH-ja ka ngritur një mekanizëm të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve dhe në mënyrë sistematike vlerëson zbatueshmërinë e rekomandimeve të saj. KLSH verifikon nëse subjektet e audituara i kanë zbatuar masat e hartuara prej tij si dhe dokumenton nivelin e zbatueshmërisë së tyre.

KLSH-ja i raporton rezultatet në Kuvend si pjesë e veprimtarisë vjetore të raportimit.

Grupi i Vlerësimit e konsiderojn kështu mekanizmin e KLSH-së për ndjekjen e rekomandimeve një sistem të efektshëm, pavarësisht rënies së nivelit të zbatimit në vitin 2015.

Grupi i Vlerësimit vëren se mekanizmi për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve është ngritur për auditimet e përputhshmërisë dhe ato financiare, por mund të mos i plotësojë kërkesat për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të performancës me fushë më të gjerë, kompleksitet të lartë dhe rekomandime që lidhen me ekonomicitetin, eficencën dhe efektivitetin. Meqenëse strategjia e KLSH-së ka për synim rritjen e numrit të auditimeve të performancës, mekanizmi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve mund të ketë nevojë për disa ndryshime për t'iu përshtatur më mirë karakteristikave të auditimeve të performancës. Nëse sipas sistemit aktual një ndjekje e rregullt e rekomandimeve të të gjitha auditimeve të kryera të performancës është e pamundur, KLSH mund të shqyrtojë munësinë e përshtatjes së një qasjeje të bazuar në risk për ndjekjen e auditimeve të caktuara të performancës për vetëm dhe brenda rekomandimeve të përzgjedhura.

Për më tepër, KLSH mund të shqyrtojë mundësinë e botimit të rezultateve të auditimeve të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve si raporte të veçanta.

Parimi 8

Autonomi financiare dhe menaxheriale-administrative si dhe disponueshmëria e burimeve të përshtatshme njerëzore, materiale dhe monetare

8.1 SAI duhet të disponojë burimet e nevojshme dhe të arsyeshme njerëzore, materiale dhe monetare – ekzekutivi nuk duhet të ketë kontroll mbi aksesin e këtyre burimeve apo të kontrollit të tyre. SAI menxhon buxhetin e tij dhe e shpërndan atë në mënyrë të përshtatshme.

Organi ligjvënës ose një nga komisionet e tij është përgjegjës për t'u siguruar se SAI ka burimet e përshtatshme për të përmbushur kompetencat e tij.

SAI ka të drejtë të ankohet në mënyrë të drejtpërdrejtë tek organi ligjvënës në rast se burimet e siguruara janë të pamjaftueshme për t'i lejuar SAI-t të ushtrojë kompetencat në përmbushje të funksionit të tij.

8.2 (1) Kushtetuta nuk përmban ndonjë dispozitë rreth burimeve të KLSH-së, por neni 7 i Ligjit për KLSH-në parashikon se buxheti i KLSH-së është pjesë e buxhetit të shtetit dhe si i tillë miratohet nga Kuvendi çdo vit në formën e një ligji. Këto ligje për buxhetin ndajnë buxhetin për çdo institucion në disa kategori buxhetore si dhe përcaktojnë numrin maksimal të punonjësve që mund të punësohet nga secili institucion.

(2) KLSH paraqet çdo vit projekt-buxhetin pranë Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, i cili e shqyrton atë dhe e paraqet në seancë plenare. Buxheti (i përgjithshëm) miratohet nga Kuvendi në formën e një ligji.

E drejta e Kryetarit të KLSH-së për të folur për çështje të buxhetit para Komisionit Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave apo në seancë plenare nuk është e sanksionuar me ligj.

(3) Neni 7 i Ligjit për KLSH-në përmban dhe dispozitën sipas së cilës KLSH zbaton buxhetin e saj në mënyrë të pavarur.

Ministria e Financave i vë në dispozicion KLSH-së fondin e buxhetit.

Buxheti i KLSH-së, buxheti i shtetit dhe përqindja e buxhetit të KLSH-së për tre vitet e fundit ka qenë si vijon:

Tabela 4: Buxheti i KLSH-së dhe buxheti i shtetit

Viti	Buxheti i KLSH-së (në mill. ALL)	Buxheti i KLSH-së (në mill. ALL)	Buxheti i KLSH-së (në mill. ALL)	Buxheti i KLSH-së (në mill. ALL)	% që zë buxheti i KLSH-së në buxhetin e shtetit
2013	291.61	2.08	409,408	2,924.34	0.07
2014	371.45	2.65	456,404	3,260.03	0.08
2015	350.61 (fillimisht 380.61)	2.50 (fillimisht 2.72)	456,437 (fillimisht 472,697)	3260.26 (fillimisht 3,382.69)	0.08 (fillimisht 0.08)

Burimi: KLSH, kursi i këmbimit: 1 Euro = 140 Lek

Në vitin 2013, Kuvendi miratoi një pakësim buxheti çka çoi në reduktim të buxhetit të KLSH-së dhe buxhetit të të gjithë institucioneve të tjera me 5% gjatë vitit. Buxheti i KLSH-së prej rreth 2.08 milion EUR[10] ishte praktikisht rreth 35,714 EUR[11] më pak se sa do të kishte qenë sipas ligjit për buxhetin e atij viti.

Këto shifra sugjerojnë se buxheti për vitin 2015 ishte më i ulët se buxheti për vitin 2014, por KLSH sqaroi se buxheti i planifikuar për vitin 2015 kishte qenë rreth 2.72 milion EUR[12]. Meqenëse rreth 215,000 EUR[13] ishin caktuar për një projekt IPA[14], nisja e të cilit ishte shtyrë për në vitin 2016, kjo shumë për rrjedhojë ishte transferuar në buxhetet e viteve të ardhshme.

(4) Sipas nenit 7 të ligjit për KLSH-në, KLSH ka të drejtë të përdorë të ardhurat dytësore të përfituara nga projektet ndërkombëtare dhe botimet e tij. Deri në shkurt të vitit 2016 nuk ishte kryer asnjë projekt i tillë dhe nuk janë përfituar të ardhura dytësore.

(5) Ligji për buxhetin për çdo vit përmban gjithashtu numrin maksimal të punonjësve që mund të punësohen nga KLSH-ja. Numri maksimal i punonjësve krahasuar me

[10] ekuivalenti i 291.61 milion ALL
[11] ekuivalenti i 5 milion ALL
[12] ekuivalenti I 380.61 milion ALL
[13] ekuivalenti i 30 milion ALL

[14] IPA nënkupton "Instrumentin para - aderimit"

numrin aktual të punonjësve të KLSH-së është si vijon:

Brenda limitit të ligjit për buxhetin, KLSH ka një farë autonomie të caktuar të mëtejshme në lidhje me buxhetin për personelin: mund të aplikojë tek Ministria e Financave për të ndryshuar kategorizimin e pjesëve të buxhetit të saj për të lejuar pjesë më të madhe buxheti për kategorinë e personelit. Kërkesa të tilla zakonisht pranohen.

Nenet 37 dhe 38 të Ligjit për KLSH-në mbulojnë statusin e personelit të KLSH-së, i cili është i ndarë në auditues dhe në nëpunës dhe të dy kategoritë janë nëpunës civilë për të cilët zbatohen rregullat e ligjit për shërbimin civil, si dhe personeli mbështetës për të cilët zbatohen dispozitat e Kodit të Punës. Brenda kuadit ligjor të shërbimit civil, KLSH është e lirë të kryejë procedurat e tij të rekrutimit të personelit të ri.

(6) Ligji për KLSH-në, në nenin 40 të tij, gjithashtu lejon kontraktimin e ekspertëve të jashtëm, pagat e të cilëve mbulohen nga buxheti i KLSH-së. Siç parashikohet në ligj, Kryetari i KLSH-së nxjerr një vendim ku përcaktohen hollësi të mëtejshme në lidhje me përzgjedhjen dhe pagesat e këtyrëve ekspertëve, të cilët përzgjidhen nga një Komision ad – hoc dhe paguhen me një pagë që varion nga 50% e pagës në pagën e plotë të një krye audituesi.[15]

Nga dhjetori i vitit 2014 deri në nëntor të vitit 2015, KLSH ka kontraktuar në total 51 ekspertë të jashtëm për një total prej 174 muajsh, pra mesatarisht 14.5 persona në muaj. Shpenzimi për pagat e këtyre ekspertëve varion prej mesatarisht 293 EUR në 905 EUR[16] në muaj, mesatarisht rreth 599 EUR[17] për person në muaj. Shpenzimi në total për ekspertët e jashtëm shkon në rreth 104,200 EUR[18].

Tabela 5: Employees of the ALSAI

Viti	Numri maksimal i punonjësve	Numri aktual i punonjësve	%
2013	161	157	97.5%
2014	166	166	100.0%
2015	171	166	97.1%

Burimi: KLSH

(7) Sipas nenit 7 të Ligjit për KLSH-në, veprimtaria financiare e KLSH-së mund të auditohet nga një grup audituesish të pavarur, të përzgjedhur nga Kuvendi. Meqenëse nuk është kryer asnjëherë një auditim i tillë, Kryetari ka dërguar tre kërkesa në Kuvend për auditimin e veprimtarisë financiare të KLSH-së në vitet 2012, 2013 dhe 2014. Kryetari dëshiron të theksojë se KLSH ka për qëllim të jetë transparente dhe të zbatojë standardet ndërkombëtare. Megjithatë, deri më tani Kuvendi ende nuk ka ndërmarrë një auditim të tillë.

(8) Sipas nenit 10 të Ligjeve për Buxhetin e Shtetit për vitet 2014, 2015 dhe 2016, Këshilli i Ministrave përcakton standardet dhe normat financiare për shpenzimet publike, të cilat kërkohen të zbatohen nga të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme, Këto norma janë të zbatueshme edhe për KLSH-në, meqenëse nga pikëpamja e Ligjit

për Buxhetin e Shtetit KLSH-ja konsiderohet si njësi e qeverisjes së përgjithshme. Megjithatë, KLSH- mendon që kjo dispozitë është në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit për KLSH-në, sipas të cilit KLSH- zbaton në mënyrë të pavarur buxhetin e tij. Për të reflektuar këtë gjë, rekomandohet që në opinionin për shpenzimet e vitit të mëparshëm financiar të Këshillit të Ministrave të kërkohet ndryshimi i ligjit.

(9) Një nga standardet dhe normat financiare të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave lidhet me dietat e shërbimeve të nëpunësve civilë. Aktualisht trajtohen me dieta për shërbim vetëm audituesit e KLSH-së që kryejnë vizita pune në terren në një distancë më të madhe se 100 km nga vendndodhja e KLSH-së në Tiranë. KLSH mendon që kjo gjë shkakton vështirësi financiare për audituesit dhe e kufizon autonominë buxhetore të institucionit. KLSH është përpjekur të inkurajojë amendimin e këtij vendimi në lidhje me trajtimin financiar të punonjësve me shërbim duke i drejtuar letra shtesë Kryeministrit, Ministrit të Financave, Ministrit të Drejtësisë dhe Kryetarit të Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat. Në këto letra KLSH ka theksuar detyrat e veçanta që kryen KLSH dhe situatën aktuale ligjore për sa i përket kufizimit të autonomisë buxhetore të KLSH-së me anë të këtij rregulli për trajtimin financiar me anë të dietave për shërbim larg vendit të punës; faktin që puna në terren e audituesve shpesh zgjat rreth 22 deri në 45 ditë dhe se audituesve u rimbursohen vetëm shpenzimet e udhëtimit, por nuk përfitojnë trajtim financiar në formë diete dhe as kompensim për kohën e shpenzuar në udhëtim, edhe pse prej tyre pritet që të punojnë për 8 orë në ditë në larg vendit të punës.

8.3 Pavarësisht faktit që buxheti i KLSH-së dhe numri maksimal i punonjësve janë pjesë e buxhetit të shtetit të miratuar nga Kuvendi, Grupi i Vlerësimit vëren që Kryetari nuk ka të drejtë ankimimi të drejtpërdrejtë në Kuvend apo në Komisionet Parlamentare për çështje që lidhen me buxhetin e KLSH-së. Për të arritur autonomi më të madhe financiare në lidhje me burimet e KLSH-së, Grupi i Vlerësimit rekomandon që KLSH të informojë organin ligjvënës rreth rasteve të mospajtueshmërisë me Deklaratën e Meksikës në këtë drejtim me qëllim arritjen e të drejtës së KLSH-së për të ankimuar në Kuvend.

Grupi i Vlerësimit vëren gjithashtu se liria e plotë në shpërndarjen e buxhetit, si për shembull dhënia e buxhetit si shumë totale dhe dhënia e të drejtës KLSH-së për akordimin e saj në mënyrë autonome, do të nënkuptonte përmbushjen e Deklaratës së Meksikës në një shkallë më të lartë. Pavarësisht se Ligji për KLSH-në i jep KLSH-së të drejtë të menaxhojë buxhetin e saj në mënyrë të pavarur, Ligji për Buxhetin përfaqë- son një shkallë kufizimi duke e ndarë buxhetin në disa kategori shpenzimesh. Grupi i Vlerësimit rekomandon që KLSH-ja të punojë për marrjen e buxhetit të saj si shumë në total.

Sipas Ligjit për KLSH-në, KLSH-ja ka të drejtë të përftojë të ardhura. Pavarësisht se ky rregull mundëson një autonomi më të gjerë buxhetore, Grupi i Vlerësimit i kujton KLSH-së se pavarësisht kësaj mundësie, KLSH-ja

duhet ta ketë përqendrimin parësor në kryerjen e detyrave thelbësore në përmbushje të kompetencave të saj.

Grupi i Vlerësimit e konsideron pozitiv faktin që KLSH ka marrë miratim për një rritje të numrit të punonjësve. Kjo, së bashku me të drejtën për të kontraktuar ekspertë të jashtëm si dhe rregullat e qarta për këto procese i japin mundësinë KLSH-së të përdorë burimet e nevojshme dhe të arsyeshme njerëzore. Grupi i Vlerësimit i rekomandon KLSH-së të monitorojë kontraktimin e ekspertëve të jashtëm dhe në rast se kontraktimi i ekspertëve të jashtëm arrin në një nivel të caktuar ku ata zëvendësojnë punën e personelit të rregullt, të kërkojë të punësojë personel të përhershëm

Sipas mendimit të Grupit të Vlerësimit, mundësia e auditimit të veprimtarisë financiare të KLSH-së nga ana e Kuvendit është një instrument i rëndësishëm për forcimin e transparencës së KLSH-së. Grupi i Peer Review Ekipi konstatoi se Parlamenti e nuk ka përdorur deri tani këtëinstrument dhe vë në dukje gatishmërinë e KLSH-së për kryerjen e auditimit mbi aktivitetin e tij financiar.

Grupi i Vlerësimit vëren se Ligji për KLSH-në siguron pavarësinë e KLSH-së për për-dorimin e buxhetit të saj, por pavarësisht kësaj vërehen shqetësime për kufizimet në trajtimin financiar me anë të dietave për shërbim larg vendit të punës. Grupi i Vlerësimit e çmon të rëndësishëm zgjidhjen e këtij problemi dhe rekomandon vazhdimin e përpjekjeve për gjetjen e një zgjidhjeje për të.

Shtojca 1: Palët e Interesit të intervistuara

Z. Ridvan Bode, Zëvendës kryetar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat

Z. Florion Mima, Anëtar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat

Znj. Blerina Gjylameti, Anëtare e Komisionit për Ekonominë dhe Financat

Znj. Evis Kushi, Anëtare e Komisionit për Ekonominë dhe Financat

Z. Ervin Koçi, Anëtar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat

Znj. Mimoza Dhëmbi, Drejtoreshë e Përgjithshme, Drjetoria e Buxhetit, Ministria e Financave

Z. Jorgji Bollano, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (OJQ) Z. Artur Cani, Integrimi Urban (OJQ)

Z. Hysen Cela, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (OJQ) Z. Sazan Guri, G&G Group (OJQ)

Z. Sami Neza, Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë (OJQ)

Shtojca 2: Anëtarët e Grupit të Vlerësimit

Z. Bernhard Beybel, Gjykata Austriake e Auditimit

Znj. Eva Prenner, Gjykata Austriake e Auditimit

Znj. Irmtraud Weinke, Gjykata Austriake e e Auditimit

Znj. Viorica Verdes, SAI i Moldavisë

FORCIMI I INFRASTRUKTURËS ETIKE NË INSTITUCIONET SUPREME TË AUDITIMIT, TENDENCË E KOHËS

KLSH në mënyrë të natyrshme, është bashkuar me tendencën e SAI-ve, evropiane dhe ka ngritur tashmë strukturën e tij etike, ka Kodin e tij të Etikës, po bashkëpunon me shoqërinë civile, po bën gjithnjë e më shumë transparente veprimtarinë e tij, po menaxhon konfliktin e interesit nëpërmjet deklarimeve periodike, po drejton nëpërmjet shembullit të drejtuesve të lartë, duke pasur bindjen e plotë se është momenti i duhur për ta bërë sjelljen etike, pjesë integrale të veprimtarisë së tij.

Nga: Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme

Irena Islami, Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, KLSH

Abstrakt

Çdo Institucion Suprem Auditimi (SAI) synon të jetë një trupë profesionale që i kontribuon shtimit dhe kursimit të vlerës së parave publike, duke ndihmuar në përmirësimin e menaxhimit të Qeverisë e të enteve të tjera publike nëpërmjet auditimit, duke fituar në këtë mënyrë besimin e palëve të interesit në qeverisjen e sektorit publik.

Për të siguruar këtë besim, pavarësia e SAI-t, etika dhe besueshmëria duhet të jenë jashtë çdo dyshimi, ashtu siç theksohet edhe në *Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimi* (ISSAI). Për këtë arsye kërkohet forcimi i infrastrukturës etike në SAI, me qëllim vendosjen e standardeve të larta etike për audituesit publikë.

Bordi drejtues EUROSAI (Organizata Evropiane e Institucioneve Supreme të Auditimit) ka krijuar Task Forcën e EUROSAI (në të cilën bën pjesë edhe KLSH, që nga qershori i vitit 2013) për Auditimin dhe Etikën (TFA&E) si një instrument për të mbështetur SAI-et evropiane në promovimin e rëndësinë e sjelljes etike, me qëllim shkëmbimin e ndërsjellë të përvojave përkatëse.

KLSH si anëtar i këtij grupi, në mënyrë të natyrshme, është bashkuar me tendencën e SAI-ve, evropiane dhe ka ngritur tashmë strukturën e tij etike, ka Kodin e tij të Etikës, po bashkëpunon me shoqërinë civile, po bën gjithnjë e më shumë transparente veprimtarinë e tij, po menaxhon konfliktin e interesit nëpërmjet deklarimeve periodike, po drejton nëpërmjet shembullit të drejtuesve të

lartë, duke pasur bindjen e plotë se është momenti i duhur për ta bërë sjelljen etike, pjesë integrale të veprimtarisë së tij.

Menaxhimi i çështjeve të Etikës është shumë i rëndësishëm dhe çdo SAI duhet të sigurohet që etika dhe parimet deontologjie të respektohen dhe të zbatohen, në mënyrë që institucioni të përmbushë rolin e tij të vërtetë. Për të arritur këtë objektiv, SAI-et duhet të plotësojë disa kushte thelbësore si: hartimi dhe zbatimi i Kodit të tij të Etikës, aplikimi i metodave inovative të forcimit të sistemit të integritetit, ndërgjegjësimi i stafit për rëndësinë e zbatimit të çështjeve të etikës, trajnimi i tij, zbatimi i politikave të tjera të burimeve njerëzore që lidhen me etikën e integritetin dhe drejtimi nëpërmjet shembullit të mirë të menaxherëve të nivelit të lartë.

Fjalë kyçe: etikë, auditim, Institucion Suprem Auditimi, besueshmëri, ISSAI Intosaint

Mbi menaxhimin e sistemit të etikës dhe integritetit në Institucionet Supreme të Auditimit.

Rasti i Kontrollit të Lartë të Shtetit metoda inovative "*Intosaint*".

Etika dhe Integriteti i Institucionit Suprem të Auditimit është element thelbësor dhe parakusht që ky institucion të konsiderohet i besueshëm. KLSH luan një rol kritik në promovimin e menaxhimit të shëndoshë të financave publike, në funksion të një qeverisje transparente dhe të përgjegjshme.

Hapat e ndërmarra nga KLSH që nga viti 2013 e në vazhdim, drejt modernizimit me një vizion të ri, kanë synuar një rol proaktiv për rritjen e përgjegjshmërisë dhe besueshmërinë së publikut ndaj qeverisjes. Menaxhimi i fondeve publike është çështje besimi dhe në shoqëritë demokratike publiku kërkon transparencë, integritet dhe kompetencë prej institucioneve që ushtrojnë funksione publike.

ISSAI 1: (Deklarata e Limës; neni 14.1) kërkon që stafi i SAI-ve duhet të vlerësohet bazuar në profesionalizmin, kualifikimet dhe integritetin moral në mënyrë që të sigurohet që ata të mund të kryejnë plotësisht detyrat e tyre.

ISSAI 20: (Përgjegjësitë e SAI-it) i kushton vëmendje të veçantë përgjegjshmërisë dhe transparencës, si një element i qeverisjes së mirë të SAI-t.

Në kuadër të përmbushjes së objektivit për modernizimin e institucionit gjatë viteve të fundit, KLSH ka ndërmarrë hapa konkrete dhe një sërë iniciativash për instalimin në institucionin e KLSH-së të një **infrastrukture efektive** etike dhe me integritet.

1-Në fokus të politikave të ndjekura nga menaxhimi është pasur parasysh që masat e ndërmarra për instalimin e një sistemi efektiv të integritetit të jenë të vazhdueshme, pjesë e menaxhimit të përditshëm të institucionit të KLSH-së dhe jo politika të përkohshme, me impakt krijimin e një ambienti jo korruptiv dhe implementimin e një kulture etike dhe me integritet.

Problematikat e Integritetit në KLSH, janë konsideruar si një **komponent standart i përditshëm** dhe i prekshëm nga të gjithë audituesit. Mund të thuhet se mbikëqyrja dhe monitorimi që të mos rezultojnë incidente të karakterit korruptiv apo shkelje ndaj integritetit **ka qenë boshti kryesor** i veprimtarisë së përditshme të KLSH-së.

Promovimi i integritetit ka qenë në fokus të veprimtarisë menaxhuese.

Në këtë drejtim merr rendësi aspekti praktik i filozofisë së menaxhimit i "Ton at the top" pasi promovimi i integritetit të KLSH-se është kryer nën parimin e "udhëheqjes nëpërmjet shembullit". Nga ana tjetër politikat e integritetit janë implementuar duke shpenzuar një pjesë të konsiderueshme të fondeve buxhetore në këtë drejtim (ngritja e strukturës së auditimit & investigimit apo e komunikimit, trajnime brenda dhe jashtë vendit, botime etj). Politikat e integritetit në KLSH kanë qenë të tilla që të arrihej një ekuilibër midis parandalimit të shkeljeve dhe marrjes së masave ndëshkimore nga njëra anë dhe inkurajimit të integritetit nga ana tjetër.

Në drejtim të marrjes së masave ndëshkimore veprimtaria institucionale është përqendruar në drejtim të zbulimit hetimit dhe ndëshkimit të shkeljeve. Kjo praktikë është ndjekur pasi mos ndëshkueshmëria sjell dëme të pariparueshme për institucionin e KLSH-së dhe humbjen e kredibilitetit institucional në përgjithësi dhe të besimit të publikut në veçanti. Nëse një shkelje e integritetit kalon pa u ndëshkuar, kjo sjell automatikisht demotivimin e anëtarëve të tjerë me moral të shëndetshëm të stafit të KLSH-së. Në vijimësi është ndjekur politika "Tolerancë zero" ndaj shkeljeve të integritetit në këndvështrimin, që nëse shkeljet nuk korrigjohen dhe ndëshkohen ato bëhen të rrezikshme dhe "bumerang" për institucionin.

2-Gjatë vitit 2013, KLSH u pranua anëtare e Task Forcës së Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) "Mbi auditimin e etikës". KLSH nëpërmjet anëtarësimit dhe pjesëmarrjes aktive në këtë organizëm, synon nga njëra anë, në instalimin dhe funksionimin e një infrastrukture efektive etike në vetë institucionin e KLSH-së dhe nga ana tjetër, do të ndërmarrë misione auditimi mbi rregullaritetin dhe eficiencën e Etikës dhe Integritetit në institucionet publike, duke konsideruar që lufta kundër korrupsionit dhe politikat për instalimin e një sistemi efektiv të integritetit të jenë pjesë e menaxhimit të institucioneve publike.

Krahas sa më sipër KLSH ne cilesine e anëtarit e Grupit për Rishikimin e ISSAI 30: Kodi Etik, një iniciativë kjo e ndërmarrë nga Këshilli Mbikëqyrës i Komitetit të Standardeve Profesionale (PCS) të INTOSAI-T në Qershor të vitit 2013. KLSH ishte nje nder kontributoret e hartimit te ISSAI 30 miratuar ne kongresin e fundit te ONTOSAI.

3-Po kështu me synim instalimin dhe zhvillimin më tej <u>të një kulture të re organizative</u> përgjatë viteve te fundit janë nxjerrë udhëzime per "Komunikim i

drejtpërdrejtë për përmirësimin e punës audituese dhe rritjen e zbatimit të standardeve INTOSAI në KLSH" udhëzim i cili reflekton dhe është dëshmi e ndjekjes së praktikave më të mira të fushës, duke krijuar në këtë mënyrë hapësira konkrete të mjaftueshme për shprehjen e "kriticizmit pozitiv" nga poshtë lart apo dhënien e mendimeve, sugjerimeve për përmirësimin e punës në institucion.

Kjo ishte një **praktikë risi** mjaft demokratike (gjithëpërfshirëse) aplikuar për herë të parë në institucionin e KLSH-së dhe rezultoi se një pjesë e mire e stafit të KLSH është treguar aktive në dhënien e mendimeve dhe sugjerimeve.

Nxjerrja e këtyre udhëzimeve ishte një "mjet " efektiv për promovimin e integritetit pasi çelësi për promovimin e integritetit përmes kulturës organizative është komunikimi.

Nëpërmjet këtij udhëzimi realisht u inkurajuan punonjësit e KLSH-së për diskutimin e problemeve, vlerësimin e menaxhimit apo edhe sugjerimin e mendimeve të ndryshme.

Nga ana tjetër kjo praktikë reflektoi edhe zbatimin e kërkesave të një prej Standardeve Ndërkombëtare te Auditimit ISSAI nr. 41 "Analiza e boshllëqeve" që synon përmirësimin e menaxhimit të institucionit.

4- Po kështu në reflektim të praktikave më të mira të fushës eshte krijuar një strukturë e veçantë, përgjegjëse për investigimin e shkeljeve ndaj integritetit e cila është një mase me efekte parandaluese në drejtim të forcimit të sistemit të kontrollit të integritetit ne KLSH .

Po keshtu eshte miratuar një strukture e veçantë, Sektori i Etikes dhe Integritetit, pjesë e Departamentit Juridik dhe zbatimit te standarteve. Nëpërmjet krijimit të këtij sektori, KLSH **avancoi duke emëruar si pjesë të strukturës organizative "Komisionin e integritetit** " i cili ndër të tjera ka përgjegjësi si strategjike dhe menaxheriale përsa i përket integritetit. Kjo strukture është përgjegjëse për:

- monitorimin e zbatimit të kërkesave të kodit etik,
- komunikimin rreth çështjeve të etikës,
- trajnimin për etiken dhe integritetin,
- kryerjen e këshillimeve dhe zgjidhjen e dilemave të etikes dhe integritetit, me
- kompetenca hetimi dhe kontrolli në rastet e sinjalizimeve për thyerjen e rregullave të integritetit, etikes, standardeve etj.

5-Në Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të institucionit, rregullore e cila reflekton kërkesat dhe standardet më të mira të fushës janë sanksionuar procedura të cilat tentojnë konsolidimin dhe forcimin e sistemit të kontrollit të integritetit të punonjësve gjatë veprimtarisë audituese. Përmendim këtu të drejtën e kryerjes së investigimeve edhe gjatë procesit auditues në vartësi kjo të sinjalizimeve të ndryshme për shkelje të integritetit nga ana e audituesve, pra ekziston protokolli i investigimit të shkeljeve te integritetit.

6-Kodi Etik i KLSH-së . Bazuar në kërkesat e ISSAI 30 KLSH ka hartuar, disponon dhe zhvillon një Kod Profesional të Etikës. KLSH referuar edhe planit të tij strategjik ka hartuar një dokument të ri të Kodit Etik (miratuar në datën 30 prill 2015), i cili reflekton praktikat më të mira të fushës.

Strategjia për krijimin e një ambienti me integritet në KLSH ka ndjekur hapat e mëposhtme:

-**së pari,** u hartua kuadri rregullator (Rregullorja e organizimit dhe funksionimit të KLSH-së, urdhra dhe udhëzime etj).

-**së dyti,** është vijuar me imponimin, implementimin e rregullave, procedurave dhe udhëzimeve. Ne këtë aspekt janë kryer trajnime intensive që kanë synuar edukimin e punonjësve me frymën e standardeve dhe vlerave morale.

-**së treti,** është proceduar me kontrollin, investigimin dhe ndëshkimin e sjelljeve të papranueshme të integritetit .

7-Transparenca e Institucionit të KLSH-së në marrëdhënie me publikun.

Në zbatim të ISSAI 20: "Parimet e transparencës dhe llogaridhënies" KLSH ka synuar që nëpërmjet transparencës së veprimtarisë së aktivitetit institucional të sigurojë dhe ti japë publikut një garanci dhe një transparencë të plotë në lidhje me menaxhimin e sistemit të integritetit në KLSH.

Këtij qëllimi i kanë shërbyer publikimet në internet të raporteve të performancës institucionale, publikimit të analizave vjetore dhe periodike të veprimtarisë së KLSH-së, publikimit të masave të marra për kallëzimet penale ndaj audituesve që kanë rezultuar me shkelje të integritetit apo aktiviteteve të trajnimit dhe forcimit të kapaciteteve të burimeve njerëzore.

Perspektiva:

-Kontributi i KLSH-së për auditimin e integritetit dhe qeverisjen e mirë në sektorin publik.

Referuar praktikave më të mira të fushës dhe përcaktimeve në planin strategjik 2013-2017, KLSH synon të kontribuoje në instalimin e një infrastrukture etike efektive në institucionet e sektorit publik.

Kontributi institucional: *KLSH ka ngritur një sistem efektiv të kontrollit të integritetit dhe një infrastrukture etike efektive dhe kontribuon* ***duke udhëhequr sipas shembullit*** *në promovimin e integritetit në sektorin publik dhe rrjedhimisht për një qeverisje të mirë.*

Kontributi strategjik: *KLSH synon të përfshijë në programet e auditimit, kryerjen e auditimit te integritetit dhe etikës gjatë veprimtarisë audituese.*

Te kryejë monitorimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të integritetit si dhe kryerjen e trajnimeve dhe rritjen e njohurive të INTOSAINT edhe për organizatat e sektorit publik apo dhe për auditimin e brendshëm.

Nga pikëpamja operacionale *ky lloj auditimi mund të kryhet gjatë auditimit të përputhshmërisë, rregullshmërisë, audi-timet e performancës duke u fokusuar në sistem por mund të kryhet edhe vetëm*

auditim mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të integritetit.

-Kudo në bote vitet e fundit është ndërmarrë iniciativa për promovimin e etikës dhe integritetit në sektorin publik. Në këtë kuadër KLSH i është bashkuar iniciativës së ndërmarrë nga Gjykata Hollandeze e Auditimit për kryerjen e vetëvlerësimit të integritetit duke parashikuar hapa konkrete edhe në planin strategjik të KLSH-së 2013-2017, i cili do të synon në testimin e sistemit të integritetit, evidentimin e fushave vulnerabël dhe me risk si dhe hartimin e planit të masave që do të merren për forcimin e sistemit të etikes si dhe përmirësimin e menaxhimit të integritetit në KLSH.

Një nga metodat inovative të zhvilluara së fundmi (fillesat e saj i ka në vitet 2011-2012) në funksion të fuqizimit të sistemit të integritetit është dhe metoda INTOSAINT (Integrity Self Assesment INTOSAI).

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka aplikuar këtë instrument të vetëvlerësimit të integritetit për herë të parë të plotë në vitin 2014, por Kryetari i KLSH-së qysh në vitin 2013, në Prezantimin e Raportit të Performancës së KLSH-së për vitin 2013, pranë Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit të Shqipërisë ka theksuar *"...KLSH-ja aplikoi dhe u pranua anëtar i Task Forcës së Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI) "Mbi auditimin e etikës". Kjo është pjesëmarrja e parë në këto komisione. Nëpërmjet anëtarësimit dhe pjesëmarrjes aktive në këtë organizëm, si dhe aplikimit të Instrumentit të vetëvlerësimit të integritetit, të ashtuquajturit INTOSAINT, jemi përpjekur të forcojmë infrastrukturën etike si brenda institucionit, ashtu dhe të promovojmë integritetin dhe etikën në institucionet e sektorit publik që auditojmë, duke u përpjekur "të udhëheqim nëpërmjet shembullit....".*

Përgjegjësia për integritetin. Nëpunësit Civilë veprojnë me integritet nëse zbatojmë vlerat dhe standardet e një administrimi të mirë. Integriteti mbulon jo vetëm kërkesat e mos korruptimit, por gjithashtu mbulon vlera si ndershmëria, sinqeriteti, shoqërueshmëria, neutraliteti, konsiderata, besueshmëria, fokusi tek klienti, respekti, objektiviteti dhe mirësjellja. Një nëpunës civil duhet të kujdeset që të ushtrojë përgjegjësitë e tij/saj dhe të përdorë fuqitë, informacionin dhe burimet në dispozicion në të mirë të publikut ose të interesit të përgjithshëm të cilit i shërben, si dhe të sillet në mënyrë korrekte me kolegët e tij dhe me publikun.

Integriteti është një parakusht për performancën e vazhdueshme dhe efektive të sektorit publik.

Integriteti do të thotë më shumë se thjesht shqyrtim i ligjeve dhe rregullave. Ligji është kufiri i poshtëm dhe pikënisja minimale morale. Rregullat dhe ligjet nuk mund të mbulojnë të gjitha situatat. Tensioni është më i lartë atje ku rregullat mungojnë apo janë të pasigurta, siç mund të haset në situata të reja, komplekse dhe të ndryshueshme. Përkatësisht në

situata të tilla, nëpunësit civilë duhet të jenë në gjendje të krijojnë një opinion të pranueshëm moralisht dhe të veprojnë me përgjegjësi në përputhje me vlerat dhe standardet e një administrimi efektiv. Gjithashtu, e njëjta gjë duhet bërë në situatat ku ata kanë fuqi të pakushtëzuara.

Politikat e Integritetit kërkojnë një kombinim të presionit dhe parandalimit. Nga njëra anë një organizatë duhet të ndërmarrë masa nëse stafi i saj vepron në mënyrë jo të përshtatshme (presioni). Nga ana tjetër, organizata duhet të bëjë githçka që mundet që të reduktojë tundimet që mund të çojnë një nëpunës civil të veprojë në mënyrë të papërshtatshme (parandalimi). Prioritet duhet t'i jepet parandalimit. Jo vetëm që është më efektiv por, në bilanc investimi është shumë herë më i vogël se sa kostoja e riparimit të dëmit të shkaktuar nga sjellja e papërshtatshme: "më mirë të parandalosh se sa të kurosh".

Nje SAI duhet te aplikoje politika *integriteti jo ad noc jo ad hoc por të vazhdueshme* Integritetit duhet ti kushtohet vazhdimisht vëmendje. Nëse një politikë dobësohet atëherë kur gjërat funksionojnë siç duhet, risku për incidente rritet. Me fjalë të tjera, integriteti dhe politika e integritetit duhet të jenë të gdhendura në organizatë dhe të jenë një pjesë e paluajtshme e menaxhimit operacional dhe menaxhimit të cilësisë së organizatës. Integriteti nuk mund të trajtohet si një projekt sepse projektet mbarojnë dhe nuk janë të vazhdueshëm. Integriteti duhet të jetë një komponent standard në menaxhim dhe në ciklin e politikave.

Pak historik - *Vetëvlerësimi i integritetit (SAINT) si instrument është zhvilluar nga* ***Gjykata e Auditimit e Hollandës*** *në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme e Byronë e Integritetit të Amsterdamit dhe kjo metodologji po përhapet në të gjitha vendet anëtare të INTOSAI-it. Deri tani kjo metodologji është pilotuar në vende te ndryshme si: Finlanda, Hollanda, Afrika e Jugut, Gana, Indonezia, Jemen etj.*

Nga ana e Gjykatës Hollandeze të Auditimit është synuar që shpërndarja e eksperiencës dhe koncepteve të vetëvlerësimit të integritetit mund të jetë e vlefshme edhe për anëtarët e tjerë të INTOSAI-it.

Në vitin 2011, nga ana e Gjykatës Hollandeze të Auditimit u zhvillua trajnimi për moderatorë në Hagë në të cilën morën pjesë 21 përfaqësues të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe përfaqësues të Gjykatës Europiane të Auditimit, të IDI-it dhe AFROSAI-it.

Në rajonin e EUROSAI-t – Përfaqësues të SAI-t të vendeve si; Austria, Norvegjia, Rusia, Gjeorgjia Maqedonia, Turqia dhe Gjykata Evropiane e Auditimit (ECA) kanë marrë pjesë në trajnimin e INTOSAINT në Hagë në vitin 2011.

-Në shkurt të vitit 2012, Maqedonia (SAI) ndërmori një mision vetëvlerësimi.

-Norvegjia (SAI) ndërmori INTOSAINT vetëvlerësim në Nëntor të 2012 nën modelimin e ECA. Rusia synon të nderrmare mision vetëvlerësimi në

institucionin e SAI nën udhëheqjen e Gjykatës Holandeze të Auditimit si dhe shpërndarjen e eksperiencës dhe metodologjisë në vendet Rusisht folëse. Po kështu synon që ta përhapë këtë metodë edhe në organizatat e sektorit publik .

Në MAJ 2013, *Nga Gjykata e Auditimit të Holandës, në Ankara të Turqisë u zhvillua kursi një javor me temë* ***"Trajnim i moderatorëve për kryerjen e vetë-vlerësimit të integritetit në Institucionet Supreme te Auditimit"****. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga Institucionet Supreme të Auditimit të vendeve si Polonia, Estonia, Hungaria, Zvicra, Maqedonia si dhe dy audites nga institucioni i KLSH-se. Po kështu kanë zhvilluar kurs trajnimi për moderatorë përfaqësues të 18 Institucioneve Supreme të Auditimit njëherazi anëtare të OLCAEFS.*

Sikurse konstatohet Gjykata Hollandeze e Auditimit është duke koordinuar dhe inkurajuar procesin e përhapjes se kësaj metodologjie në nivel global.

Në Kongresin e XXI – INTOSAI mbajtur ne Pekin në 21-26 Tetor 2013, Gjykata Hollandeze e Auditimit raportoi për përhapjen e kësaj metode kudo në botë. U konkludua se një bazë e fortë solide eshte krijuar tashmë mbi të cilën INTOSAI mund të ndërtoi mekanizmin për ti mundësuar Institucioneve Supreme të Auditimit të udhëheqin sipas shembullit për integritetin.

Gjykata Hollandeze e Auditimit i prezantoi INTOSAI-t një sërë rekomandimesh për ndërrmarjen e hapave të cilat do të synonin ndër të tjera për zhvendosjen e INTOSAINT në një nivel më të lartë tek INTOSAI si psh tek Komitetit i Ngritjes së Kapaciteteve.

ISSAI 30 - Kodi Etik u miratua në Kongresin e XXII- të të INTOSAI- t, në dhjetor 2016, në Abu Dhabi. Përditësimi i ISSAI-t 30 do të shërbejë si një pikë nisje për shkëmbimin e eksperiencave në fushën e etikës dhe integritetit.

Tashmë INTOSAINT përfaqëson një metode mjaft të përhapur ne komunitetin e INTOSAI-t si një "Best practise", si një instrument mjaft produktiv për forcimin e sistemit të etikës dhe integritetit në institucionet Supreme të Auditimit.

Bibliografia

- "Forcimi i infrastrukturës etike në SAI dhe auditimi i Etikës në sektorin Publik", Botim i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Tiranë 2014;
- "IntoSAINT, Manuali i vetëvlerësimit të Integritetit për Institucionet Supreme të Auditimit", Botim i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Tiranë 2014;
- "Kodi i Etikës, Kodi i Sjelljes-ECA, ISSAI 30-Kodi i Etikës", Botim i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Tiranë 2015

Nga: Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme

Irena Islami, Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, KLSH

A MUNDET PLATONI DHE ARISTOTELI TË NA NDIHMOJNË TË AUDITOJMË NË BOTËN DIXHITALE?

Auditimi sot: parimet klasike + mjetet dixhitale

Marrë nga Revista e ECA-s, nr.5, maj 2017

Sipas Platonit, "E vërteta, mirësia dhe bukuria" janë cilësitë më të mëdha që një entitet mund zotëroj. A ka të bëjë auditimi me të vërtetën, mirësinë dhe bukurinë?
"Detyra jonë është të ndihmojmë në sigurimin dhe mbrojtjen e parave publike të investuara dhe mirëqenien e qytetarëve". Me fjalë të tjera, ne auditojmë për të mirën e përbashkët.

Nga: Jesus Nieto, auditues në Drejtorinë e Kontrollit të Cilësisë, ECA

Ky artikull bazohet në një prezantim që u zhvillua në ECA më 6 mars 2017.

Audituesit kanë një rol të rëndësishëm në botën dixhitale. Nëse jemi dinamikë dhe përkrahim teknologjinë dixhitale, mund të bëjmë një marrëveshje të mirë. Nëse jo, ne mund të zgjohemi dhe të themi se nuk është më e nevojshme.
Në këtë artikull flasim së pari për parimet themelore të auditimit: pse ne auditojmë (për të mirën e përbashkët) dhe si mund të auditojmë (duke kërkuar për të vërtetën). Së dyti, përmbledhim shkurti-misht mundësitë, përdorimet dhe risqet e analizimit të të dhënave. Së fundmi, ne shohim se teknikat vizuale janë shumë efektive për analizimin e të dhënave për komunikimin.

Konceptet dhe parimet

Parimet - Pse ne auditojmë?

Figura 1. Cilësitë Platonike

Sipas Platonit, "*E vërteta, mirësia dhe bukuria*" janë cilësitë më të mëdha që një entitet mund zotëroj. A ka të bëjë auditimi me të vërtetën, mirësinë dhe bukurinë?
Vítor Caldeira, ish-president i ECA-s, ka thënë se "*Detyra jonë është të ndihmojmë në sigurimin dhe mbrojtjen e parave publike të investuara dhe mirëqenien e*

qytetarëve". Me fjalë të tjera, ne auditojmë për të mirën e përbashkët.

Kur ne auditojmë, ne kërkojmë të vërtetën (dëshmi), duke hetuar atë që po ndodh, se si po ndodh dhe pse po ndodh.

Çfarë, si dhe pse mund të shihet qartë në figurën 2, duke përdorur piramidën e njohurive (të dhëna, informacion, njohuri dhe dije). Disa aspekte të realitetit që kërkojmë të masim (dele, para, etj.) regjistrohen në letër ose në kompjuter si të dhëna, numra të thjeshtë si "300". Nëse kemi njohuri për përmbajtjen, ne shohim informacionet si të dhëna: çfarë po ndodh me 300 delet që janë në një fermë. Duke filtruar dhe analizuar informacionin, ne mund të nxjerrim njohuri (si funksionojnë gjërat: korrelacionet) dhe dije (përse gjërat po ndodhin, marrëdhëniet shkak-pasojë).



Figura 2. Të dhëna, informacion, njohuri, dije dhe auditim

Si lidhet kjo me auditimin? Auditimi është filtrimi i njohurive dhe dijeve nga dëshmi të fshehura në një det me informacion. Duhet të arrijmë në njohuri dhe dije që të shtojmë vlerë në formën e konkluzioneve dhe rekomandimeve. Nëse kufizohemi vetëm në informacion, ne nuk po shtojmë vlerë, por qëndrojmë në nivelin "çfarë pastaj?"

Është e rëndësishme të mbahet mend se ne auditojmë "*nga poshtë lart*", bazuar në të vërtetën. Ne fillojmë me një pyetje në lidhje me realitetin dhe gjejmë përgjigje në bazë të provave (të vërtetës). Në këtë aspekt auditimi është i ngjashëm me *gazetarin e mirë*, pasi të dyja bazohen tek e vërteta. Aktivitete të tjera, si publiciteti dhe propaganda, punojnë "*nga lart*

poshtë", duke filluar me një mesazh që do të përdoret me ose pa prova mbështetëse.

Auditimi është…….. analizimi i të dhënave



Figura 3. Auditimit dhe procesi i analizimit të të dhënave

Auditimi sot është ... *analizim të dhënash.* Si është kryer një auditim? Ne auditojmë për *dëshmi* (evidenca) rreth realitetit në mënyrë që të analizojmë atë për t'iu përgjigjur pyetjeve tona. Zakonisht nuk shqyrtojmë vetë realitetin, por disa "*shënime*" në lidhje me të, të pasqyruara në letër (faturat, librat e llogarive) kurse tani si të dhëna në skedarë dhe baza të dhënash. Provat janë të dhëna, kështu që analiza bëhet si analizë e të dhënave. Në fakt, procesi i auditimit është shumë i ngjashëm me procesin standard të analizimit të të dhënave (figura 3).

Dallimi midis dy proceseve duket i vogël: *një bazë të dhënash e re* dhe *përgatitja e të dhënave*. Natyrisht, ne do të bashkëpunojmë me ekspertët tanë të të dhënave për të ndihmuar në përgatitjen e këtyre të dhënave "*të vogla*". Ne gjithashtu mund të kërkojmë nga audituesit e IT që të verifikojnë nëse sistemet që sigurojnë të dhëna ruajnë integritetin e tyre. Në përfundim, auditimi sot ka një marrëveshje për të mirën e përbashkët në analizimin e të dhënave.

II. Analiza e të dhënave

Mundësitë për analizimin e të dhënave në auditim mund të përmblidhen si më poshtë:

- Së pari, ne mund të automatizojmë gjithçka që duam, me kusht që të kemi informacion dixhital. Kjo përfshin atë që ne aktualisht bëjmë me dorë, por edhe atë që kurrë nuk u përpoqëm të bënim sepse do të duhej vite apo ndoshta nuk guxonim ta mendonim. Tani mund të ëndërrojmë, dhe për shembull ti themi një specialist të dhënash, "nëse unë mund të zbuloj vetëm se kush planifikon të bëjë mashtrime ..." Kjo mund të bëhet dhe madje ka një emër: analiza e rrjetit shoqëror.

Në fakt, për të vazhduar auditimin në të njëjtën mënyrë, por në formë dixhitale nuk është një qasje inteligjente për t'u ndërmarrë. Ne duhet të rishikojmë plotësisht planet tona të auditimit dhe qasjet për të shfrytëzuar informacionin dixhital.

- Së dyti, ne mund të procesojmë të gjithë popullatën. Kjo është jashtëzakonisht e fuqishme sepse përdoren të gjitha informacionet e përhapura në të gjithë popullsinë. Kjo mund të përpunohet 100%:

  a) "*zë për zë*", kështu ne mund të zbulojmë 100% të gabimeve duke kontrolluar gjithë popullsinë, ose

  b) globalisht, ne mund të shikojmë çdo pjesë të të dhënave në kontekstin e gjithë popullsisë. Duke shqyrtuar një zë të të dhënave ne shohim shumë pak informacion dhe nuk mund të nxjerrim shumë njohuri. Për shembull, shuma e një pagese (1,500 €) nuk na tregon asgjë për korrektësinë e saj. Megjithatë, duke vendosur këtë numër në kontekstin e shumave të tjera të paguara, mund të duket e dyshimtë. Kjo është pikërisht ajo që analiza e Benford-it bën, thjesht përdor kontekstin për të zbuluar anomalitë!

Ne kemi folur tashmë për verifikimin e auditimeve, por ka më shumë përdorime për analizën e të dhënave në auditim. Ne mund të krijojmë modele të bazuara në risk. Kjo është analiza parashikuese e të dhënave, pasi parashikon riskun e transaksioneve individuale që përmbajnë anomali. Kjo bëhet me një mjet për nxjerrjen e të dhënave që do të krijojë një model risku duke përdorur përvojat tona të kaluara. Këto modele nuk marrin parasysh shkaqet e anomalive, të cilat janë atribute të një transaksioni që lidhet vetëm me anomalitë e vërejtura.

Nuk na interesojnë shkaqet, vetëm saktësia e modelit. Në Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA), kryhet një ushtrim pilot, ne kemi qenë në gjendje të parashikojmë me saktësi 94% te pagesave që përmbanin gabime.

Në auditimin e performancës duhet të dimë shkaqet e rezultateve të mira ose të këqija në mënyrë që të rekomandojmë se cilat veprime pozitive duhet të ndërmerren dhe cilat veprime negative duhen shmangur. Fatkeqësisht, analiza e të dhënave nuk identifikon marrëdhëniet shkak-pasojë kështu që nuk na jep përgjigje të drejtpërdrejta. Korrelacionet e zbuluara janë shkaqe të mundshme që duhet të hetojmë për të gjetur marrëdhëniet shkak-pasojë.

Përdorimi: Auditim Performance
Pyetje: ¿ shkaqet e rezultateve të mira/ të dobët

Rezultati i Analizimit të të dhënave: korrelacionet ☹ → **Arsyet e studimit**
Y: reduktimi i landifillit % -- X: Fondet e EU (M €)



Figura 4. Analizimi i të dhënave në auditimin e performancës

Më saktësisht, në auditimin e performancës ne kërkojmë korrelacione shkakore midis inputeve, proceseve, ndikimit të faktorëve dhe rezultateve. Për shembull (shih figurën 4.), midis "fondeve të BE-së" si një kontribut dhe "reduktim i landfill-it" si rezultat. Ne do të presim që më shumë para të lidhen me zvogëlimin më të madh të landfill-it. Sidoqoftë, ne shohim në tabelë se nuk ekziston një korrelacion i tillë, d.m.th, paraja nuk është një shkak i mundshëm i zvogëlimit të landfill-it që ka ndodhur në disa vende. Ajo që mund të shohim megjithatë janë rezultatet e mira dhe të këqija, shkaqet për të cilat duhet të hetojmë në mënyrë që të rekomandojmë se çfarë duhet të bëjmë dhe çfarë duhet të shmangim.

Analiza e të dhënave përfshin disa risqe. Tre nga këto janë:

1) Analiza e të dhënave që përdor IT, e cila ka tendencë të bëhet komplekse. Kjo detyrë e vogël "përgatitja e të dhënave" nuk është e parëndësishme. Në fakt, në një projekt tipik të analizës së të dhënave, përgatitja e të dhënave dhe testimi i modelit janë 80% e punës. Ky risk i "komplikimit të papritur" mund të shkaktojë vonesa dhe tejkalime në kosto.

2) Një risk tjetër, më i rëndësishëm për shkak se mund të çojë në rezultate të gabuara është mos pasja e njohurive të thella të zonës së audituar dhe të dhënave. Ekipi ka nevojë për të zotëruar, "biznesin" (domethënë zonën e audituar), detajet dhe semantikën e të dhënave. Audituesit dhe ekspertët e të dhënave

duhet të punojnë në koordinim për të integruar të dyja burimet e njohurive. Nëse ky koordinim është jo i mirë, rezultatet mund të jenë të gabuara. Një shembull i kohëve të fundit në Spanjë ishte zbulimi i një gabimi të rremë që tregonte pagesën e mijëra pensioneve për njerëzit e vdekur. Gabimi filloi nga një koordinim jo i mirë që kishte ndodhur në lidhje me "pastrimin e të dhënave", të cilat "harruan" se numrat spanjollë të ID janë unikë, por "vetëm midis spanjollëve të gjallë", pasi numrat ID të shtetasve të vdekur janë "ricikluar".

RISKU 3 Kolapsi i informacionit

Ju duhet të vizualizoni të dhënat



Figura 5. Indikatorët statistikor rrëzojnë informacionin

3) Risku i tretë është "mbledhja" e informacionit. Treguesit statistikorë ose "statistikat përmbledhëse" (mjetet, devijimet standarde, korrelacionet etj.) janë në kolaps në shpërndarjen e informacionit në të gjithë popullsinë. Analiza e të dhënave e bazuar vetëm në treguesit statistikorë mund të jetë me të vërtetë e dobët, nëse nuk mashtron, sepse ajo injoron pasurinë e informacionit të përhapur në të gjithë popullatën. Kjo mund të krahasohet me përpjekjen për të studiuar natyrën dhe karakteristikat e pulave vetëm nëpërmjet koncentratëve të pulës si një burim të dhënash.

Efekti i "kolapsit të informacionit" zakonisht ilustrohet duke përdorur *Quartet Anscombe-së,* i cili tregon katër popullsi krejtësisht të ndryshme, me të njëjtët tregues statistikorë (domethënë, devijimi standard dhe korrelacion). Nëse përdorim vetëm indikatorët ne do të mendonim se janë një, e para e treguar në Figurën 5. Megjithatë, nëse i përfytyrojmë katër popullsitë, shohim se ato janë krejtësisht të ndryshme. Kjo sepse vizualisht mund të perceptojmë të gjithë

informacionin e shpërndarë mbi popullsinë. Në përfundim, ne duhet të vizualizojmë të dhënat.

III. Vizualizimi

Mendja njerëzore punon sipas dy "sistemeve" të ndryshme, të cilat përdorin pjesë të ndryshme të trurit:

- ***Sistemi 1,*** *bën perceptimin*, është i shpejtë, përdor pak glukozë dhe vepron në mënyrë të pandërgjegjshme dhe paralele. Ky sistem përfshin vizionin.
- ***Sistemi 2,*** *ka reflektim*, është i ngadalshëm, përdor shumë glukozë, dhe vepron në mënyrë të ndërgjegjshme dhe sekuenciale, duke kërkuar vëmendje. Ky sistem përfshin leximin.

Si mund të auditojmë duke përdorur Sistemin 2 (lexim dhe mendim)?

A mund të auditojmë "*duke përdorur 100% të trurit*"? Po, duke përdorur analizën e të dhënave vizuale?!
Analizimi i të dhënave vizuale punon duke përdorur vizualizimin e të dhënave të sistemit 1, të cilat do të perceptohen dhe sistemit 2, të cilat do të përdoren për të menduar, duke përdorur përvojën e audituesit, i cili duhet të dallojë mes normales dhe anormales. Çfarë bën Sistemi 2 është përdorimi i një modeli në trurin e audituesit pa nevojën e një mjeti për nxjerrjen e të dhënave.

Kjo është e lirë, e thjeshtë ... dhe funksionon!

Carlos Soler, drejtues ekipi në Gjykatën Evropiane të Audituesve, kontrollon sistemin doganor të BE. Në të kaluarën, ekipi i auditimit përdorte mostra të rastit: disa mostra për çdo milion deklarata doganore, të cilat gjatë verifikimit nuk u gjetën kurrë që të përmbajnë gabime apo mashtrime. Disa vjet më parë, Carlos eksperimentoi duke krijuar një mostër të bazuar në rrisk me analiza vizuale. Mjetet që ai përdori ishin:

(a) paraqitjet vizuale, duke u mbështetur në një anlizë të tillë, në të cilën është marrë në konsidertë cdo deklaratë doganore, duke treguar peshën (X) dhe vlerën e deklaruar (Y) me filtra për mallrat e importuara, vendin e origjinës dhe vendin e destinacionit;

(b) trurin, me përvojën dhe njohurinë e tij. Në çdo grafik të llojit “scatter” (shihni figurën 6.), Carlos përzgjodhi dërgesat që dukeshin shumë të lira krahasuar me pjesën tjetër të nënpopullimit (të njëjtin lloj malli, origjine dhe destinacioni).



Një nga deklaratat në kampion ishte zbuluar nga "Operation Snake" (një operacion i përbashkët i zbulimit të mashtrimit OLAF-Kinë) dhe ishte i lidhur me mashtrime të dyshuara prej rreth 20 milion euro. Për më tepër, i tërë kampioni i Carlos-it përbëhet nga "hits" – d.m.th të gjitha deklaratat ishin të gabuara ose mashtruese. Çfarë rezultati mbresëlënës kemi vetëm duke zgjedhur "pika të ngjyrosura"!

Ne mund të ndalemi këtu me rezultatin afër magjikes apo mund të bëjmë më shumë me vizualizimin? Por, ne gjithashtu mund të përmirësojmë komunikimin tonë. Ne mund të krijojmë raporte tërheqëse, të tërheqim vëmendjen, që gjithashtu janë bindëse për publikun. Ne mund ta bëjmë këtë duke përdorur imazhe të bukura dhe efektive për të tërhequr vëmendjen dhe për të përcjellë mesazhet tona. Për të shpjeguar dhe bindur opinionin publik, imazhet duhet të jenë të dizajnuara me kujdes. Kjo është shumë më tepër se dizajn grafik, kërkon dizajn konceptual, duke menduar së pari "*çfarë dua të them*", dhe pastaj duke krijuar imazhe efektive për ta shpjeguar atë.

Për të arritur këtë ne mund të përdorim lloje të ndryshme të imazheve: vizualizime të të dhënave (grafikë), diagramë (infografikë) dhe foto. Me anë të tyre ne mund të shpjegojmë informacionin, njohurinë dhe dijet që gjenden në tekstin e raporteve tona.

IV. Përfundime

Auditimi lidhet me të vërtetën, mirësinë dhe bukurinë. Ne auditojmë për të bërë mirë dhe për të kërkuar për të vërtetën.

Sot, auditimi nënkupton analizimin e të dhënave. Ne duhet të përdorim mundësinë për të përpunuar të gjithë popullsinë e të dhënave në mënyrë që të mos humbasim informacion.

Për të analizuar të dhënat, ekipet e auditimit kanë nevojë për njohuri të thelluara në procesin e auditimit dhe detajet e të dhënave. Audituesit luajnë një rol jetësor në analizimin e të dhënave dhe duhet të punojnë ngushtë me ekspertët e të dhënave.

Teknikat vizuale na mundësojnë të shfrytëzojmë aftësitë e mendjes njerëzore. Analiza e të dhënave vizuale është e lirë dhe efektive. Për më tepër, vizualizimet e dizajnuara mirë, të bukura dhe efektive bëjnë raporte tërheqëse dhe bindëse.
Kështu, duke kërkuar të vërtetën, duke përdorur bukurinë, ndihmojmë të bëjmë më të mirën për të siguruar që paratë publike të përdoren për të mbrojtur mirëqenien e qytetarëve dhe demokracinë.

Përktheu : Elisa Metaj, specialiste Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Iga: Jesus Nieto, auditues në Drejtorinë Kontrollit të Cilësisë, ECA

INTOSAI MIRATON KODIN E RI ETIK

Marrë nga "INTOSAI Journal", pranverë 2017

Në Kongresin XXII INCOSAI në Abu Dhabi u miratua Kod i ri Etik. Kodi i ri u përgjigjet nevojave të mjedisit aktual të auditimit publik.

Kodi i ri është me universal, në të përfshihen jo vetëm sugjerimet specifike të aplikimit por edhe zgjidhjet praktike të gatshme. Me qasjen dhe strukturën e tij të re, Kodi i përgjigjet nevojave të bashkësisë së SAI-ve, shprehur fillimisht në anketë dhe më vonë gjatë periudhës së ekspozimit.

Përse na nevojitet Kodi i Etikës?

Sjellja etike është me rëndësi parësore për Institucionet Supreme të Auditimit (SAI) në krijimin e një reputacioni pozitiv dhe ndërtimin e besimit me palët e interesuara. Kodi i etikës i siguron SAI-t një sërë vlerash dhe parimesh lidhur me mënyrën e sjelljes. Meqenëse mjedisi i auditimit të sektorit publik shpesh ndryshon nga ai i sektorit privat, bashkësia ndërkombëtare e SAI-ve kërkon një kod etik të dedikuar, i cili përfshin udhëzime se si duhet të ndërthuren vlerat dhe parimet etike në punën e përditshme, në situata të veçanta.

Organizata e Parë Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) miratoi Kodin e Etikës në Kongresin e XVI në Montevideo në vitin 1998. INTOSAI vlerëson rregullisht deklaratat për të siguruar plotësimin e nevojave lidhur me sfidat aktuale, dhe ISSAI 30: Kodi i Etikës i INTOSAI-t u shqyrtua rreth 15 vjet pas miratimit të kodit origjinal.

Përjashtimi i të vjetrës, përfshirja e së resë

I gjithë komuniteti i INTOSAI-t ofroi të dhëna përmes një sondazhi online, ku SAI-t u pyetën nëse Kodi i Etikës ekzistues ka nevojë për një rishikim për të siguruar përshtatshmëri dhe nëse po, në cilat drejtime duhet të bëheshin ndryshimet. Rezultatet treguan një dëshirë që Kodi të përditësohej për të krijuar standarde më të dobishme dhe më të përshtatshme për SAI-t. Pjesa me e madhe e përgjigjeve të

marra tregoi se Kodi duhet të përfshijë dispozita, udhëzime më të hollësishme dhe shembuj të mirë praktik.

Një ekip i përbërë nga përfaqësues të SAI-ve nga Shqipëria, Kili, Hungaria, Indonezia, Kuvajti, Meksika, Namibia, Holanda, Zelanda e Re, Polonia (Drejtuesi i Ekipit), Portugalia, Afrika e Jugut, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara dhe Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA) u bashkuan për të zhvilluar këtë Kod të ri.

Pas procesit të rregullt ligjor që përcakton parimet e rishikimit të INTOSAI-t, ekipi hartoi një projekt që u ekspozua për opinionin publik nga 1 nëntori 2015 deri më 1 shkurt 2016. Gjatë periudhës së ekspozimit, e cila ofroi një mundësi unike për të gjithë anëtarët, partnerët dhe palët e interesuara të INTOSAI-t për të shprehur mendimet dhe për të paraqitur sugjerime për ndryshime, ekipi ka marrë rreth 300 komente, shumë prej të cilave janë përdorur për të ndryshuar draftin. Analiza e komenteve ishte një sfidë e madhe, pasi ekipi duhej të plotësonte dy nevoja të kundërta: (1) disa SAI-e kërkonin përkufizime, shembuj dhe zgjidhje më të hollësishme, dhe (2) dokumenti duhej të ishte universal - i zbatueshëm për të gjithë anëtarët e INTOSAI-t (globalisht).

Kodi i ri është me universal, në të përfshihen jo vetëm sugjerimet specifike të aplikimit por edhe zgjidhjet praktike të gatshme. Me qasjen dhe strukturën e tij të re, Kodi i përgjigjet nevojave të bashkësisë së SAI-ve, shprehur fillimisht në anketë dhe më vonë gjatë periudhës së ekspozimit.

Kodi i ri dhe vlerat etike të tij

Në Kodin e Etikës së INTOSAI-t të rishikuar, vlerat etike janë konceptet e asaj që është e rëndësishme, ajo që duhet të nxisë vendimet për organizatën dhe stafin.
Ekzistojnë pesë vlera të përcaktuara për SAI-t:

1. **Integriteti -** për të vepruar me ndershmëri, besueshmëri, në mirë-besim dhe në funksion të interesit publik
2. **Pavarësia dhe objektiviteti -** të jesh i lirë nga rrethanat ose ndikimet që kompromotojnë (ose mund të konsiderohen si kompromotuese) të gjykosh dhe të veprosh në mënyrë profesionale dhe të paanshme
3. **Kompetenca** - për të marrë, mbajtur njohuritë dhe aftësitë e përshtatshme dhe për të vepruar në përputhje me standardet e aplikueshme me kujdesin e duhur
4. **Sjellja profesionale** - të jetë në përputhje me ligjet, rregulloret dhe konventat në fuqi për të shmangur çdo sjellje që mund të diskreditojë SAI-t
5. **Konfidencialiteti dhe Transparenca** - për të mbrojtur në mënyrën e duhur informacionin, duke e balancuar këtë me nevojën për transparencë dhe llogaridhënie

Ndonëse nuk largohen shumë nga Kodi i vitit 1998 dhe janë pothuajse identike me

vlerat e kodeve etike të disa organizatave të tjera, krahasuar me ato të dhëna gjatë periudhës së studimit dhe ekspozimit, ekziston një dallim – formulimi i vlerave të fundit.

Para publikimit të versionit të ri, "konfidencialiteti" ishte tema e cila krijoi shume debate, pasi disa SAI shprehën shqetësime se transparenca mund të mbizotërojë mbi konfidencialitetin.

Duke marrë parasysh të dy këto pikëpamje, vlera u ndryshua në emërtimin aktual "konfidencialiteti dhe transparenca" së bashku me një përkufizim që pasqyron nevojën për të balancuar të dy konceptet.

Modifikimi nuk rezultoi me ndryshime të mëdha në përmbajtjen e Kodit, pasi çështja e transparencës u theksua në fillimin e dokumentit, si në nivelin e kërkesave ashtu edhe në udhëzimet praktike të aplikimit.

Përfshirja e Kodit të ri të Përbashkët

Dallimi kryesor midis versionit të ri të Kodit dhe atij të vitit 1998 është përfshirja e perspektivës së SAI-t (si organizatë) së bashku me kërkesat e stafit individual, auditues dhe jo auditues.

Ky inkorporim ka për qëllim identifikimin dhe theksimin e përgjegjësive të SAI-t në lidhje me etikën, meqë sjellja individuale etike varet jo vetëm nga individi, por edhe nga mjedisi brenda të cilit ata punojnë.

SAI-t luajnë një rol të madh në krijimin e kulturës etike për organizatën, veçanërisht për të siguruar që stafi të mos mbetet i papërgatitur për t'u marrë me dilemat etike. Seksioni i Kodit, "Përgjegjësitë e Përgjithshme të Institucioneve Supreme të Auditimit", trajton këtë çështje duke renditur kërkesat etike që SAI-t duhet të arrijnë, duke përfshirë promovimin e një kulture etike, vendosjen e tonit dhe udhëheqjen sipas shembullit dhe zbatimin e një sistemi të kontrollit të etikës për të mbështetur sjelljen etike dhe për të adresuar shkeljet e vlerave etike. Ky grup kërkesash shërben si një listë kontrolluese kundër së cilës mund të vlerësohet funksionimi aktual i një SAI dhe identifikimi i fushave për të cilat nevojitet përmirësim.

Një risi tjetër e kodit të ri është struktura e dokumentit. Parathënia është pasuar nga një listë vlerash dhe përkufizimesh themelore dhe një pjesë kushtuar kërkesave të SAI-t. Ka edhe segmente të dedikuara për çdo vlerë themelore. Brenda secilit seksion, kërkesat e lidhura me etikën janë të përcaktuara veçmas për SAI dhe stafin, si audites dhe jo audites. Grupet e kërkesave, të cilat janë dalluar qartë përmes gjuhës dhe prezantimit grafik, pasohen nga fushat "aplikative" që fokusohen në udhëzime praktike për të zbatuar kërkesat e renditura më parë. Këto, gjithashtu, janë të ndara për SAI-in si organizatë dhe stafin e SAI-t.

Po më tej?

SAI-t tani inkurajohen që të zhvillojnë ose miratojnë një kod etik dhe një sistem të përshtatshëm të kontrollit të etikës për ta zbatuar atë. Megjithatë, siç thuhet në Parathënie, asnjë kod nuk mund të

adresojë të gjitha rrethanat etike që do të lindin në praktikë. Prandaj, Kodi është shkruar në nivel parimi. SAI-t dhe stafi i tyre duhet të zbatojnë gjykimin e tyre profesional në rrethanat që hasin dhe ndjekin kërkesat përkatëse të përcaktuara në këtë Kod.

Përktheu : Amantja Patozi, specialiste

Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

SAI-et DHE ADAPTIMI I TYRE ME NDRYSHIMET KLIMATERIKE

Të auditosh për të adresuar një risk kompleks

Marrë nga "INTOSAI Journal", pranverë 2017

SAI-et kanë aftësinë për të adaptuar qasjen audituese. Ndryshimet klimaterike përbëjnë një çështje komplekse dhe shumë SAI-e kanë mandatin për të ushtruar kontroll mbi një sërë fushash politike për të forcuar funksionet qeveritare.

Hyrje

Ndryshimet klimaterike konsiderohet nga shumë si komplekse, çështje të koklavitura që përbëjnë risk për shumë sisteme ekonomike dhe mjedisore. Sipas Këshillit për Kërkime Kombëtare të SHBA-së, megjithëse nuk mund të kemi parashikime të sakta, ka një kompromis shkencor se ndryshimet klimaterike kanë pasoja serioze për shoqërinë njerëzore pasi prekin shumë nga ekosistemet ku bazohet veprimtaria njerëzore.

Në adaptimin ndaj ndryshimeve klimaterike - pra përshtatja e sistemeve njerëzore si përgjigje ndaj ndryshimeve klimaterike - është e rëndësime pjesa e menaxhimit të këtyre risqeve. Pavarësish rolit të përshtatjes në menaxhimin e risqeve klimaterike, një auditim i vitit 2012 nga Grupi i Punë së EUROSAI mbi Auditimin Mjedisor (WGEA) zbuloi se përshtatja nuk është një prioritet në mesin e prioriteteve audituese të tetë qeverive evropiane (1). Shumica syresh kanë realizuar vlerësime të riskut për të mbledhur informacione rreth impaktit të ndryshimeve klimaterike, por vetëm dy prej tyre kanë zhvilluar një strategji efikase adaptimi. Pak shtete kanë filluar të bëjnë parashikime mbi impaktin e ndryshimeve klimaterike në ekonomitë e tyre.

Masat e implementuara janë kryesisht në përgjigje të ndryshimeve aktuale klimaterike dhe nuk janë adaptuar për t'i rezistuar impakteve afatmesme dhe afatgjata të ndryshimeve klimaterike. Adaptimi po bëhet gjithnjë një çështje e rëndësishme për SAI-t pasi këto impakte sjellin risqe financiare për qeveritë. Për

shembull, gjatë dekadës së fundit, qeveria e SHBA-së ka shpenzuar rreth 300 miliardë dollarë për shkak të kostove nga moti ekstrem dhe zjarret (siç është raportuar në kërkesën buxhetore të vitit 2016 të Presidentit).

Për më tepër, Akademikët Kombëtarë të SHBA-së besojnë se kostot priten të rriten pasi ngjarjet e rralla të motit ekstrem po bëhen gjithnjë e më të shpeshta. SAI-et e Holandës dhe SHBA-së kanë kryer auditime mbi adaptimin përgjatë disa viteve. Ky artikull ofron një panoramë të kornizave të përdorura për këto auditime, rezultatet dhe impaktet e punës së tyre dhe sfidat me të cilat mund të përballen SAI-t.

Këto shembuj tregojnë se adaptimi, pra masat adaptuese, mund të auditohen nga SAI-et në shumë mënyra dhe auditime të tilla mund të kenë impakte pozitive.

Korniza audituese

SAI i Hollandës (NCA) zhvilloi një auditim në 2012 me kërkesë të EUROSAI WGEA për të marrë pjesë në një auditim të koordinuar adaptimi (2). Nga një perspektive kombëtare, ky auditim është i rëndësishëm për shkak të rëndësisë sociale dhe marrëveshjeve ndërkombëtare që ka nënshkruar Holanda, si Konventa e Kornizës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimaterike (UNFCCC). Për më tepër, auditimet e mëparshëm të NCA kanë zbuluar se shpenzimet qeveritare mbi politikat klimaterike mund të dëmtojnë financat publike.

NCA shqyrtoi politikën klimaterike të adoptuar në 2007, me fokus në :

1. Vlerësimin e riskut dhe cënueshmërisë në nivel kombëtar (shiko figurën 1)

2. Hartimin, koordinimin dhe monitorimin e politikës kombëtare të adaptimit;

3. Aspektet financiare (shpenzimet, kostot, përfitimet)

Kjo kornizë reflekton një qasje gjithëpërfshirëse të hartuar për të ofruar një shqyrtim të hollësishëm mbi organizatën dhe progresin e arritur nga politika e adaptuar. Përgjatë viteve, GAO ka publikuar një sërë raportesh mbi adaptimin. Bazuar në këtë punë të kryer, GAO theksoi në Listën e Risqeve të Larta: "Të kufizojmë risqet fiskale të qeverisë amerikane duke menaxhuar risqet e ndryshimeve klimaterike", e cila tërhoqi vëmendjen e agjencive amerikane në ato fusha me risqe të lartë mashtrimi, abuzimi, keqmenaxhimi ose që janë nën transformim. Në veçanti, GAO identifikoi zonat ku duhen bërë përmirësime të gjera për të reduktuar risqet fiskale, duke krijuar një kornizë për kryer auditime të adaptimit. Këto fusha përfshijnë, por nuk kufizohen, tek roli i qeverisë amerikane si:

1. Lider i planit strategjik që koordinon veprimet federale, si dhe informon mbi aksionin shtetërore, lokal dhe të sektorit privat;

2. Zotërues ose operator i infrastrukturës shtetërore;

3. Garantues i pronës dhe kulturave bujqësore që cenohen nga ndryshimet klimaterike;

4. Ofrues i të dhënave dhe asistencës teknike ndaj shumë vendimmarrësve, përgjegjës për menaxhimin e impakteve të ndryshimeve klimaterike dhe;

5. Ofrues i dëmshpërblimeve nga katastrofat.

Në shkurt 2017, GAO botoi një version të përditësuar të Listës së Risqeve të Larta dhe përcaktoi se qeveria ka shënuar progres mbi këtë çështje por nuk ka plotësuar të gjithë kriteret për heqjen e tyre nga lista (3).

Sfidat

SAI-et kanë aftësinë për të adaptuar qasjen audituese. Ndryshimet klimaterike përbëjnë një çështje komplekse dhe shumë SAI-e kanë mandatin për të ushtruar kontroll mbi një sërë fushash politike për të forcuar funksionet qeveritare. Megjithatë, SAI-t mund të përballen me disa sfida kur auditojnë këto masa adaptimi, përfshirë:

Pasigurinë. Masat adaptive për të adresuar probleme afatgjata me impakte që mund të shfaqen gradualisht, në nivele të ndryshme pasigurie. Kështu, audituesit duhet të kenë parasysh natyrën dinamike të adaptimit gjatë kryerjes së auditimeve kur formulojnë konkluzionet dhe rekomandimet, diçka që NCA e realizoi në 2012. Ndër të tjerat, NCA konkludoi se qeveritë pasuese nuk kanë një kuptim të qartë mbi risqet që derivojnë nga ndryshimet klimateriken në një sërë fushash dhe kishin ulur vigjilencën mbi atë sesi mund të ndikonin këto risqe. Si rezultat, NCA u rekomandoi periodikisht qeverive të analizonin risqet e ndryshimeve klimaterike në të gjithë sektorët, e më pas të integronin dhe vlerësonin rezultatet e këtyre analizave me qëllimin sigurimin e një vendimmarrjeje politike për rishikimin e politikave mbi adaptimin me ndryshimet klimaterike.

Dimensionet lokale, rajonale dhe globale të adaptimit. Është e rëndësishme për audituesit të jenë të vetëdijshëm se impaktet potenciale të ndryshimit të klimës në një vend të caktuar mund të ndikojnë në rajone të tjera të botës dhe në të gjithë sektorët (4). Për shembull, sipas një studimi të kryer nga Administrata e Shërbimeve të Përgjithshme Amerikane, një ngjarje e vetme e lidhur me klimën mund të ketë efekte komplekse, me një gamë ndikimesh të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, në të gjithë sektorët. Sipas studimit, këto efekte u provuan në vitin 2011 kur përmbytjet e rënda ndërprenë prodhimin elektronik në Tajlandë, duke çuar në vonesa dhe ndërprerje për kompanitë në mbarë botën. Në kohën që ndodhi përmbytja, 45% e hard-drive-ve kompjuterikë në botë prodhoheshin në Tajlandë. Pavarësisht natyrës rajonale të impakteve të ndryshimit klimatik, audituesit duhet të jenë të ndërgjegjshëm se përpjekjet e përshtatjes zakonisht janë specifike sipas vendit dhe vendndodhjes. Çdo vend dhe pozicion gjeografik ka nevojat e veta të adaptimit dhe të burimeve, të cilat mund ta bëjnë të vështirë krahasimin me përpjekjet në vendet e tjera. Sidoqoftë, SAI-t ende mund të mësojnë nga praktikat e vendeve

të tjera. Për shembull, si pjesë e një shqyrtimi të vitit 2015 të përpjekjeve federale të SHBA-ve për të siguruar informacione mbi klimën, GAO studioi se si Gjermania, Holanda dhe Mbretëria e Bashkuar përdornin sisteme të informacionit mbi klimën për të dhënë mësime të nxjerra për zhvillimin e një sistemi informacioni kombëtar amerikan mbi klimën (5) .

Kriteret e duhura. Ekzistojnë kritere që mund të përdoren ose përshtaten për auditimet e adaptimit, edhe pse kjo është një fushë relativisht e re. Si shembull, kriteret e auditimit të NCA-së të vitit 2012 janë nxjerrë kryesisht nga marrëveshje (ndër) kombëtare të nënshkruara nga Holanda (p.sh. UNFCCC) dhe standardet e vitit 2010 të vendosura nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI), WGEA në "Auditim mbi Përgjigjen e Qeverisë ndaj Ndryshimeve Klimatike: Udhëzues për Institucionet Supreme të Auditimit" (6) . INTOSAI, gjithashtu, ofron standarde bazë për mirëqeverisjen, të tilla si alokimi i qartë i përgjegjësive ndaj aktorëve publikë të përfshirë në politikë. GAO ka përdorur një sërë kriteresh, duke përfshirë udhëzimet e agjencisë së brendshme "Standardet për Kontrollin e Brendshëm në Qeverinë Federale (7), si dhe Urdhrat Ekzekutivë Presidencialë që drejtojnë agjenci të caktuara në zbatimin e ligjeve ose politikave.

Terminologjia. Edhe pse një fushë më e re, përshtatja lidhet me koncepte të njohura për SAI-t, të tilla si menaxhimi i riskut, elasticiteti dhe zbutja e riskut, siç ilustroi GAO në Maj 2016 (shiko figurën 2 në link-un më poshtë (8)). Prandaj, SAI-t janë në gjendje të përdorin terminologji të ngjashme kur auditojnë përshtatjen.

Figura 2: Marrëdhëniet midis rreziqeve, elasticitetit, zbutjes së rreziqeve dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike

Auditime me Impakt

SAI-t mund të auditojnë masat adaptive për të përmirësuar praktikat e qeverisë dhe të zhvillojnë reduktime potenciale në kosto, pavarësisht pasigurisë dhe kompleksitetit të ndryshimeve klimatike. Në vitin 2014, GAO zbuloi se rritja e çmimeve të pronave në zonat me prirje rreziku kanë rritur humbjet, dhe se ndryshimi i klimës mund ta zmadhojë këtë efekt. Të dhëna nga Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave Federale (FEMA) dhe Agjencia e Menaxhimi të Riskut treguan se ekspozimi ndaj humbjeve potenciale të pronave të siguruara u rritën me 8 për qind, nga 1.3 trilionë $ në 2007, në 1.4 trilion $ në 2013 (9). GAO rekomandoi që FEMA dhe RMA të ndërmerrnin hapa për të inkurajuar siguruesit e përmbytjeve dhe të të mbjellave duke miratuar praktika me qëllim reduktimin e riskut afatgjatë dhe të ekspozimit federal ndaj humbjeve. FEMA u pajtua me rekomandimin e GAO-s, ndërsa RMA as u pajtua e as nuk u pajtua. Në një shembull tjetër, në vitin 2015, GAO zbuloi se vetëm disa nga agjencitë federale amerikane të përzgjedhura kishin zbatuar veprimet për të menaxhuar risqet që lidhen me klimën në zinxhirët federalë të furnizimit , të cilët transportuan afërsisht 445 miliardë $ mallra dhe

shërbime për vitin fiskal 2014, pjesërisht për shkak të të qenit në fazat e para të planifikimit dhe jo-identifikimit të plotë të këtyre risqeve (10). GAO arriti në përfundimin se, duke mos ditur rreziqet e mundshme do të thotë që Agjencitë Amerikane nuk janë të pozicionuara mirë për të identifikuar ose zbatuar veprime për të menaxhuar këto risqe, të cilat mund të komprometojnë misionet dhe të shtrijnë burimet e kufizuara. Me qëllim për të ndihmuar Agjencitë Amerikane që të menaxhojnë këto risqe, GAO rekomandoi që Këshilli i Shteteve të Bashkuara mbi Cilësinë e Mjedisit të sqarojë udhëzimin e tij mbi përfshirjen e risqeve të zinxhirit të furnizimit në planet e përshtatjes së agjencisë dhe të ndërmarrë një plan për thirrjen e një grupi pune midis agjencive mbi dobësitë e zinxhirit të furnizimit të klimës. Këshilli ra dakord dhe zbatoi rekomandimet e GAO-s brenda një viti nga raporti. Përveç kësaj, një nga rekomandimet kryesore të NCA-së të vitit 2012 ishte që qeveria të implementonte një program kombëtar të adaptimit ndaj klimës të përbërë nga një paketë koherente veprimesh, projektesh dhe aktivitetesh, dhe të mbulonte të gjitha fushat e politikave që kërkojnë përshtatje ndaj ndryshimit të klimës. Që nga viti 2012, qeveria holandeze i ka adresuar të gjitha rekomandimet e raportit. Në Dhjetor 2016, kabineti i paraqiti Parlamentit një Strategji të re Kombëtare të Klimës, që synonte ta kthente Holandën elastike ndaj klimës, në të gjithë sektorët.

Për më shumë informacion rreth auditimeve të përmendura në këtë artikull ju lutemi kontaktoni: Znj. Michelle Wong (WongM@gao.gov) ose Znj. Willemien Roenhorst (w.roenhorst@rekenkamer.nl).

Referenca

(1) EUROSAI Working Group on Environmental Auditing, Adaptation to Climate Change–Are Governments Prepared? A Cooperative Audit (2012).

(2) Netherlands Court of Audit, Adaptation to Climate Change: Strategy and Policy (2012).

(3) GAO, High-Risk Series: An Update, GAO-17-317 (Washington, D.C.: Feb. 15, 2017).

(4) Riverside Technology, Inc. and Acclimatise, Climate Risks Study for Telecommunications and Data Center Services (2014).

(5) GAO, Climate Information: A National System Could Help Federal, State, Local, and Private Sector Decision Makers Use Climate Information, GAO-16-37 (Washington, D.C.: Nov. 23, 2015).

(6) INTOSAI Working Group on Environmental Auditing, Auditing the Government Response to Climate Change: Guidance for Supreme Audit Institutions (June 2010).

(7) GAO, Standards for Internal Control in the Federal Government, GAO-14-704G (Washington, D.C.: September 2014).

(8) GAO, Climate Change: Selected Governments Have Approached

Adaptation through Laws and Long-Term Plans, GAO-16-454 (Washington, D.C.: May 12, 2016).

(9) GAO, Climate Change: Better Management of Exposure to Potential Future Losses is Needed for Federal Flood and Crop Insurance, GAO-15-28 (Washington, D.C.: Oct 29, 2014).

(10) GAO, Federal Supply Chains: Opportunities to Improve the Management of Climate-Related Risks, GAO-16-32 (Washington, D.C.: Oct. 13, 2015).

Përktheu: Redi Ametllari, specialist

Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Përgatitja e Institucioneve Supreme të Auditimit për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm

Marrë nga "INTOSAI Journal", pranverë 2017

Institucionet Supreme të Auditimit luajnë një rol të rëndësishëm në implementimin e Objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm (OZHQ), një set me 17 objektiva dhe 169 synime të cilat duhet të realizohen deri në vitin 2030. Kombet e Bashkuara besojnë se SAI-et janë të rëndësishme për promovimin, forcimin, eficiencën, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike.

Nga: Blucer W. Rajaguguk, I Gusti Bagus Tridarwata Yatnaputra dhe Adrianus Paulus

Bordi i Auditimit i Republikës së Indonezisë (BPK)

Hyrje

Institucionet Supreme të Auditimit luajnë një rol të rëndësishëm në implementimin e Objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm (OZHQ), një set me 17 objektiva dhe 169 synime të cilat duhet të realizohen deri në vitin 2030. Kombet e Bashkuara besojnë se SAI-et janë të rëndësishme për promovimin, forcimin, eficiencën, llogaridhënien, efektivitetin dhe transparencën e administratës publike. Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) ka hartuar një kornizë për auditimet që lidhen me OZHQ. Duke qenë se këto objektiva janë tashmë në axhendën globale, është më shumë i domosdoshëm se kurrë koordinimi midis SAI-eve për auditimin e këtyre objektivave. Ky artikull shpjegon se si duke punuar së bashku për auditimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm mund të arrijmë rezultate më efektive për të bërë më të mirën për qytetarët në mbarë globin.

Auditimet të kryera në bashkëpunim

Auditimet në bashkëpunim (siç shpjegohen në draftin e ISSAI 5800) janë auditime që kryhen nga dy ose më shumë SAI-e. Auditimet e kryera në bashkëpunim ndahen në: auditime paralele, të koordinuara dhe të bshkëpunim. Në auditimet paralele, auditime të ngjashme kryhen ne mënyrë simultane nga dy ose më shumë trupa audituese. Ndërkohë çdo trupë auditimi ka grupe auditime të veçanta të cilat raportojnë veçmas tek organet drejtuese të SAI-t për çështje brenda mandatit. Megjithatë ato ndjekin

të njëjtën metodologji dhe qasje. Një auditim i koordinuar është si auditimi i kryer në bashkëpunim me raporte të veçanta auditimi të cilat i paraqiten trupës menaxhuese të SAI-eve të ndryshme ashtu edhe auditimet paralele me raporte të veçanta (shtesë e raporteve të veçanta kombëtare). Në auditimet e kryera në bashkëpunim vendimet kryesore bëhen të njohura dhe auditimi kryhet nga një grup auditimi në të cilin marrim pjesë grupe audituese, të cilat zakonisht përgatisin një raport auditimi të përbashkët dhe ja paraqesin një organi drejtues (p.sh. INTOSAI -it).

Tabela 1 paraqet karakteristikat që lidhen me çdo lloj auditimi të kryer në bashkëpunim. Megjithatë ndryshimi midis tyre nuk është gjithnjë i qartë. Bazuar në ISSAI 5800, shkalla e bashkëpunimit varijon nga vazhdimësia e auditimeve paralele tek audimet e përbashkëta dhe lloji i bashkëpunimit për kryerjen e auditimit nuk më është i rëndësishëm se sa siguria që SAI-et të kenë të njëjtin opinion për të gjitha pikat e rëndësishme.

Llojet e Auditimit				
	Auditimi Paralel	***Auditimet e koordinuara***		***Auditimet e përbashkëta***
Grupi i auditimit	Auditim kombëtar	Auditim kombëtar	Grup i përbashkët	Grup i përbashkët
Objektivat	Të ngjashme/pjesërisht të ngjashme	Të ngjashme/pjesërisht të ngjashme	Identike	Identike
Qëllimi	I ngjashëm/ pjesërisht i ngjashëm	I ngjashëm/ pjesërisht i ngjashëm	Identike	Identike
Metodologjia	E ngjashme	I ngjashëm/ pjesërisht i ngjashëm	Identike	Identike
Kryerja e auditimit	Pothuajse simultane	simultane		
Raporti	Grup kombëtar	Raport auditimi i përbashkët	Raport në nivel kombëtar	Grup i përbashkët
Vlerësimi	Grup kombëtar		Grup i përbashkët	Grup i përbashkët

Tabla 1: Karakteristikat e auditimeve të kryera në bashkëpunim (sipas llojit). Burimi: Drafti i ISSAI 5800

Auditime në bashkëpunim janë kryer nga SAI-et në të shkuarën, veçanërisht në fushën e mjedisit (tabela 2). Këto auditime u mundësojnë SAI-eve të ndajnë standardet, njohuritë dhe eksperiencat dhe ato japin referenca si për SAI-et ashtu edhe për qeveritë. Për këtë arsye Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm mund të implementohen nga qeveritë pasi kjo ju mundëson atyre implementimin e tyre në të njëjtën fazë dhe me të njëjtën shpejtësi.

Viti	*Subjekti i Auditimit*	*SAI-et pjesëmarrëse*
2007	Auditim paralel për mbrojtjen e lumit Bug	Bjellorusia, Polonia, Ukraina
2007	Auditim performance për projektet shtetërore dhe situatën e mjedisit për lumin Plicomayo	Argjentina, Bolivia, Paraguaj
2010	Auditim ndërkombëtar i koordinuar për ndryshimet klimatike *Implikimet kryesore për qeveritë dhe audituesit (UNFCCC, Protokolli i Kyotos)*	Kanada, Australia, Austria, Brazili,Estonia, Finlanda,Greqia, Norvegji, Polonia, Sllovenia, Afrika e Jugut, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara të Amerikës
2013	Auditim paralek për parapërgatitjen për rastet e katastrofave	Turqia, Azerbajxhani, Kili, India, Holanda, Pakistani, Filipinet, Rumania, Ukraina

Tabla 2: Shembuj të auditimeve të kryera në bashkëpunim. Burimi website i INTOSAI WGEA

Referuar raportit të objektivave të zhvillimeve të mileniumit 2015 (pararendëse të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm) veprimet globale janë rruga e vetme për të siguruar që axhenda e miratuar nuk do të lërë askënd pas (OKB 2015). Auditimet e kryera në bashkëpunim është një nga mënyrat për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe sigurojnë që askush të mos mbetet pas.

Cili lloj auditimi është më i miri?

Auditimet e përputhshmërisë dhe të performancës janë auditimet më të zakonshme të kryera në bashkëpunim që mund të përdoren gjithashtu për auditimi e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Auditimet e përputhshmërisë janë më të mira si në rastet kur objektivat janë të përfshira në programet e qeverisë por edhe kur ato nuk janë përfshirë në to. Në këtë mjedis ekzistojnë disa politika qeveritare të cilat përputhen me objektivat e qëndrueshme të zhvillimit(pavarësisht se nuk janë deklaruara) ndërkohë që disa të tjera nuk përputhen. Pavarësisht se objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm nuk janë ligjërisht detyruese pritet që qeveritë:

1. Të adoptojnë dhe të hartojnë politika për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm;
2. Të shqyrtojnë procesin e implementimin duke u bazuar në të dhëna dhe analiza të besueshme në nivel kombëtar;
3. Të kontribuojnë në vlerësimin në nivel rajonal dhe global (Këshilli ndërkombëtar i shkencës dhe Këshilli ndërkombëtar i shkencave sociale 2015 cituar në Simpson 2016, faqe 166).

Qëllimi 1 – Zhdukja e varfërisë	*Indikatori*
1.1 Deri në vitin 2030, të zhduket varfëria ekstreme për të gjithë njerëzit kudo ku jetojnë	1.1.1 Përqindja e popullsisë që jeton nën nivelin ndërkombëtar të varfërisë
1.2 Deri në vitin 2030, të përgjysmohet përqindja e burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave që jetojnë në varfëri	1.2.1 Përqindja e popullsisë që jeton nën nivelin kombëtar të varfërisë
	1.2.2 burrave, grave dhe fëmijëve të të gjitha moshave që jetojnë në varfëri në të gjitha dimensionet e saj sipas përkufizimeve kombëtare.
1.3 Deri në vitin 2030, të arrihet një mbulimi i konsiderueshlm i mbrojtjes sociale të të varfër dhe të pambrojtur	1.3.1 Përqindja e popullsisë e mbuluar nga sistemet e mbrojtjes sociale
1.4 Deri në vitin 2030, të sigurohet që meshkujt dhe femrat të kenë të drejta të barabarta në burime ekonomike, shërbime bazë, pronësi, kontrollin mbi tokën dhe forma të tjera të pronësisë, trashëgimisë, burimeve natyrore, teknologjive të reja të përshtatshme dhe shërbimeve financiare, duke përfshirë mikrofinancimin	1.4.1 Përqindja e popullsisë që jeton në familje me qasje në shërbimet bazë
	1.4.2 përqindja e përgjithshme popullatës me të drejta të sigurta për të poseduar tokë
1.5 Deri në vitin 2030, të ndërtohen banesa të qëndrueshmëria për të varfrit dhe të prekurit nga situata të rrezikshme duke zvogëluar ekspozimin dhe cënimin e tyre ndaj ngjarjeve ekstreme klimaterike, si dhe goditjeve dhe fatkeqësive te tjera ekonomike, sociale dhe mjedisore	1.5.1 Numri i vdekjeve, persona të humbur dhe personave të prekur nga katastrofa në 100,000 njerëz
	1.5.2 Humbjet ekonomike të drejtpërdrejta në fatkeqësi në raport me produktin e brendshëm bruto në nivel global
	1.5.3 Numri i vendeve me strategji kombëtare dhe lokale për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë
1.a Sigurimi i konsiderueshëm i burimeve nga një shumëllojshmëri e burimeve për zbatimin e programeve dhe politikat për t'i dhënë fund varfërisë në të gjitha dimensionet e saj	1.a.1 Përqindja e burimeve të alokuara nga qeveria drejtpërsëdrejti në programet e reduktimit të varfërisë
	1.a.2 Përqindja e shpenzimeve totale të qeverisë në shërbimet thelbësore (arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale)
1.b Krijimi i kornizave të politikave në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, bazuar në zhvillimin e strategjive pro të varfër dhe çështjeve sensitive gjinore	1.b.1 Përqindja e shpenzimeve korrente dhe kapitale të qeverisë për sektorët që përfitojnë në mënyrë jo proporcionale gratë, grupet e varfra dhe të cenueshme

Tabla 3: Qëllimet dhe indikatorët tregues për realizimin e Objektivit I. Burimi: UNSTAT i OKB

Qasja e auditimit të performancës

Auditimi i Performanës bazohet përgjithësisht në një nga tre qasjet: orientimin drejt sistemit, rezultatit dhe problemeve. Qasja përzgjidhet duke u bazuar në kushtet dhe fazat e zbatimit të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të çdo vendi. Qasja e orientuar drejt sistemit është e përshtatshme për të vlerësuar masat parandaluese në rang kombëtar të cilat përfshijnë aktivitete të ndryshme të lidhura me planifikimin, kryerjen e auditimit, raportimin dhe ndjekjen e rekomandimeve. Qasja e orientuara drejt rezultateve është e përshtatshme për fazën e implementimit, e cila karakterizohet nga shmangiet midis fakteve dhe objektivave. Qasja e orientuar drejt sistemit përfshin planifikimin, kryerjen e auditimit, raportimin dhe procesin e ndjekjes se rekomandimeve. Planifikimi nënkupton përfshirjen e Axhendës së OKB-së në kornizën ligjore kombëtare si dhe planin për aktet rregullatore dhe politikat kombëtare.

Kryerja i referohet disponibilitetit të mjeteve për ta zbatuar atë, të tilla si institucionet përgjegjëse, objektivat parësore dhe të dhënat relevante për matjen e performancës. Raportimi i referohet disponibilitetit të mekanizmave të raportimit dhe institucioneve përgjegjëse për shqyrtimin e raportit. Ndjekja e rekomandimit i referohet mekanizmave për përmirësimin e mangësive që duhen përdorur në raportin e monitorimit si mjet vlerësimi për të përmirësuar programin në të ardhmen. Qasja e orientuara drejt problemit mund të përdoret në kushte kur ekzistojnë njohuri shumë të mira për zbatimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, rast i cili është mjaft evident në vendet e zhvilluara.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm kërkojnë informacion të qëndrueshme, të standardizuara dhe objektiv i cili është i aksesueshëm pa asnjë kosto dhe për çdokënd.

Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara (ECOSOC) ka hartuar tashmë treguesit e përgjithshëm ashtu si çdo vend mund të ketë hartuar më parë tregues të veçanta në referencë të treguesve të sipërcituar. Audituesit duhet të shqyrtojë zbatimin e këtyre treguesve për të ndihmuar SAI-t në mbledhjen e rezultateve të auditimit, si në kuadrin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Eksperienca e Indonezisë për implementimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm

Në të ardhmen, SAI-t mund të projektojnë auditime të përshtatshme në bazë të disa indikatorëve. OKB ka hartuar disa tabela të cilat ilustrojnë objektivat dhe treguesit e lidhura me to.

Në mënyrë të veçantë për Qëllimin e I (shih Tabelën 3), objektivat e renditura në mënyre alfabetike i referohen mjeteve të nevojshme për implementimin e tyre. Treguesit në zonën me ngjyrë të kuqe i referohen treguesve të disponueshëm në

Indonezi. Duke qenë se auditimi i objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm mund të përqendrohet në objektiva apo tregues të veçantë, në fazën e implementimit SAI-t mund të auditojë arritjet e një treguesi të vetëm ose të gjithë indikatorët të disponueshëm që lidhen me një objektiv të veçantë. Megjithatë, të dhënat për disa tregues janë të disponueshme nga disa ministri dhe jo vetëm nga Instituti i Statistikave. Për shembull, pothuajse të gjithë të dhënat për Objektivin I janë të dhëna që i disponon Ministria e Bujqësisë, çka kërkon që SAI të vlerësojë vlefshmërinë e tyre. Disa ishin pyetjet e shtruara në këtë rast si p.sh. *"A ka Ministria e Bujqësisë autoritetin dhe burimet e nevojshme për të kryer mbledhjen e të dhënave? A janë përdorur mjetet dhe metodologjitë e njohura për mbledhjen e të dhënave?"*. Në mënyrë të ngjashme, mund të ngrihen pyetje për listën e treguesve të ECOSOC të cilat nuk janë në dispozicion në nivel lokal, si p.sh:*" A duhet SAI të inkurajojë qeverinë (në këtë rast, Institutin e Statistikave) për inicimin e mbledhjes së këtyre treguesve? "*

Grupi i auditimit të kryer në bashkëpunim për programin e reduktimit të varfërisë. Rast studimor.

Strategjia e Reduktimit të Varfërisë në Indonezi është e komplikuar, pasi ajo përfshin nëntë programe të hartuara nga një ndërmarrje shtetërore dhe njëmbëdhjetë ministrive (Figura 2). Pavarësisht këtyre programeve, objektivi i reduktimit të varfërisë 2010-2014 nuk është përmbushur. Mospërmbushja e objektivit e shtyu Zyrën Kombëtare të Auditimit të Indonezisë (BPK)të kryej një auditim performance. BPK konfiguruar një auditim të koordinuar ndërmjet zyrës qendrore dhe përfaqësuese BPK-së në disa provinca. U krijuan 12 grupe auditimi për të audituar 12 subjekte qeveritare dhe 15 grupe nga zyrat rajonale të cilat audituan 15 njësi që qeverisjes vendore. Auditimi i njësive të qeverisjes vendore ishte i nevojshëm për të vlerësuar konvergjencën midis strategjisë kombëtare dhe lokale për reduktimin e varfërisë. Auditimi ka rezultuar në një raport të konsoliduar kombëtar dhe raporte auditimi për çdo njësi të qeverisjes vendore

Konkluzione

Auditimet e kryera në bashkëpunim nga anëtarët e INTOSAI-t janë vendimtare në shkëmbimin e njohurive, çka sjell zgjerimin impaktit të auditimit. Auditimet paralele, auditimet e përbashkëta dhe auditimet e koordinuara mund të përdoren për të vlerësuar masat përgatitore të ndërruara nga qeveritë dhe zbatimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.



Përktheu: Alma Shehu, specialiste Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë

Nga: Blucer W. Rajaguguk, I Gusti Bagus Tridarwata Yatnaputra dhe Adrianus Paulus

Bordi i Auditimit i Republikës së Indonezisë (BPK)

Info Kontrolli i Lartë i Shtetit

AKTIVITETE TË KLSH-së PËR PERIUDHËN JANAR – PRILL 2017

KLSH merr pjesë në Takimin e EUROSAI-t për Auditimin Paralel mbi Cilësinë e Ajrit

Në datat 26 - 27 janar u mbajt në Krakov takimi i radhës i SAI-ve të përfshira në Auditimin Paralel mbi Cilësinë e Ajrit, në të cilin është i angazhuar edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit. Kjo iniciativë koordinohet në nivel evropian nga Gjykata Holandeze e Llogarive dhe nga SAI Polak dhe në të janë përfshirë SAI-t nga 14 shtete si Bullgaria, Estonia, Hungaria, Rumania, Sllovakia, Spanja, Shqipëria, Gjeorgjia, Izraeli, Kosova, Maqedonia, Moldavia, Zvicra. Kësaj iniciative i është bashkuar së fundmi edhe Gjykata Evropiane e Audituesve. Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë aktivitet u përfaqësua nga z. Artur Hasanbelliu, Drejtor Drejtorie në KLSH, Prof. Dr Sazan Guri dhe znj.Xhuljeta Çelaj Audituese e Lartë në KLSH.

Ideja për një auditim evropian mbi mbrojtjen e cilësisë së ajrit është hedhur në kuadër të Organizatës Evropiane të Institucioneve Supreme të Auditimit (EUROSAI), duke i dhënë përgjegjësinë e koordinimit të këtij auditimi SAI-t Holandez dhe atij Polak. Qëllimi kryesor i këtij takimi ishte hartimi i një strukture të përbashkët për auditimin paralel mbi cilësinë e ajrit, si edhe paraqitja nga ana e përfaqësuesve të Agjencisë Evropiane të Mjedisit të Raportit mbi Cilësinë e Ajrit në Evropë i publikuar në fund të vitit 2016.

Takimi u hap nga Presidenti i NIK-ut Polak, z. Krzysztof Kwiatkowski, i cili u rikujtoi të pranishmëve se mbi 85 % e qytetarëve të BE-së kushtëzohen të marrin frymë në një ajër, i cili përmban substanca toksike në sasi që i tejkalojnë normat e lejuara evropiane. Për fat të keq, vetë Polonia hyn në listën e atyre shteteve ku matjet tregojnë pikërisht nivele të larta të këtyre substancave në ajër, të cilat shkaktojnë probleme shëndetësore shqetësuese, madje edhe vdekjen e rreth 45,000 njerëzve çdo vit në Poloni. SAI i Polonisë shpesh herë ka rekomanduar instalimin e disa pajisjeve të veçanta në bimë për të zvogëluar volumin e pluhurit dhe të

gazrave ndotës, reduktimin e emetimeve nga sistemet ngrohëse të banesave duke stimuluar forma alternative ngrohjeje, si edhe krijimin e zonave me trafik të kufizuar, por këto nuk kanë patur impaktin e shpresuar. Nëse këto rekomandime do të ngrihen në nivel evropian, atëherë impakti i tyre në axhendën e politik - bërësve do të jetë edhe më i madh. Objektivi final i këtij auditimi paralel, në të cilin KLSH është tashmë e angazhuar prej rreth një viti, do të ketë si qëllim kryesor vlerësimin e aktiviteteve të shteteve që kanë për qëllim rritjen e cilësisë së ajrit. Pjesëmarrja në këtë iniciativë të përbashkët evropiane, do ti lejojë Kontrollit të Lartë të Shtetit të shqyrtojë dhe vlerësojë veprimtarinë e subjekteve përgjegjëse për mbrojtjen e ajrit në vendin tonë duke e krahasuar atë me situatat e ngjashme në shtetet e tjera, falë auditimeve të kryera. Vetë ajri nuk është pronë e ndonjë shteti në veçanti dhe efektet e një ajri të ndotur nuk respektojë kufijtë politikë të shteteve, prandaj përpjekjet e përbashkëta dhe të koordinuara në këtë fushë janë thelbësore për të dhënë rekomandime të cilat të kenë efekt të dukshëm për qytetarët dhe që realisht përmirësojnë cilësinë e ajrit.

Kryetari i KLSH-së takon drejtues të lartë të GAO-s në Uashington D.C.

Në datën 30 janar 2017, Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj takoi në Uashington D.C. drejtues të lartë të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA (GAO), përkatësisht z. James-Christian Blockwood, Drejtor i Planifikimit Strategjik dhe i Marrëdhënieve me Jashtë dhe zj. Janet St. Laurent, Drejtoreshë e Qendrës së Ekselencës në Auditim.

Qendra e Ekselencës në Auditim është një strukturë qendrore e GAO-s që punon me të gjitha institucionet e auditimit dhe llogaridhënies qeveritare në botë, për të përmirësuar dhe shtuar, nëpërmjet trajnimeve të saj, kapacitetet e tyre në auditim. Qendra ndihmon institucionet supreme të auditimit publik (SAI-t) të zhvillojnë dhe zbatojnë korniza të shëndosha të sigurimit të cilësisë në auditim dhe plane strategjike e strategji të zhvillimit të burimeve të tyre njerëzore, duke rritur njohuritë për standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t.

Z. Leskaj dhe dy përfaqësuesit e lartë të GAO-s diskutuan fushat e bashkëpunimit me Qendrën e Ekselencës në trajnime afatgjata e afatshkurtra të audituesve shqiptarë, veçanërisht për Auditimin e Performancës dhe të IT, si edhe në sferën e Planifikimit Strategjik 2018-2022. Kryetari i KLSH shprehu vlerësimin e tij për ndihmën e deritanishme nga GAO dhe vullnetin e strategjinë e KLSH-se në këto vite për thellimin e bashkëpunimit. Ai i informoi drejtuesit e GAO-s për treguesit e institucionit shqiptar të auditimit në këto vitet e fundit, në fushën e kapaciteteve audituese dhe në thellimin e luftës kundër korrupsionit për përmirësimin e qeverisjes publike. Drejtuesit e GAO-s vlerësuan arritjet e KLSH-së, sidomos treguesit e mbulimit me auditime, gjetjet për mirë-administrimin e Buxhetit të Shtetit, kallëzimet penale, indeksin e dobishmërisë në auditim, etj. Gjatë bisedës u theksua rëndësia që kanë çështjet e etikës dhe integritet për

Institucionet Supreme të Auditimit dhe në këtë kontekst, z.Leskaj citoi një pjesë të leksionit, *"Etika dhe integriteti në auditim: një parakusht për mirëqeverisje"*, të mbajtur nga Audituesi i Përgjithshëm i GAO, z. Dodaro në "Shoqërinë Amerikanë për Administratën Publike", ku theksohet se *"....etika dhe integriteti janë të lidhur pazgjidhshmërisht me auditimin në funksion të transparencës, llogaridhënies dhe mirëqeverisjes. Këto standarde kanë ndikime konkrete tek puna e GAO-s dhe audituesit tanë. Për t'u shprehur më thjesht, etika dhe integriteti janë parësore për GAO-n. Në fakt, integriteti është një nga tre parimet kryesore të GAO-s. Dy të tjerat janë llogaridhënia dhe besueshmëria...."*.

Në përfundim, zoti Leskaj shprehu vlerësimin e tij për Zyrën e Auditimit të Qeverisë së SHBA dhe veçanërisht për Audituesin e Përgjithshëm të saj, z.Gene L. Dodaro që përgatitën strategjinë e zhvillimit të INTOSAI-t për periudhën 2017-2022, të cilën e lançuan në Kongresin e XXII të INTOSAI-t, në Abu Dhabi, me synimin për të rritur kontributin e SAI-ve në përforcimin e llogaridhënies dhe transparencës në menaxhimin financiar publik në të gjithë botën.

Zj. St. Laurent, me përvojë të gjatë në GAO, konfirmoi bashkëpunimin e mëtejshëm dhe bëri një pasqyrë të aktivitetit të Qendrës dhe arritjeve të saj, si edhe qasjet bashkëkohore, veçanërisht për përdorimin e teknologjisë së informacionit gjatë trajnimeve. Nga ana e tij, Drejtor i Planifikimit Strategjik dhe Marrëdhënieve me Jashtë, z. Blockwood konfirmoi mbështetjen e GAO-s, edhe nëpërmjet ardhjes së audituesve të GAO-s në Shqipëri për trajnime në fushat e kërkuara nga KLSH. Të dy palët ranë dakord për eksplorimin e mundësive për nënshkrimin e një marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën për Ekselencë në Auditim. Takimi u zhvillua në frymën e mirëkuptimit dypalësh dhe përmbushi pritshmëritë e KLSH-së, lidhur me bashkëpunimin mes dy institucioneve.

KLSH merr pjesë në takimin e VIII-të për Auditimin e Etikës, organizuar nga grupi Task Force (EUROSAI) për Auditimin e Etikës

Në datat 2-3 shkurt 2017, u zhvillua në Londër, takimi i VIII-të i grupit Task Force të EUROSAI-it për "Auditimin dhe Etikën" (TFA&E). Në cilësinë e anëtarit të këtij grupi, KLSH mori pjesë në këtë aktivitet të rëndësishëm të EUROSAI-t, i cili trajtoi një prej çështjeve më aktuale për administratën publike, Etikën, e cila është e lidhur me parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Trajtimi i kësaj teme është me rëndësi prioritare për institucionet supreme të Auditimit, të ngarkuara me mbikëqyrjen e menaxhimit të shëndoshë të financave publike. Në këtë takim morën pjesë përfaqësuesit e 18 SAI-ve: Gjykata Portugeze e Llogarive

që kryeson Task Forcën, Shqipëria, Republika Çeke, Gjykata Evropiane e Audituesve, Kroacia, Maqedonia, Izraeli, Italia, Malta, Holanda, Polonia, Mbretëria e Bashkuar, Rumania, Gjermania, Serbia, Spanja, Turqia dhe Hungaria. KLSH u përfaqësua në këtë aktivitet nga Sekretarja e Përgjithshme znj. Luljeta Nano, Drejtoresha e Drejtorisë së Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, znj. Irena Islami, znj. Amantja Patozi dhe znj. Armanda Begaj, audituese.

Zyra Kombëtare e Auditimit (NAO) e Britanisë se Madhe ishte SAI mikpritës, fjala përshëndetëse u mbajt nga z. John Thorpe, Anëtar i Bordit drejtues të NAO.

Punimet e këtij takimi u hapën ditën e parë me një informacion të përgjithshëm mbi TFA&E dhe aktivitetet e saj nga znj. Helena Abreu Lopes, Kryetare e TFA&E.

Gjatë ditëve të takimit u trajtuan dhe u diskutuar çështje si:

- "Cështjet e auditimit të Etikës në SAI-t Evropiane", NAO;
- "Investigimi i NAO-s lidhur me pranimin e dhuratave dhe procedurat e mikpritjes nga zyrtarët publikë: metodat dhe gjetjet";
- "Modulet e Integritetit / Rastet e auditimit të etikës", SAI i Hungarisë;
- "Gjetjet e auditimit të qeverisë", NAO ;
- "Forcimi i monitorimit dhe sistemet e kontrollit për etikën në SAI-e: udhëzime për zbatimin e ISSAI 30", ECA;

Gjatë ditës së dytë të takimit zoti Jacek Jezierski diskutoi lidhur me rezultatet e aktivitetit te TFA&E per EUROSAI-n dhe SAI-et dhe mësimet që duhet te nxjerrim. Zoti Jezierski theksoi se etika duhet të promovohet edhe në organizata të tjera publike.

Gjatë ditës së dytë të takimit u trajtuan edhe shumë shembuj praktikë që lidhen me dilemat etike, diskutimi i të cilëve ngjalli diskutime, në të cilat u përfshinë të gjithë pjesëmarrësit.

Dita e dytë e takimit u përshëndet edhe nga Presidenti i Gjykatës Portugeze te Llogarive z.Vitor Caldeira. Gjatë fjalës së tij zoti Caldeira theksoi se EUROSAI beson se Task Forca për Auditim & Etikën po studion dhe punon fort për të arritur qëllimin kryesor atë të promovimit të sjelljes etike si në Institucioneve Supreme të Auditimit dhe në organizatat publike. Në periudhën 2014-2017, Task Forca do të realizojë këto qëllime përmes dy fushave kryesore të aktivitetit: "Nxitja e etikës, si një shtyllë e Institucioneve Supreme të Auditimit" dhe "Promovimi i sjelljes etike në organizatat publike përmes auditimeve të SAI-ve". Në një përpjekje të përbashkët me anëtarët e task forcës dhe ekspertëve të ftuar, ne do të përpiqemi të vazhdojmë të ofrojnë produkte të rëndësishme për të

arritur këto qëllime. Ne do të përpiqemi që të jemi të dobishëm, për të rritur vlerat e SAI-ve, lidershipin dhe stafin e tyre, si dhe për qytetarët të cilëve u shërbejnë- vijoi z.Caldeira.

Në fund pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e këtij aktiviteti të EUROSAI-t dhe u la si detyrë finalizimi i udhëzuesit për auditimin e Etikës, i cili do të paraqitet në Kongresin e ardhshëm të EUROSAI-t në muajin maj në Stamboll.

Vizitë studimore në Zyrën Supreme të Auditimit të Kroacisë

Në datat 7-9 Shkurt, Kontrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë në vizitën studimore në Zyrën Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, në kuadër të projektit të binjakëzimit "Ngritja e kapaciteteve të auditimit të jashtëm në Shqipëri", financuar nga Bashkimi Evropian.

Takimi mes audituesve shqiptarë dhe kroatë u krye në funksion të auditimit pilot, i cili është duke u zhvilluar në Ministrinë e Zhvillimit të Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Ky auditim performance, përveç funksionit primar të matjes së efektivitetit, efiçencës dhe ekonomicitetit të programeve strategjike për zhvillimin e turizmit, do të kontribuojë edhe në plotësimin e hartës së të dhënave mbi zhvillimin e turizmit në rajonin e Ballkanit e më gjerë. Auditimi pilot mbi zhvillimin e turizmit është kryer më parë nën drejtimin e Zyrës Shtetërorë të Auditimit të Kroacisë në bashkëpunim me vende të tjera si Maqedonia dhe Hungaria. Gjatë vizitës studimore, audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit, znj. Eva Leka dhe znj. Miranda Berdo, prezantuan mënyrën e organizimit të strukturave përgjegjëse për zhvillimin e turizmit, ndryshimet ligjore, efektet e këtyre ndryshimeve ligjore gjatë dekadës së fundit si dhe etapat në të cilat ka kaluar hartimi i strategjisë kombëtare të zhvillimit të turizmit.

Kolegët kroatë shkëmbyen rastet e institucioneve të tyre lidhur me zhvillimin e turizmit duke prezantuar në këtë mënyrë edhe një nga modelet më të mira të turizmit në rajonin e Ballkanit, me qëllimi shkëmbimin e njohurive, eksperiencave dhe praktikave të mira në mënyrë që të kontribuojnë në përmirësimin e turizmit.

Kryetari i KLSH-së takon drejtues të Unionit të Punonjësve të Shqipërisë

Në datën 16 shkurt 2017, Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj realizoi një takim pune me drejtues të Unionit të Punonjësve të Shqipërisë dhe konkretisht: z. Veli Fejzullaj, President i Unionit, z.Myslym Zotaj, Sekretar dhe Koordinator i sindikatës, si edhe përfaqësuesit të tjerë të Unionit si Prof.Dr.Ing.Gjergji Foto, Ing.Qerim Ismeni, z.Mahmut Dodgjini dhe z.Bekim Hadini.

Takimi u fokusua në kërkesën e sindikalistëve lidhur me pushimin nga puna të 410 naftëtarëve nga Kompania

"Albpetrol". Në emër të sindikalistëve e mori fjalën Prof.Dr. Gjergji Foto, një inxhinier gjeolog dhe pedagog me përvojë në fushën e shfrytëzimit të burimeve të naftës. Prof.Foto, mbështetur në përvojën e tij 40 vjeçare në këtë fushë evidentoi problematikën në fushën e industrisë së naftës në dy dekadat e fundit dhe veçanërisht menaxhimin pa strategji zhvillimi, keqadministrimin, shpërdorimin dhe shkatërrimet e qëllimshme të vendburimeve të nxjerrjes së naftës, gazit dhe përpunimit të tyre për qëllime përfitimi personal nga ana e disa firmave të dyshimta. Punonjësit e Industrisë së naftës-vijoi Prof.Foto janë të shfrytëzuar, duke punuar për vite me radhë në kushte të vështira dhe aktualisht nuk po përfitojnë as dëmshpërblimin që u takon për largimin me pa të drejtë nga puna duke theksuar faktin që i janë drejtuar KLSH-së për zgjidhje sepse vlerësojnë punën profesioniste të audituesve të këtij institucioni, më së shumti auditimet e realizuara në vitet e fundit në AKBN dhe në Albpetrol, rekomandimet e të cilave janë shumë profesionale, të drejta dhe të bazuara në ligj. Rekomandimet e këtyre auditimeve do të vlerësohen nga UPSH dhe sindikalistët për ta zgjidhur problemin në favor të punonjësve të industrisë së naftës.

Kryetari i KLSH-së në fjalën e tij falenderoi përfaqësuesit e sindikatës për besimin që kanë në institucionin që ai drejton dhe vlerësoi faktin që në këtë grup bëjnë pjesë edhe profesionistë të shquar dhe të ndershëm të fushës së hidrokarbureve si Prof.Dr.Gjergji Foto. Zoti Leskaj theksoi se pavarësisht auditimeve të kryera në këto fusha nga KLSH në 3-4 vitet e fundit, institucioni do të thellojë auditimet në periudhën në vijim dhe do të vazhdojë të trajtojë problemet e ngritura nga sindikatat e punonjësve, duke i vlerësuar si çështje me interes të madh publik. Punonjësit e industrisë së naftës kanë të drejtën e tyre të ndjekin këtë çështje në rrugë ligjore, duke përdorur pa dyshim edhe zgjidhjet konkrete të propozuara nga KLSH, si institucioni më i lartë shtetëror për auditimin e jashtëm në Shqipëri. Në këtë takim Kryetari i KLSH-së shoqërohej nga Zj.Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme, zj.Albana Agolli, Drejtore e Departamentit të Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja &Shoqërive Publike, z. Alush Zaçe Drejtor Kabineti, zj.Irena Islami, Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Prof.Dr.Sazan Guri dhe Prof.Dr.Pajtim Ribaj. Takimi u zhvillua në frymën e mirëkuptimit dypalësh dhe përmbushi pritshmëritë e përfaqësuesve të sindikatës, të cilët falenderuan Kryetarin e KLSH-së për mbështetjen dhe për kohën që i kushtoi takimit dhe konfirmuan që do të vazhdojnë të ndjekin problemin e tyre në institucione të tjera të shtetit shqiptar, duke pasur si reference auditimet e realizuara nga KLSH në këto fusha në vitet e fundit dhe veçanërisht duke kërkuar

zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së për çështjet e diskutuara.

Zhvillohet Analiza vjetore e KLSH-së për vitin 2016

Në datat 27-28 shkurt 2017, në ambientet e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, Kontrolli i Lartë i Shteti zhvilloi analizën vjetore për vitin 2016. Kjo analizë vjetore e përgjithshme vijoi pas kryerjes së analizave vjetore të departamenteve të auditimit në disa nga universitetet kryesore publike të vendit në Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan dhe Shkodër. Ajo përmblodhi gjetjet, sugjerimet dhe vërejtjet nga ana e profesoratit dhe e shoqërisë civile të këtyre qyteteve, të cilët KLSH i falenderon për pjesëmarrjen dhe kontributin, por sidomos profesoratin dhe studentët, që na mikpritën në mjediset e tyre.

Në këtë analizë morën pjesë, Audituesi i Përgjithshëm i Kosovës, z. Besnik Osmani, zv/Presidenti i NIK-ut polak, z.Wojciech Kutyla, z.Jacek Jezierksi, Këshilltar i Presidentit të NIK-ut polak, Eksperti Amerikan i Bankës Botërore për projektin e prokurimeve publike, z.Simeon A Sahaydachny, akademikë dhe profesorë, si Prof. Dr. Jorgji Bollano, Prof.Dr.Sazan Guri, Prof.Dr.Sherif Bundo, Prof.Dr. Ago Nezha, përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, rektori i Universitetit të Vlorës Prof.Dr. Roland Zisi, pedagogë dhe studentë të këtij universiteti, gazetarë e përfaqësues të shoqërisë civile. Analiza Vjetore u hap me homazhe në nderim të dy audituesve të KLSH-së, të ndjerët Andi Buzo dhe Piro Imeraj, të ndarë papritur nga jeta.

Në prezantimin e kësaj analizë institucionale, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z.Bujar Leskaj e përkufizoi veprimtarinë për vitit 2016 të KLSH si "Auditim në shërbim të qytetarëve". Së pari, kemi përmbushur detyrën dhe mandatin tonë kushtetues, duke realizuar 154 auditime nga 154 të planifikuara. Së dyti, nga auditimet e vitit 2016, KLSH ka zbuluar. Dëm ekonomik, parregullsi dhe shkelje financiare (në të ardhurat publike dhe shpenzimet e kryera) në nivelin e 25.5 miliardë lekë. Gjetjet e auditimeve të KLSH gjatë vitit 2016 kanë rritur treguesin e dobishmërisë, efektivitetit të institucionit, një tregues ky qendror i Kuadrit të Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit, që vendos në raport sasinë e dëmit të kërkuar për zhdëmtim në Buxhetin e Shtetit, me sa i kushton taksapaguesve një SAI, i përdorur gjerësisht nga institucionet moderne evropiane të auditimit suprem dhe nga GAO amerikane. Për vitin 2016, për një lek të harxhuar nga KLSH, institucioni ka kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik për 78 lekë, e barabarte kjo me katër vite të marra së bashku, 2008, 2009, 2010 dhe 2011. Për pesëvjeçarin 2012-2016, mesatarja e treguesit të dobishmërisë ishte 127 lekë, ose mbi 6 herë më shumë se mesatarja e

pesëvjeçarit 2007-2011(20.6 lekë). Shifrat flasin vetë".

Ndër të tjera, Kryetari Leskaj theksoi se veprimtaria e KLSH-së përshkohet nga një luftë e thelluar kundër korrupsionit, ku çdo javë bëhet nga një kallëzim penal, një indikator ky që provon se Kontrolli i Lartë i Shtetit ndodhet në frontin e parë të luftës kundër korrupsionit.

Audituesi i Përgjithshëm i Kosovës, z. Besnik Osmani, në fjalën e tij, falënderoi Kryetarin e KLSH-së për angazhim institucional dhe personal që ka treguar për anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Institucioneve Supreme të Auditimit. Duke bërë një prezantim të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, z. Besnik Osmani theksoi se midis KLSH-së dhe ZKA-së ekziston një marrëdhënie e natyrshme, e cila është konkretizuar me ripërtëritjen e marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy institucioneve. "Zyra Kombëtare e Auditimit të Kosovës, do të jetë gjithmonë një shtëpi e dytë për audituesit e Shqipërisë", përfundoi fjalën tij z.Osmani.

Në përshëndetjen e tij, Rektori i Universitetit të Vlorës, z. Roland Zisi, theksoi se bashkëpunimi midis këtij universiteti dhe KLSH-së është kthyer tanimë në një traditë dobiprurëse për të dyja institucionet, veçanërisht për Universitetin e Vlorës. Sipas tij, Universiteti "Ismail Qemali" sheh tek KLSH-ja një ekspertizë të çmuar për implementimin e ligjit të ri të arsimit të lartë dhe të zhvillimit të veprimtarisë së tij në përputhje me kuadrin ligjor.

Prof. Dr. Jorgji Bollano, në emër të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, vlerësoi rolin e KLSH-së në përmirësimin e menaxhimit financiar publik, me auditime që venë theksin në zbatimin e standardeve të kontabilitetit. Profesori i shquar theksoi se bashkëpunimi që ofron Kontrolli i Lartë i Shtetit me ekspertët kontabël, reflektuar konferencat e përbashkëta dhe punimet shkencore të botuara në Revistën Auditimi Publik, ka ofruar zgjidhje për problemet e njësive ekonomike. "KLSH është një shembull për të gjitha institucionet në organizimin e konferencave dhe workshopeve ku profesionistë të fushave të ndryshme mund të kontribuojnë në forcimin e mirëmenaxhimit të financave publike", përfundoi Prof. Dr. Jorgji Bollano. Gjate diskutimit te tij Prof.Dr.Sazan Guri u përqendrua në bashkëpunimin e KLSH-së me organizata të shoqërisë civile, organizata të profesionistëve të fushës dhe me botën akademike që ka vijuar të jetë prioritet në punën e KLSH-së. Prof.Guri, evidentoi faktin që KLSH ka lidhur 42 marrëveshje bashkëpunimi, nga të cilat 24 me OJF, 12 me institucione homologe dhe të tjerat me institucione shtetërore dhe Universitete Publike. Të gjitha këto marrëveshje kanë ndikuar në rritjen e transparencës së veprimtarisë së

KLSH-së dhe në forcimin e kapaciteteve të audituesve.

Dita e parë vijoi punimet me prezantimin e analizave vjetore për çdo departament, me prezantimin e auditimeve me impakt të rëndësishme dhe me efekte të konsiderueshme në menaxhimin e financave publike dhe zhvillimin ekonomik të vendit, si auditimi i performancës mbi marrëveshjet hidrokarbure në Shqipëri, auditimi në Infrastrukturën Rrugore, Auditimet në Menaxhimin e Financave Publike, Auditimet në Dogana dhe Tatime, Auditimi në Sistemet Informatike, Auditimet në administrimin e pronave, etj.

Dita e dytë e Analizës Vjetore pati në qendër të punimeve sfidat që ka KLSH-së për të forcuar më tej pozitën e saj si "agjente e qytetarëve", në tre fusha: të zbatimit të standardeve ndërkombëtare ISSAI, të luftës kundër korrupsionit dhe rritjes së transparencës nëpërmjet zgjerimit të kanaleve të komunikimit. Në arritjen e këtyre objektivave, KLSH do të asistohet edhe nga Banka Botërore dhe Zyra Polake e Auditimit (NIK), në kuadër të projektit IPA. Eksperti Amerikan i Bankës Botërore për projektin e prokurimeve publike, zoti Simeon A.Sahaydachny njoftoi gjatë Analizës Vjetore se BB do të ndihmojë KLSH në krijimin e një manuali për prokurimin publik dhe në forcimin e kapaciteve audituese të KLSH-së në fushën e prokurimeve.

Zv/Presidenti i NIK-ut polak, z.Wojciech Kutyla, bëri një prezantim të vitit të parë të zbatimit të projektit IPA "Forcimi i kapaciteteve të auditimit të Jashtëm në Shqipëri" dhe të rezultateve që janë arritur mes audituesve shqiptarë dhe ekspertëve të projektit në funksion të modernizimit të KLSH drejt parametrave të Institucioneve Supreme të Auditimit të Evropës. Zoti Jacek Jezierksi, Këshilltar i Presidentit të NIK-ut polak shpalosi Strategjinë e EUROSAI-it për vitet 2018-2023 dhe analizoi objektivat e kësaj strategjie, me qëllim që SAI-t të kontribuojnë në realizimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, si pjesë e Axhendës 2030 të OKB.

Gjatë analizës, një rëndësi e veçante iu kushtua kolanës së botimeve të KLSH-së, e cila në pesë vitet e fundit 2012-2016 është pasuruar me 67 tituj, përkundrejt 12 titujve në periudhën 1991-2011. Kolana përçon drejtimet strategjike të reformimit të institucionit, që janë rritja e kontributit në përmirësimin e qeverisjes publike. Botimet e KLSH-së janë zbatim i detyrimeve ndërkombëtare të angazhimit të institucioneve të auditimit edhe në fushën e botimeve të dokumentacionit për t'i mundësuar qytetarëve një akses më të gjerë. Kolana e botimeve, e cila pasurohet nga viti në vit, pasqyron çdo kronikë të reformave që ka nisur KLSH dhe nëpërmjet tyre, rritet transparenca dhe

llogaridhënia e institucionit, duke rritur njëkohësisht edhe besimin e qytetarëve ndaj punës së KLSH-së.

Analiza për vitin 2016 është një moment reflektimi për të ardhmen dhe në këtë kontekst Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj, foli mbi perspektivat për vitin 2017, viti i realizimit të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2013-2017. Kryetari Leskaj theksoi se KLSH do të konsolidojë auditimet e përputhshmërisë bazuar në standardet ndërkombëtare, auditimet financiare, në veçanti në certifikimit të pasqyrave financiare, si dhe do të rrisë numrin e auditimeve të performancës në 10-15% të auditimeve totale dhe auditimet IT në 50%. ”Integriteti dhe etika do të jenë në themel të punës audituese. Do shtojmë prezencën në Parlament, në komisione për Ekonomitë dhe Financat si dhe në komisionet hetimore”, theksoi ndër të tjera kreu i KLSH-së.

Kryetari i KLSH-së, në përfundim të fjalës së tij iu uroi suksese audituesve në punën e tyre për vitin në vijim, duke e mbyllur me një citim të Krye-kontrollorit të SHBA-ve, z.Gene L. Dodaro, mikut të Shqipërisë, KLSH-së dhe shqiptareve: ”Ne në GAO nuk bëjmë politika, as marrim vendime politike, kjo i takon Kongresit. Por ne besojmë se duke u bazuar në të dhëna të shëndosha, zyrtarët publikë kanë më shumë gjasa të marrin vendime të informuara dhe të bëjnë gjënë e duhur. Ky informacion i besueshëm dhe objektiv është i nevojshëm urgjentisht sot, për shkak të shumë sfidave fiskale, sociale dhe të sigurisë me të cilat përballet kombi ynë”. Gjatë ditës së dytë, analiza u ndal në një moment të veçantë, atë të promovimit të librit të sociologut Gëzim Tushi. Kryetari i KLSH-së u shpreh se z.Tushi përfaqëson një personalitet të shquar të sociologjisë dhe politologjisë. “Z. Gëzim Tushi ka një kontribut të çmuar krijues si sociolog dhe politolog, duke qenë autor i 20 librave, që kanë në qendër qytetarin, shoqërinë civile, moralin dhe shtresat në nevojë. Ato ofrojnë një ballafaqim me problematikat sociale të vendit tonë dhe orientojnë shoqërinë, si në nivelin e qytetarit ashtu edhe të shtetarit, drejt atyre qasjeve që i adresojnë në thelb këto problematika”. Analiza vjetore 2016 u mbyll me mbajtjen e një leksioni tepër interesant nga z. Gëzim Tushi me audituesit e KLSH-së.

Gjatë dy ditëve të qëndrimit në qytetin e Vlorës, audituesit e KLSH-së vizituan Muzeun e Pavarësisë dhe Galerinë e Arteve të këtij qyteti. Analiza e KLSH-së u ndoq me interes nga mediat kombëtare, të cilat në edicionet e lajmeve transmetuan mesazhe të kësaj analize, ndërsa televizioni lokal “6+1” e transmetoi

të plotë analizën e veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2016.

Presidenti i Byrosë Shtetërore të Auditimit të Kuvajtit zhvillon një vizitë zyrtare dy ditore në Shqipëri

Në datat 6-7 mars 2017, Presidenti i Byrosë Shtetërore të Auditimit (SBA) të Kuvajtit, z. Adel Abdulaziz Al-Saraawi, zhvilloi një vizitë pune dy ditore në Shqipëri. Në përbërje të delegacionit ishin z. Ibrahim Abdullah Bukobar, Kryeauditues, Departamenti i Auditimit të Ministrive; znj. Fatma Yousef Al-Qattan, Specialiste mbi Organizmat Ndërkombëtare; znj. Fatma Abdullah Al-Abduljalil, Audituese e Asociuar, Departamenti i Shoqërive Publike dhe znj. Shiekha Khalid Al-Zair, Audituese e Asociuar, Departamenti i Punësimit. Gjatë takimeve të zhvilluara në ambientet e KLSH-së përgjatë dy ditëve, u bë një prezantim i dy institucioneve respektive, me qëllimin identifikimin e fushave dhe interesave të përbashkëta për nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi midis Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Byrosë Shtetërore të Auditimit të Kuvajtit, bazuar në një plan pune me një kalendar aktivitetesh.



Kryetari i KLSH-se z. Leskaj vuri në dukje dobishmërinë që do të sjellë zbatimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Byronë Shtetërore të Auditimit të Kuvajtit, i cili përfaqëson një institucion modern dhe inovativ, jo vetëm në ARABOSAI por edhe në komunitetin e INTOSAI-t. "SAB i Kuvajtit renditet ndër SAI-t e pakta që realizon auditimet të llojit "para-faktit" (ex-ante audit), si dhe ka mbi 20 vjet që kryen auditime të performancës në një numër të konsiderueshëm në nivel vjetor. Në kuadrin e bashkëpunimeve institucionale me vendet e rajonit, me Gjykatën Evropiane të Audituesve, me Zyrën e Auditimit të Qeverisë së SHBA-së (GAO) dhe aktualisht me SAB e Kuvajtit, KLSH plotësoi gjeografinë e bashkëpunimeve institucionale, të cilat përbëjnë shtyllat e modernizmit të KLSH-së".

Kreu i KLSH-së theksoi se Kuvajti është një vend mik i Shqipërisë, i cili ka mbështetur me donacione dhe projekte madhore zhvillimin e shumë sferave të ekonomisë shqiptare. Në frymën e këtij bashkëpunimi, Kryetari Leskaj shprehu angazhimin maksimal të KLSH-së për ripërtëritjen e marrëveshjes së

bashkëpunimit duke e konkretizuar përmes auditimeve të përbashkëta, vizitave të ndërsjellta të audituesve shqiptarë dhe atyre kuvajtianë, workshop-eve, si dhe në organizimin e konferencave të përbashkëta shkencore. "Mbështetja e Kuvajtit është e rëndësishme për Shqipërinë dhe ne si Kontroll i Lartë i Shtetit shohim një aspekt tjetër të këtij bashkëpunimi, përpos atij financiar, atë të ndërveprimit institucional përmes auditimeve të përbashkëta, me qëllim forcimin e kapaciteteve institucionale", u shpreh Kryetar i KLSH, z. Bujar Leskaj. Nga ana e tij, Presidenti i Byrosë së Auditimit të Kuvajtit, z. Adel Abdulaziz Al-Saraawi, falenderoi Kryetarin e KLSH-së për ftesën dhe pritjen miqësore, duke vlerësuar rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit në përmirësimin e menaxhimit financiar në Shqipëri si dhe reformat institucionale të ndërmarra nga KLSH, të cilat, theksoi ai, reflektohen dhe tek prezenca aktive e audituesve të KLSH-së në grupet e punës së INTOSAI-t. "Kemi respekt për punën Tuaj dhe kemi ardhur me aspirata të reja për të ngritur në një stad të ri bashkëpunimin mes KLSH-së dhe SBA-së". Presidenti Al-Saraawi prezantoi një plan pune ku do të bazohet marrëveshja e bashkëpunimit me KLSH-në duke theksuar se Byroja Shtetërore e Auditimit është e përkushtuar për të çelur një horizont të ri ndërveprim mes dy institucioneve, duke u fokusuar në fushat e menaxhimit të riskut, zbatimit të standardeve ndërkombëtare të INTOSAI-t, auditimit të sektorit të hidrokarbureve, transparencës dhe integritetit, kontrollit të brendshëm dhe auditimit mjedisor. Presidenti Al-Saraawi shprehu një interes të veçantë për Konferencën Shkencore të KLSH, të cilën e konsideroi si një forum të rëndësishëm në funksion të kërkimit shkencor në fushën e auditimit dhe më gjerë dhe mbështeti propozimin e z.Leskaj për organizimin e një konferencë të përbashkët shkencore, një pikë kjo e cila u pasqyrua edhe në marrëveshjen e bashkëpunimit.

Në kuadër të vizitës në Shqipëri, në datë 6 mars, delegacioni i Kryesuar nga Presidenti i SAI-t të Kuvajtit zhvilloi një takim me Presidentin e Republikës, SH.T.Z. Bujar Nishani me Kryetarin e Kuvendit, SH.T.Z. Ilir Meta në ambientet e Kuvendit të Shqipërisë dhe me deputetë të Parlamentit.



Gjatë takimi me delegacionin kuvajtian, Kreu i Shtetit, SH.T.Z. Bujar Nishani u shpreh se Kuvajti dhe Shqipëria kanë një miqësi të veçantë. *"Kuvajti ka tek Shqipëria një mik të përhershëm dhe ne jemi përgjegjës për të zhvilluar më tej këtë marrëdhënie. Vendi ynë ka dinamikë në zhvillimin ekonomik dhe roli i SAI-ve është me shumë rëndësi për miradministrimin e fondeve publike"*, përfundoi z. Nishani. Nga ana e tij, Presidenti Al-Saraawi falenderoi Presidentin për pritjen duke theksuar se së bashku me z. Leskaj do të punojnë për të konkretizuar marrëveshjen e bashkëpunimit, për të forcuar

llogaridhënien dhe transparencën në menaxhimin financiar.

Gjatë takimit me SH.T.Z. Ilir Meta, Kryetarin e Kuvendit, Presidenti i Byrosë shtetërore të Auditimit të Kuvajtit, Zoti Saraawi, vlerësoi rëndësinë e bashkëpunimit të SAI-ve me parlamentin, si institucion tek i cili SAI-t raportojnë por edhe institucioni që e mbështet veprimtarinë e SAI-ve, me qëllim përmirësimin e qeverisjes.

Zoti Meta vlerësoi marrëdhëniet e deritanishme me shtetin e Kuvajtit, të cilat i cilësoi si marrëdhënie vëllazërore. Zoti Meta konfirmoi se ai personalisht dhe institucioni që drejton janë mbështetës të fuqishëm të marrëdhënieve shumë të mira me shtetin e Kuvajtit dhe cilësoi në këtë drejtim vizitat e shumta të personaliteteve të rëndësishme të Kuvajtit në Shqipëri.

Në përfundim të takimeve dy ditore, Kryetari i KLSH-së, z. Bujar Leskaj dhe Presidenti i SAB, z. Adel Abdulaziz Al Saraawi nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit, duke përcaktuar edhe një kalendar të aktiviteteve për periudhën 2017-2021, bazuar në planin e punës të përditësuar. Delegacioni gjatë ditëve të qëndrimit në Shqipëri zhvilloi një vizitë në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë dhe në Muzeun e Pavarësisë në Vlorë.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të KLSH-së në iniciativën e bashkëpunimit midis Institucioneve të Auditimit Suprem (SAI) në auditime paralele të performancës, PPA II

Në datat 7-9 mars në qytetin e Shkupit u mbajt takimi i pestë i përfaqësuesve të institucioneve Supreme të Auditimit nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Serbia, Suedia, si dhe përfaqësuesve nga ECA, në vijim të bashkëpunimit të vendeve të rajonit në auditime paralele performance, iniciuar për herë të dytë nga NAO e Suedisë (Paralel Performance Audit, PPA II).

Në këtë aktivitet KLSH u përfaqësua nga z. Aulent Guri, Kryeaudituesi Departamentit të Performancës, z. Alfred Zylfi dhe znj. Elfrida Agolli, Audites.

Takimi u përshëndet nga znj. Tanja Tanevska Auditues i Përgjithshëm i Zyrës së Auditimit të Maqedonisë. Në këtë takim, nga të gjitha vendet pjesëmarrëse u diskutuan arritjet e tyre në auditimin e dakordësuar mbi "Prokurimin Publik". Gjatë tri ditëve të punës në këtë bashkëpunim rajonal për realizimin e PPA II nga grupet e tetë SAI-ve pjesëmarrëse u diskutua rreth:

•Procesit të Prokurimit Publik në vendet e tyre;

•Evidencat e auditimit që janë mbledhur, analizën dhe interpretimin e tyre;

•Problemet më të shpeshta që janë vërejtur, duke përfshirë pasojat e këtyre problemeve;

•Përmirësimin e gjetjeve nëpërmjet analizave më të thelluara e të detajuara;

•Hartimin në formë piramide të pyetësorëve për krijimin e një terreni sa më të përshtatshëm dhe frytdhënës në gjetjen e mangësive në subjektet e audituara;

•Mënyrën e shkrimit të raportit të auditimit për ta bërë atë sa më të qartë për lexuesin.

Të gjitha diskutimet kishin si qëllim krijimin e një baze për kryerjen e një auditimi sa më efektiv, paraqitjen e tij në mënyrë sa më të përshtatshme e të thjeshtë për lexuesin si edhe rritjen e shkëmbimit të njohurive dhe përvojës mes audituesve e institucioneve të vendeve që ato përfaqësonin.

Në ditët në vijim u diskutua më në detaje në ekipe të ndara midis përfaqësuesve të dy apo tre SAI-ve dhe ekspertëve që drejtonin këtë workshop për problematika të ndryshme lidhur me formulimin e pyetjeve, kryerjen e vlerësimeve apo llogaritjen në vlerë monetare nga grupet e auditimit të dëmeve të ndryshme që shkaktojnë subjektet e audituara, etj.

Takimi i radhës i PPA II u vendos tëorganizohet në Beograd në qershor të vitit 2017.

Takim i Përfaqësuesve të KLSH me Drejtorin e GIZ për Shqipërinë

Në datën 9 mars 2017 përfaqësues të KLSH-së zhvilluan në ambientet e GIZ një takim me Drejtorin e GIZ për Shqipërinë z. Hans-Jurgen Cassens. GIZ punon në Shqipëri në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) me qëllim rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë.

Përfaqësuesi i GIZ u informua për mënyrën e funksionit të KLSH-së dhe rolin e këtij institucioni të rëndësishëm kushtetues në përmirësimin e qeverisjes.

Zoti Hans informoi lidhur me mekanizmin e funksionimit të GIZ dhe fushat prioritare të bashkëpunimit të GIZ me Shqipërine në projektin ekzistues 2016-2017.

Nga ana e KLSH-së u shpreh angazhimi maksimal institucional për të vënë në dispozicion çdo lloj informacioni të nevojshëm për të mundësuar bashkëpunimin e mëtejshëm dhe mundësisht institucionalizimin e këtij bashkëpunimi. Në takim nga KLSH morën pjesë z.Luljeta Nano, Sekretare e Përgjithshme, zj.Lindita Milo, Drejtore e Përgjithshme, z.Ermal Yzeiraj, Drejtor i Departamentit Juridik dhe zj.Irena Islami, Drejtore e Drejtorisë së Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

KLSH merr pjesë në Panairin e Librit të organizuar nga Bashkia e Elbasanit dhe Shoqata Kulturore Artistike "DURANA"

Në datat 11-14 mars 2017 për herë të parë në qytetin e Elbasanit në kuadër të festimeve për "Ditën e Verës", u zhvillua "Panairi i librit", i organizuar nga Bashkia e Elbasanit dhe Shoqata Kulturore Artistike "DURANA". Në panair morën pjesë rreth 20 shtëpi botuese nga Shqipëria dhe Kosova. Ky panair u ndoq me shumë interes nga qytetarët e Elbasanit, si dhe nga studentët e Universitetit "Aleksandër Xhuvani".

Interes shfaqi për vizitorët edhe stenda e botimeve të KLSH-së, në të cilën ishin ekspozuar 67 botimet e periudhës 2012-2016 të KLSH-së. Në këtë panair u prezantuan për herë të parë 3 botime të periudhës nëntor - dhjetor 2016, si: 4 vjet Auditim Publik 2012-2015; SAI dhe Parlamenti (partneriteti) dhe Revista "Auditimi publik" nr. 14 (maj-gusht 2016).

Auditues të KLSH marrin pjesë në Trajnimin Intensiv Ndërkombëtar ITP për "Auditimin e Performancës, Lahore, Pakistan

Në Lahore të Pakistanit u zhvillua Programi i 98-të i Trajnimit Intensiv Ndërkombëtar ITP për "Auditimin e Performancës". Auditori i Përgjithshëm i Pakistanit është institucioni i vetëm i mandatuar nga Kushtetuta për të mbështetur Parlamentin në mbikqyrjen e përdorimit të fondeve publike. Në përmbushje të funksionit të tij kushtetues SAI ka rreth 1500 auditues të kualifikuar. SAI i Pakistanit është i ndarë në 4(katër) degë. Një degë e specializuar është vendosur në Lahore, e cila organizon trajnime mbi Auditimin e Performancës si për punonjësit vendas ashtu dhe për pjesëmarrës nga institucione ndërkombë-tare të auditimit. Organizimi i këtyre trajnimeve është një traditë shumëvjeçare dhe deri tani janë trajnuar me sukses 343 auditues të Institucioneve Supreme të Auditimit nga vende të ndryshme të botës dhe 1360 zyrtarët e Departamentit të Auditorit të Përgjithshëm të Pakistanit. Aktualisht programi për trajnimin e Auditimit të Performancës që u zhvillua ishte i 98 -ti dhe u organizua për një periudhë 4 javore, nga 20.02.2017 deri 17.03.2017.

Nga KLSH në këtë trajnim morën pjesë zj. Ermira Vojka, Audituese e Parë dhe zj.

Erieta Këlliçi – Audituese e Dytë. Trajnimi u fokusua në të gjitha fazat e Auditimit të Performancës sipas renditjes kronologjike të zhvillimit të auditimit, dhe u relatua nga trajnues të kualifikuar dhe certifikuar nga qendra të ndryshme ndërkombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, etj.

Gjatë javës së parë u prezantuan standardet ISSAI për auditimin e performancës, planifikimi i auditimit, përcaktimi i qëllimit të auditimit, risku i auditimit, pyetjet e auditimit dhe përcaktimi nëse do të zhvillohej auditimi ose do të rishikohej mundësia për të mos u zhvilluar. Në javën e dytë trajnimi u fokusua në temat, kontrollet e brendshme dhe faza e ekzekutimit të auditimit që u përfshi përgatitja e planit të auditimit, përkufizimi, burimi i të dhënave, kategoria, cilësia dhe llojet. Mënyra e mbledhjes së evidencave, teknikat dhe dokumentimi i tyre gjithashtu dhe analizimi i të dhënave. Në javën e tretë trajnimi u fokusua në zhvillimin në terren të auditimit, përgatitja e raportit përfundimtar, mbikëqyrja dhe rishikimi i auditimit. Në fund të kësaj jave u zhvillua një vizitë kulturore në kryeqytetin Islamabad ku u vizituan disa vende kulturore, muze dhe vende historike. Në datën 6 mars 2017 të gjithë pjesëmarrësit në trajnim u pritën nga Zëvendës Kryetari i Parë i Auditorit të Përgjithshëm i Pakistanit. Gjatë këtij takimi pjesëmarrësit u njohën me strukturën organizative dhe planin strategjik të Auditorit të Përgjithshëm të Pakistanit dhe u zhvillua një diskutim mbi ndryshimet dhe të përbashktat që kanë të gjitha SAI-t si anëtarë të INTOSAI-t.

Java e katërt u fokusua në fazën e raportimit të auditimit, krijimin e impaktit të auditimit, teknikat dhe mjetet në auditimin e performancës. Sigurimi i cilësisë në auditim si dhe faza e fundit e parashikuar zbatimi i rekomandimeve.

Në datën 17 mars u zhvillua ceremonia e përmbylljes së trajnimit të auditimit të performancës ku u shpërndanë nga Zëvendës Kryetari i Parë i Auditorit të Përgjithshëm i Pakistanit Certifikatat për përfundimin me sukses të trajnimit.

Drejtoresha e Qendrës për Ekselencë në Auditim të GAO-s, vizitë pune dy ditore në KLSH

Në datën 23 mars, znj.Janet St. Laurent, Drejtoresha e Qendrës së Ekselencës në Auditim të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA-së (GAO) zhvilloi një takim në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në kuadër të një vizite pune dy ditore që po zhvillon në Shqipëri. Në ambientet e KLSH, znj.Janet St. Laurent u takua me Kryetarin, z.Bujar Leskaj dhe drejtues të lartë të KLSH-së. Duke i uruar mirëseardhjen, Kryetari, z.Bujar Leskaj, u shpreh se vizita e znj. St.Laurent, e dyta vizitë e nivelit të lartë nga GAO, pas asaj të Kontrollorit të Përgjithshëm, z.David M. Walker në vitin 2004 dëshmon për forcimin e urave të bashkëpunimit midis dy institucioneve.

"Zyra e Auditimit të Qeverisë së SHBA-së është lider në komunitetin e INTOSAI-t, dhe në këtë cilësi, kjo vizitë është një formë "mini-peer review" për Kontrollin e Lartë të Shtetit. GAO ka përgatitur strategjinë e zhvillimit të INTOSAI-t për periudhën 2018-2022, një Strategji e cila do të fillojë implementimin në KLSH për të rritur kontributin në përforcimin e llogaridhënies dhe transparencës në menaxhimin financiar publik". Kryetari i KLSH-së theksoi vullnetin e tij personal dhe të institucionit që bashkëpunimi mes KLSH-së dhe GAO's të jetë permanent. Zoti Leskaj vlerësoi bashkëpunimin e frytshëm që GAO i ka ofruar KLSH-së në këto tre vitet e fundit, përmes programeve të trajnimit 4 mujore (fellowship) për audituesit shqiptarë, duke nënvizuar se kjo marrëdhënie ka një potencial të madh për t'u zgjeruar në fusha të tjera, si auditimet e performancës dhe auditimet IT. Ky takim zhvillohet në vazhdën e takimeve të Kryetarit të KLSH-së me z. Gene Dodaro, Auditor i Përgjithshëm i GAO, në vitin 2015 në Washington dhe në Kongresin e Abu Dhabit, në dhjetor të 2016, si edhe në vizitën e fundit në Washington në shkurt të vitit 2017.

Kryetari Leskaj theksoi se bazuar në Librin e Verdhë të GAO-s (Standardet e Auditimit të Qeverisë), të botuar nga KLSH në shqip, Kontrolli i Lartë i Shtetit do të përgatisë dhe botojë Librin e Verdhë të Standardeve të Auditimit të Qeverisë Shqiptare dhe kërkoi që audituesit e GAO të mbështesin rritjen e kapaciteteve në KLSH, jo vetëm me trajnime por edhe nëpërmjet asistencës profesionale në auditime të rëndësishme. Znj. Laurent, me përvojë të gjatë në GAO, falenderoi Kryetarin e KLSH-së për ftesën duke e konsideruar vizitën dhe takimin me përfaqësues të KLSH-së si pikënisje të një bashkëpunimi më të konsoliduar e konkret mes Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA-së.

Pasi u njoh me historikun, arritjet, sfidat, risitë e Ligjit të ri organik të Kontrollit të Lartë të Shtetit, zyrtarja e lartë e GAO-s vlerësoi progresin e arritur vitet e fundit në KLSH, veçanërisht në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të Auditimit si dhe fushën e trajnimeve që KLSH ofron për audituesit, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. "Vlerësoj fleksibilitetin e KLSH-së në përcaktimin e numrit dhe llojeve të auditimeve që do të realizohen, e cila është esenciale për veprimtarinë e një Institucioni Suprem Auditimi. Një indikator i rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve audituese është programi i trajnimeve. Në këtë fushë, KLSH ka krijuar një traditë solide, për të cilën GAO jep kontributin e saj përmes fellowship-eve për audituesit shqiptarë". Më tej, znj.St. Laurent i konsideroi inovative botimet e artikujve nga audituesit e KLSH-së në shtypin e shkruar, që sipas saj, forcon

transparencën duke krijuar linja konkrete komunikimi me qytetarët dhe vlerësoi botimet e KLSH-së në vitet e fundit, rekomandimet e dhëna nga institucioni për subjektet e audituara, kallëzimet penale, etj.

Diskutimi mes përfaqësuesve të KLSH-së dhe znj.Janet St.Laurent u fokusua më tej me ekspertizën që mund të ofrojë Qendra e Ekselencës në Auditim të GAO-s, përmes trajnimeve në fusha si auditimi i performancës dhe auditimit IT. Në këtë kuadër, Kryetari i KLSH-së e çmoi ekspertizën amerikane në auditim, jo vetëm si pjesë integrale të politikave të ndërmarra për modernizimin e institucionit, por si një finalizim dhe përmbushje të reformave për ngritjen e kapaciteteve audituese të KLSH-së. " KLSH është në një fazë ku po konkretizon frymën e bashkëpunimit për forcimin e kapaciteteve, falë edhe bashkëpunimit me SAI partnere si NIK-u Polak, Zyra e Audimit të Kroacisë, Gjykata Austriake e Auditimit, Gjykata Evropiane e Audituesve, etj. Në këtë drejtim, bashkëpunim me GAO-n përmbyll këtë cikël modernizimi për institucionin". Në përfundim të takimit, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, z. Bujar Leskaj dhe Drejtoresha e Qendrës për Ekselencë në Auditim të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA-së (GAO) znj. Janet St. Laurent u dakordësuan për identifikimin e fushave dhe prioriteteve të KLSH-së, me qëllim konkretizimin e kornizës së bashkëpunimit, ku do të bazohet asistenca e GAO-s për Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Drejtoresha e Qendrës së Ekselencës në Auditim të GAO-s, Znj. Janet St.Laurent, zhvillon një leksion me audituesit e KLSH

Në datën 24 mars, në sallën e Akademisë së Shkencave, znj.Janet St.Laurent, Drejtoreshë e Qendrës së Ekselencës në Auditim të Zyrës së Auditimit të Qeverisë së SHBA-së (GAO), zhvilloi një leksion të hapur me audituesit e KLSH-së. Tema e leksionit ishte "Roli i GAO-s në provimin e llogaridhënies, rezultateve dhe bashkëpunimit". Leksioni vjen në kuadër të vizitës dyditore të znj.Janet St.Laurent në Shqipëri, ku mori pjesë edhe në Seminarin "SAI dhe Parlamenti".

Në prezantimin e këtij leksioni, znj.Janet St.Laurent i njohu audituesit shqiptarë me misionin e GAO-s dhe parimet ku bazohet puna audituese amerikane. *"Roli i GAO-s është që të mbështesë Kongresin e SHBA-së në ushtrimin e përgjegjësive kushtetuese, të asistojë në performancën e mirë dhe rritjes së llogaridhënies së qeverisë amerikane, për të mirën e popullit amerikan. Për të realizuar këtë mision, GAO mbështetet në disa parime thelbësore si: llogaridhënia, integriteti dhe besueshmëria për të garantuar që punë audituese të jetë profesionale, objektive, jo-partizane, jo ideologjike, e drejtë dhe e balancuar për të ofruar raporte të qarta e më cilësi të lartë mbi mënyrën sesi*

shpenzohet fondet federale".Shumica e raporteve të adutimit në GAO janë të llojit të performancës dhe bazohet në një metodologji të pasur që përfshinë: rastet studimore, kampionimin statistikor, anketimet, intervistat dhe krahasimin e të dhënave.

Për znj. St.Laurent, pavarësia e një Institucioni Suprem Auditimi është parakusht për realizimin e këtij misioni dhe në GAO, Audituesi i Përgjithshëm ka një mandat 15 vjeçar, më të gjerë që mund të kenë drejtuesit e institucioneve, me qëllim që veprimtaria audituese të mbetet e pacenuar nga rotacionet politike. "Audituesi i Përgjithshëm konfirmohet përmes një procesi emërimi të përbashkët, që përfshin Kongresin dhe Presidentin. Ai mund të largohet përmes "impeachment" ose një rezolute të përbashkët në Kongres, për arsye të mirëpërcaktuara".

Në vijim të leksionin, znj.St Laurent u ndal në një pikë të rëndësishme, të rolit thelbësor që ka Kongresi në efektivitetin e punës së një institucioni suprem auditimi, duke vlerësuar gjetjet dhe rekomandimet e SAI-t, si dhe duke kërkuar zbatimin e tyre nga institucionet e audituara. Zj. St. Laurent solli eksperiencën e pasur te GAO-s në raportet me Kongresin Amerikan, ku çdo vit GAO merr pjesë në qindra seanca dëgjimore te Kongresit dhe i dërgon atij me qindra raportime. *"Raporti GAO-Kongres institucionalizohet përmes një Dokument Protokolli. Tashmë kemi një traditë të konsoliduar besimi reciprok ku në shumicën e ligjeve të miratuara, Kongresi sanksionon dispozita të veçanta që i atribuojnë GAO-s të drejtën e auditimit për fushën që rregullon ligji. Në marrëdhëniet SAI- Parlament, raportet e performancës kanë rëndësi pasi zgjerojnë bashkëpunimin me komisione të ndryshme".*

Lektorja amerikane vuri në dukje se marrëdhënia solide GAO-Kongres ka krijuar një mekanizëm efektiv për ndjekjen e rekomandimeve që ka rezultuar në një impakt pozitiv në buxhetin amerikan. "Për vitin fiskal 2016, arritjet e GAO-s përfshijnë një përfitim financiar për buxhetin në masën $ 63,4 miliardë dhe 1234 përmirësime në programe dhe ligje qeveritare. Nga 2000 rekomandime të bëra, 73% e tyre janë implementuar", theksoi znj.St.Laurent.

Në vazhdën e leksionit, znj.Laurent bëri një prezantim edhe të Qendrës për Ekselencë në Auditim të GAO-s, me qëllim ndarjen e eksperiencës së GAO-së me SAI-

t homologe nëpër botë. *"Misioni i Qendrës së Ekselencës në Auditim është që të promovojë mirëqeverisjen dhe të ndërtojë kapacitete institucionale të organizmave kombëtare e ndërkombëtare të auditimit, duke ofruar trajnime, asistencë teknike dhe metodologji inovative. Kjo qendër është një strukturë qendrore e GAO-s, që punon me të gjitha institucionet e auditimit dhe llogaridhënies qeveritare në botë, për të përmirësuar dhe shtuar, nëpërmjet trajnimeve të saj, kapacitetetet e tyre në auditim. Qendra ndihmon institucionet supreme të auditimit publik (SAI-t) të zhvillojnë dhe zbatojnë korniza të shëndosha të sigurimit të cilësisë në auditim dhe plane strategjike e strategji të zhvillimit të burimeve të tyre njerëzore, duke rritur njohuritë për standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t".*Leksioni vijoi me pyetje-përgjigje nga audituesit shqiptarë për identifikimin e fushave dhe prioriteteve të KLSH-së, me qëllim konkretizimin e kornizës së bashkëpunimit, ku do të bazohet asistenca e GAO-s për Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Leksioni përfundoi me një fjalë përshëndetëse të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, z.Bujar Leskaj, i cili shprehu mirënjohjen për mbështetjen që GAO i ka ofruar KLSH-së. "Në këto vitet e fundit, marrëdhënia jonë si KLSH me GAO-n po forcohet dhe po merr trajta konkrete bashkëpunimi. I jemi mirënjohës GAO-s dhe në veçanti z. Dodaro, drejtuesit të saj, që në harkun kohor të dy viteve 2016-2017 mundësuan dhe po realizojnë trajnimin e tre audituesve tanë për 4 muaj pranë zyrave të GAO-s në Uashington D.C. Kjo eksperiencë që po merret është e një vlere të jashtëzakonshme për ne".

Kryetari i KLSH-së theksoi se GAO, si lider i komunitetit INTOSAI, përbën një model për të gjitha institucionet supreme të auditimit në botë, për pavarësinë, profesionalizmin, transparencën dhe integritetin, vlera këto të përmbajtura në standardet ISSAI të INTOSAI-t. *"Mbështetur në këto tradita dhe vlera të patjetërsueshme të kontributit të një SAI si GAO në mbajtjen të përgjegjëshme të administratës së shtetit më të fuqishëm dhe demokratik në botë, por dhe në zhvillimin e auditimit suprem publik, ne si KLSH përkthyem në shqip dhe botuam në vitin 2015 standardet e auditimit të GAO-s, «Yellow Book(Libri i Verdhë)".* Leximi dhe përvetësimi i këtyre standardeve nga audituesit e KLSH-së po i ndihmon ata në punën e tyre të përditshme për të realizuar auditime cilësore. Sfida jonë është të implementojmë standardet e GAO-s, pra të përgatisim "The Albanian Yellow Book", standardet e auditimit suprem publik të Shqipërisë", përfundoi Kryetari i KLSH-së, z.Bujar Leskaj.

Mbahet në Bern të Zvicrës takimi i grupit të punës së EUROSAI-t për projektin e vetëvlerësimit

Në datat 21- 22 mars 2017 u mbajt në Bern të Zvicrës takimi i Grupit të Punës së EUROSAI-t për Vetëvlerësimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Vetëvlerësimit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, organizuar nga Zyra Federale e Auditimit të Zvicrës. Takimi kishte për qëllim shkëmbimin e

eksperiencave të vendeve pjesëmarrëse si dhe përcaktimin e planeve për të ardhmen. KLSH në këtë takim u përfaqësua nga Drejtori i Drejtorisë së Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, z. Kozma Kondakçiu dhe audituesit, z. Meald Abazaj dhe z. Benard Haka.

Në takim u prezantuan eksperiencat e ITSA (vetëvlerësimin e Teknologjisë së Informacionit) të zhvilluara gjatë vitit 2016.

Gjatë këtij takimi KLSH prezantoi rezultatet e Vetëvlerësimit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit (ITASA) të zhvilluar në datat 11 deri me 13 maj 2016 në qytetin e Vlorës.

Të pranishmit vlerësuan si risi:

- shkallën e zhvillimit të Auditimit të TI si dhe gjetjet e ITASA në KLSH;
- mënyrën e organizimit të workshop-it larg vendit të punës dhe zgjedhjen e një Universiteti si vendi i zhvillimit të workshop-it;
- pjesëmarrjen e studenteve e pedagogëve të Teknologjisë së Informacionit të këtij Universiteti në këtë workshop;
- Përcjelljen dhe publikimin në web e media të eventit;
- Zhvillimin e rekomandimeve të ITASA nga Projekti i Binjakëzimit IPA 2013 për forcimin e kapaciteteve të auditimit IT dhe shtrirjen e këtij lloji auditimi në auditimet e tjera. Përgjatë diskutimeve, të pranishmit theksuan se konkluzionet e ITASA-s kanë ndihmuar Auditimin IT në KLSH duke treguar se ai po zhvillohet në rrugën e duhur me një teknologji bashkëkohore. Nga z. Piotr Prokopczyk i NIK të Polonisë në emër të grupit të punës së IT të EUROSAI-t u bë një prezantim i shkurtër mbi:
- Përdorimin e rezultateve të ITASA në Shqipëri nga projekti i binjakëzimit;
- probleme administrative dhe informative mbi kongresin e Stambollit dhe çështje që do të trajtohen në takimin tjetër të Grupit të Punës të Auditimit IT të EUROSAI-t.

Në përfundim, z. Piotr Prokopczyk theksoi se në Kongresin e Stambollit do të paraqitet një prezantim më i zgjeruar mbi rezultatet e bashkëpunimit në kuadër të Projekti të Binjakëzimit IPA 2013 me KLSH për zhvillimin e Auditimit IT dhe shtrirjen e elementeve të tij në formatet e tjera të auditimit.

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit zhvilloi një vizitë zyrtare në Zyrën e Auditimit të Qipros

Në datën 27 mars 2017, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit z.Bujar Leskaj, zhvilloi një vizitë zyrtare në Zyrën e Auditimit të Qipros, ku nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me homologun e tij, z. Odysseas Michaelides.

Kryetari i KLSH-së, Dr.Bujar Leskaj dhe Presidenti i SAI-t të Qipros, Dr. Odysseas Michaelides, bënë nga një prezantim të SAI-ve respektive lidhur me mandatin e tyre të auditimit, pavarësinë e SAI-ve, strukturën organizative, ligjin në të cilin mbështetet funksionimi i SAI-ve në secilin prej të dy vendeve si edhe nenet e Kushtetutës që lidhen me funksionimin e SAI-ve.

Grupet e Punës së INTOSAI-t dhe EUROSAI-t kanë shërbyer si pikëtakime të rëndësishme për zhvillimin e marrëdhënieve mes Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Zyrës së Auditimit të Republikës së Qipros. Një bashkëpunim i frytshëm ka rezultuar përmes Grupit të Punës të EUROSAI-t mbi Auditimin e Mjedisit, ku gjatë muajit dhjetor të vitit të kaluar, në Nikosia u zhvillua takimi paraprak për auditimin e përbashkët të zonave të mbrojtura detare, në të cilin morën pjesë dy përfaqësues të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Kryetari i KLSH-së evidentoi frymën e bashkëpunimit mes KLSH-së dhe SAI-t të Qipros, e cila motivohet dhe gjen shumë gjëra të përbashkëta edhe nga të qenit vende të mesdheut. Zhvillimi i mëtejshëm i kësaj marrëdhënie premton rezultate pozitive për zhvillimin reciprok të të dy SAI-ve, bazuar në moton e INTOSAI "Experientia mutua omnibus podest".

Diskutime midis Kryetarit të KLSH-së dhe Audituesit të Përgjithshëm të Qipros u fokusuan në institucionalizimin dhe konkretizimin e bashkëpunimit në fushën e auditimeve të performancës dhe në veçanti në temat mbi mbrojtjen e mjedisit.

Marrëveshja e nënshkruar është me shumë vlera për KLSH-në dhe vjen pas nënshkrimit të disa marrëveshjeve të bashkëpunimit me SAI-et Evropiane e më gjerë, të tilla si NIK-u Polak, Gjykata Austriake e Auditimit, Gjykata Turke e Llogarive, SAI-et e Kroacisë dhe Sllovenisë dhe në nivel rajonal, me SAI-et e Malit të Zi, Bosnje dhe Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë dhe Bullgarisë. Zbatimi i këtyre marrëveshjeve, ka kontribuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve të KLSH-së.

Zoti Odysseas Michaelides shoqëroj në këtë takim nga z. Kyriacos Kyriacou, zv/Auditor i Përgjithshëm, z. Yiangos Papakyriakou dhe z. Tomazos Georgiu, Drejtorë të Departamenteve të Auditimit, z. Andreas Hassapopoulos, Drejtor i Departamentit Teknik, z.Akis Hadjiossif, z.Akis Kikas dhe zj.Maria Pieri, Auditues të Lartë.

Zoti Bujar Leskaj shoqërohej në këtë vizitë nga znj. Lindita Lati, Drejtoreshë e Përgjithshme, znj. Albana Agolli, Drejtore e Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore dhe zj. Irena Islami, Drejtore e Drejtorisë së

Komunikimit, Botimeve dhe Marrëdhë-nieve me Jashtë.

Në përfundim të takimit, delegacioni i KLSH-së pati mundësinë të zhvillonte një vizitë kulturore në kryqeqytetin e Qipros, Nikosia.

Një grup audituesish të KLSH-së zhvilluan një vizitë studimore në Kroaci

Nga data 27-31 mars 2017, një grup audituesish të KLSH-së zhvilluan një vizitë studimore në Zyrën Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, në kuadër të projektit të binjakëzimit, i cili po implementohet në KLSH nga SAI i Polonisë në bashkëpunim me SAI-n e Kroacisë. Kjo vizitë studimore kishte si qëllim shkëmbimin e eksperiencës së SAI-it Kroat për funksionimin e sistemeve të kontrollit të cilësisë gjatë procesit të auditimit.

Dita e parë e vizitës studimore nisi me urimin e mirëseardhjes nga znj. Lidija Pernar, Asistente e Drejtorit të Përgjithshëm, duke vënë theksin në rolin e institucioneve supreme të auditimit. Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, nënshkruar më datë 27 nëntor 2012, në qytetin e Vlorës dhe në vijim të takimeve të tjera të punës të cilat janë thelluar këto katër vjet, znj. Pernar theksoi se ky bashkëpunim midis dy SAI-eve rezulton i suksesshëm.

Audituesit e KLSH u prezantuan me funksionimin dhe strukturat e SAI-t Kroat. Çështjet kryesore dhe temat e trajtuara gjatë vizitës studimore u fokusuan në rolin që ka kontrolli i cilësisë në të gjitha fazat e auditimit dhe sigurimi dhe menaxhimi i këtij kontrolli gjatë gjithë procesit të auditimit.

Nga kolegët kroatë, në ditën e dytë u prezantuan procedurat që ata ndjekin në lidhje me sigurimin dhe menaxhimin e kontrollit të cilësisë nëpërmjet programit të auditimit software. Ky program ka filluar të zbatohet në vitin 2013 dhe janë dashur thuajse dy vite që të implementohej dhe të përdorej nga të gjithë audituesit. Në fillim të vitit 2015 procesi i auditimit nga faza e planifikimit deri në atë të raportimit ka kaluar nga formati manual në atë elektronik. Sistemi ka si qëllim sigurimin e pavarur të sistemeve të kontrollit të cilësisë dhe lehtësimin e punës audituese. Për të bërë me konkret funksionimin e software prezantimi u shoqërua edhe me shembuj nga praktika.

Duke qenë se SAI- Kroat është organizuar edhe në nivel të zyrave rajonale, gjithsej 20 të tilla, në ditën e tretë të vizitës u zhvillua një vizitë në Zyrën Rajonale të Kakovecit. Nga koleget e kësaj zyre u prezantua qasja që ata kishin në lidhje me programin software për procedurat e sigurimit të kontrollit të cilësisë. Takim u zhvillua në një frymë miqësore dhe në formën e bashkëbisedimit. Nga drejtori i kësaj dege u theksua bashkëpunimi që KLSH dhe Zyra Shtetërore e Auditimit të Kroacisë kanë me njëra-tjetrën dhe për këtë bashkëpunim, shprehu një falënderim të veçantë për dy drejtuesit e institucioneve.

Në ditën e katërt të vizitës studimore audituesit e KLSH-së u përshëndetën nga Audituesi i Përgjithshëm i Zyrës Shtetërore të Auditimit të Kroacisë. z. Ivan Klešić, i cili uroi mirëseardhjen dhe ndër të tjera vuri theksin në bashkëpunimin e ngushtë që dy SAI-et tona kanë jo vetëm në kuadër të projektit të binjakëzimit, por edhe në bashkëpunimin e frytshëm të pesë viteve të fundit. Një falënderim të veçantë, Audituesi i Përgjithshëm përcolli për Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit z. Bujar Leskaj.

Vizita studimore vijoi me bashkëbisedime ku të dy palët shkëmbyen eksperienca dhe praktikat me të mira audituese. Nga drejtoresha e marrëdhënieve me publikun u referua një prezantim interesant në mënyrën se si është e përfshire kjo drejtori në procesin e sigurimit të cilësisë, sidomos në fazën e raportimit. Gjithashtu u pasqyrua një përmbledhje në lidhje me funksionimin dhe detyrat që ka kjo drejtori, mënyra se si SAI Kroat mban lidhje me publikun e gjerë por edhe me median e shkruar dhe atë vizive. Në ditën e fundit të vizitës një nga drejtueset e projektit për komponentin e "Sigurimit dhe menaxhimit të kontrollit të cilësisë", znj. Lidija Pernar prezantoi një përmbledhje të arritjeve të deritanishme të punës së bërë midis kolegeve kroatë, znj. Lidija Pernar e znj. Verica Akrap dhe grupit të punës se KLSH, ngritur për këtë komponent të projektit. Në këtë prezantim u theksua domosdoshmëria e bashkëpunimit dhe u prezantuan *check listat* e hartuara në lidhje me sigurimin e kontrollit të cilësisë për komponentin 2.5.1, *check* lista të cilat janë hartuar nga grupi i punës nën mbikëqyrjen e homologëve kroatë.

Tashmë janë të përfunduara dy check lista për auditimin e performances dhe auditimin financiar, si dhe në auditimet pilot që do të kryen në kuadër të projektit të binjakëzimit do të aplikohet edhe kontrolli i cilësisë nëpërmjet këtyre check listave. Kjo vizitë u mbyll me një bashkëbisedim ku u shprehën mendimet dhe sugjerimet e të dy palëve në lidhje me kontrollin e cilësisë dhe përmirësimin e sistemit të kontrollit. Gjatë vizitës studimore homologët kroatë i njohën kolegët shqiptarë edhe me kulturën dhe historinë e vendit të tyre, në veçanti të kryeqytetit Zagreb, me vizita në Muzeun

Kombëtar dhe atë të Kakovecit. Audituesit e KLSH-së që morën pjesë në këtë vizitë studimore znj. Yllka Pulashi, z. Artur Hasanbelliu, znj. Miranda Haxhija, z. Niko Nako, znj. Mimoza Bedini, znj. Marjola Lleshi, znj. Ina Sokoli, z. Pullumb Beqiraj, znj. Xhuljeta Çelaj znj. Eriola Shia, znj. Jorida Zhegu, znj. Eni Kabashi, znj. Elida Kocani, z. Taulant Dervishaj dhe z. Xheni Xhindoli.

KLSH merr pjesë në takimin e III-të të Grupit të Punës të EUROSAI-t për Auditimin e Fondeve të Alokuara për Fatkeqësitë dhe Katastrofat

Në datat 30-31 mars 2017 u zhvillua në Romë, takimi i III-të i Grupit të Punës së EUROSAI-t për Auditimin e Fondeve të Alokuara për Fatkeqësitë dhe Katastrofat. Takimi ishte konceptuar në formën e seminarit dhe prezantimit të raporteve të auditimit të kryera në këtë fushë nga vendet anëtare të grupit.

Në fjalën e çeljes së aktivitetit, Presidenti i Gjykatës së Llogarive të Italisë, z. Arturo Martucci di Scarfizzi theksoi se Italia është një nga vendet evropiane, e cila vitet e fundit është prekur nga katastrofat natyrore, çka e ka bërë të domosdoshme ngritjen e mekanizmave për minimizimin e pasojave nga këto katastrofa.

Presidenti në detyrë i SAI të Ukrainës, z. Aleksandr Yaremenko, SAI drejtues i Grupit të Punës, bëri prezantimin e aktivitetit 3 vjeçar duke vënë theksin tek implementimi i suksesshëm i strategjisë së grupit të punës, kryerjen në bashkëpunim ose më mënyrë paralele të 3 auditimeve nga SAI-t anëtare, etj.

Në takim u prezantua edhe strategjia e tre viteve të ardhshme, e cila do të fokusohet në implementimin e Axhendës 2030 të Kombeve të Bashkuara për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, parandalimin e katastrofave të shkaktuara nga njeriu dhe ngritja e kapaciteteve e shkëmbimi i eksperiencave mes SAI-eve.

Në takim u prezantua edhe draft rezoluta e Grupit të Punës së EUROSAI-t për Auditimin e Fondeve të Alokuara për Fatkeqësitë dhe Katastrofat që do të prezantohet edhe në Kongresin e EUROSAI-t që do të zhvillohet në maj të vitit 2017 në Stamboll.

Në seminarin me temë "Mundësitë e auditimeve të performancës për vlerësimin e aktiviteteve për parandalimin e eliminimin e pasojave të katastrofave" SAI-et e Ukrainës, Bullgarisë, Federatës Ruse, Polonisë, Turqisë, Italisë dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve referuan mbi praktikat e tyre për planifikimin, kryerjen dhe raportimin për auditimet e performancës të kryera në fushën e fundeve të alokuara për fatkeqësitë dhe katastrofat.

Në sesionin e ditës së dytë "Praktikat më të mira të institucioneve supreme të auditimit" u prezantuan rezultatet e auditimit ndërkombëtar për mbrojtjen

nga ndotja e lumit Bug, raporti për koordiminin e përgjegjësive për t'ju përgjigjur fatkeqësive jashtë BE, kryer nga Gjykata Evropiane e Audituesve, rezultatet e auditimit të performancës mbi përdorimin e fondeve shtetërore për minimizimin e pasojave të katastrofës së Chernobil-it dhe rezultatet e auditimit për sistemin e kontrollit për menaxhimin e përmbytjeve kryer nga SAI i Polonisë.

Në takimin e III të Grupit të Punës të EUROSAI-t për Auditimin e Fondeve të Alokuara për Fatkeqësitë dhe Katastrofat, në të cilin morën pjesë drejtues dhe përfaqësues të SAI-eve të Ukrainës, Bullgarisë, Gjykatës Evropiane të Audituesve, Federatës Ruse, Polonisë, Rumanisë, Serbisë, Turqisë, Moldavisë, Italisë dhe Letonisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga Drejtori i Përgjithshëm, znj. Manjola Naço dhe Audituese e Parë, znj. Alma Shehu.

KLSH merr pjesë në Seminarin me temë "Implementimi i ISSAI 300-Parimet Themelore të Auditimit të Performancës-eksperiencat dhe praktikat më të mira"

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të auditimit publik dhe procesit të përforcimit të përdorimit të Udhëzuesit të Auditimit të Performancës, SAI Sllovak në bashkëpunim me EUROSAI organizuan në datat 4 -6 prill, seminarin me temë "Implementimi i ISSAI 300-Parimet Themelore të Auditimit të Performancës-eksperiencat dhe praktikat më të mira". Në këtë seminar mori pjesë znj.Maria Lucia Lima si përfaqësuese e INTOSAI Development Initiative (IDI) dhe përfaqësues të 29 vendeve anëtare të EUROSAI. Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga znj.Miranda Berdo, Audituese.

Fjala e hapjes në këtë seminar dy ditor u mbajt nga Presidenti i SAI-t Sllovak Z.Karol Mitrik, i cili falënderoi pjesëmarrësit dhe theksoi qëllimin e këtij takimi mbi ndarjen e eksperiencave në përdorimin e ISSAI 300 (miratuar në INCOSAI 2013), ISSAI 3000, 3100, 3200 (miratuar në INCOSAI 2016) dhe zhvillimin e diskutimeve mbi metodologjinë e implementimit të tyre në auditime performance.

Sesioni i parë u drejtua nga përfaqësuesi i SAI-t të Suedisë, z.Tony Angleryd duke prezantuar përfitimin, zhvillimin dhe standardizimin që po ndjekin auditimet e performancës së SAI-ve, nëpërmjet përdorimit të Udhëzuesit të Auditimit të Performancës.

Përfaqësuesi i SAI-t të Austrisë z.Norbert Weinrichter diskutoi mbi sfidat e institucioneve audituese në procesin e implementimit së standardeve të auditimit të performances dhe përfitimet nga trajnimet apo kualifikimet për arritjen e rezultateve cilësore.

Sesioni i dytë u drejtua nga znj.Elise Fidjestel, përfaqësuese e SAI-t të Norvegjisë, kumtesa e së cilës njohu pjesëmarrësit me Planin Strategjik 2017-2019 të SAI-ve anëtare të INTOSAI-t, dokument i cili do të miratohet këtë vit në Oslo.

Në përfundim pjesëmarrësit theksuan që sesione të tilla trajnimi midis SAI-ve janë një kontribut më shumë në shkëmbimin e eksperiencave dhe njëkohësisht rrisin pritshmëritë institucionale, cilësinë e auditimeve të performancës dhe besueshmërinë në publik.

Prof. Dr. Skënder Osmani dhe Kryetari i KLSH-së, Dr.Bujar Leskaj, zhvilluan leksionin me temë "Burimet, menaxhimi dhe stafi"

Në ambientet e Fakultetit të Gjeologjisë e Minierave të Universitetit Politeknik të Tiranës, Prof. Dr. Skënder Osmani dhe Kryetari i KLSH-së Dr.Bujar Leskaj zhvilluan një leksion me temë "Burimet, menaxhimi dhe stafi". Të pranishëm në leksion ishin dekani i Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, Prof. Dr. Vasil Jorgji, ish-dekani Prof. Dr. Përparim Hoxha, pedagogët Prof. Dr. Gafur Muka, Prof. Dr. Thoma Korini, Prof. Dr.Bashkim Çela, studentë si dhe auditues e drejtues të KLSH-së.

Leksioni trajtoi çështjet e mëposhtme:

•Burimet, Struktura, Sistemi, Risku, Menaxhimi;

•Optimizimi, Kërkimi Operacional, Menaxhimi;

•Optimizimi me shumë kritere, vendim-marrja, qeverisja;

•Nevoja për ngritjen e Departamentit të Menaxhimit dhe Institutit të Menaxhimit;

•FGJM dhe KLSH- Operatorë të rëndësishëm zhvillimi;

•Përfundime- Menaxhimi, Prapambetja, Zhvillimi, Reformat.

Në prezantimin e leksionit, Prof. Dr. Skënder Osmani nënvizoi rëndësinë e menaxhimit, si një gur themeli për zhvillimin e vendit. Me një historik zhvillimi qysh prej vitit 1997, menaxhimi si disiplinë shkencore ende nuk është

lëvruar në të gjithë morfologjinë e saj shkencore. "Menaxhimi është në rend dite si diplomë në vendet e zhvilluara dhe mjafton të përmendim se në Britaninë e Madhe ekzistojnë rreth 51 tekste për këtë disiplinë. Menaxhimi është sinonim i zhvillimit në çdo fushë, në mësim, punë, mjekësi, shkencë, politikë, kulturë, kontroll, etj., në çdo cep e sektor të vendit në energji, industri, financë, ekonomi, qeverisje, mjedis, mbrojtje etj. Kuptimet themelore të tij si burim, strukturë, sistem, proces, inteligjencë, funksion etj, të zbatuara në praktikë janë universale për nga vlera, drejtimi, strategjia, studimi, kërkimi dhe zhvillimi. Jeta është projekt, jeta është risk, jeta është menaxhim, jeta është sistem, jeta është efiçiencë, jeta është fazi".

Ndërthurja e debatit filozofik mbi jetën dhe atij shkencor mbi menaxhimin si disiplinë duket se nuk shkaktoi përplasje konceptuale, siç rëndom ndodh mes filozofisë dhe shkencës. Përkundrazi, krijoi një "mirëkuptim" mes dy koncepteve reflektuar kjo në aksiomën se jeta është optimizim me shumë objektiva dhe kritere. Në të gjithë sipërmarrjet e tij, qofshin ekonomike apo jo, njeriu kërkon të përcaktojë maksimumin ose minimumin e asaj çka synon të arrijë. Në këtë gjykim, theksoi Prof. Dr. Skënder Osmani parimi i 3E-ve, ekonomiciteti, eficienca dhe efektiviteti na përcaktojnë maksimumin ose minimumin më të afërt, por jo nivelin e saktë. Problemi bëhet edhe më kompleks kur një nga kriteret dominonin mbi të tjerët. Në këtë rast, theksoi Profesor Osmani, është efiçienca që na vjen në ndihmë për të dhënë gjykimin tonë se cilët nga kriteret prevalon mbi tjetrin. Optimizimi me shume kritere dhe plotësime është vazhdimi i punës së bërë nga përvoja e deritanishme në Universitet dhe në Kontrollin e Lartë të Shtetit si edhe i synimeve të zhvillimit të optimizimit dhe i zbatimit të tij për rritjen e performancës në shumë fusha inxhinierike, ekonomike, financiare, mjedisore, infrastrukturore, shëndetësore, në fund por jo me më pak rëndësi, në auditimin dhe kontrollin", theksoi Prof. Dr. Osmani.

Një komponent i rëndësishëm i menaxhimit është edhe teoria e lojës dhe në shtjellimin e kësaj teorie, leksioni i Prof. Dr. Skënder Osmanit dhe Dr. Bujar Leskaj solli idetë e ekonomistit të shquar, Lloyd Shapley, laurant i çmimit Nobel, si mjeshtër i lëvrimit të teorisë së lojës. "Në një sistem, burimet bashkëveprojnë e procedohen nëpër strukturën dhe/ose infrastrukturën përkatëse që i mban këto burime të bashkëveprojnë, komunikojnë. Kur këto burime janë njerëz, ky bashkëveprim ndërmjet tyre në përgjithësi është reciprok, njeri thotë një gjykim, etj, tjetri e pret dhe thotë të tijën, i pari e dëgjon, i dyti e pret, pastaj mesazhi i pritur dërgohet tek origjina, e kështu me radhë vazhdon loja, ndërsa kur njeri nuk e vazhdon, apo e le sipas një marrëveshje para se të futet në lojë,

atëherë kundërshtari shpallet fitues. Leksioni i Prof. Dr. Skënder Osmani dhe Dr. Bujar Leskaj, përpos një analizimi teorik dhe praktik të menaxhimit si një disiplinë shkencore, përmban një propozim për ngritjen e një Institutit të Menaxhimit, për përgatitjen universitare të menaxherëve në Fakultetin e Gjeologjisë ose në përgjithësi në Universitetin Politeknik me kurrikula të ndara ose jo të ndara me pjesëmarrjen e një ose disa fakulteteve nga Universiteti Politeknik dhe jashtë tij. Sipas lektorëve, kjo është një domosdoshmëri kombëtare duke patur parasysh që vendi ynë ka një prapambetje relativisht të madhe, madje dhe rolin e projektizimin, të menaxhimit, modelimit, optimizmit, riskut për zhvillimin e vendit.

Leksioni ishte në shenjë homazhi, vlerësimi dhe mirënjohjeje për rektorin e parë të Universitetit të Tiranës, Prof. Kahreman Ylli, për rektorët Prof. Petrit Radovicka dhe Prof. Osman Kraja si dhe për dekanët Prof. Eshref Pumo dhe Prof. Rexhep Reka.

Një grup audituesish të KLSH-së morën pjesë në takimin e task-forcës për auditimin e bashkive në Lituani

Nga data 11-12 prill 2017, një grup audituesish të KLSH-së morën pjesë në takimin e zhvilluar nga Zyra Kombëtare e Audtimit të Lituanisë, mbi Task Forcën e EUROSAI për auditimin e bashkive (EUROSAI TFMA) . Motoja e këtij takimi ishte *"Bashkimi i forcave – rezultate më të mira. Ne mund të përfitojmë nga puna e njëri tjetrit".*

Ky takim u ndoq nga më shumë se 50 pjesëmarrës, nga 26 vendet anëtare të EUROSAI. Në të u diskutua programi i punës së EUROSAI - TFMA për vitet 2017-2019, u përcaktuan përgjegjësitë e detyrat e veçanta të SAI-ve pjesëmarrëse si dhe u miratuan dokumentet strategjike.

EUROSAI TFMA u krijua në qershor të vitit 2016, kur Bordi Drejtues i EUROSAI mbështeti iniciativën e Zyrës Kombëtare të Audtimit të Lituanisë, për të bashkuar ato SAI të EUROSAI, të cilat janë të interesuara për çështjet e auditimit të bashkive, me synim përmirësimin e sistemit të procesit të auditimit në mënyrë që rezultatet e auditimit të sjellin ndryshime pozitive për bashkinë si dhe përfitime për secilin qytetar.

Zyra Kombëtare e Audtimit të Lituanisë, si nismëtare e kësaj ideje, ka marrë përgjegjësinë për të kryesuar TFMA, koordinimin e aktiviteteve dhe komunikimit të tij, midis anëtarëve të TFMA dhe partnerëve të saj të jashtëm. Kjo Zyrë ka planifikuar të zbatojë masat e programit të punës dhe të bëjë analiza të sistemeve bashkiake në vendet e EUROSAI. Në ditën e parë të punimeve, audituesve i uroi mirëseardhjen Auditori Gjeneral i kësaj zyre Dr. Arūnas Dulkys,

duke vënë theksin në rolin e Institucioneve Supreme të Auditimit në Task Forcën e auditimit të bashkive, në vendet anëtare të EUROSAI.

Në këtë takim u diskutua mbi përmirësimin e website-it të EUROSAI TFMA, shkëmbimin e praktikave më të mira për të arritur rezultatet e auditimit me ndikim thelbësor në drejtim të përmirësimit të menaxhimit financiar publik, përmirësimit të auditimit të jashtëm bashkiak, si dhe auditimit të sistemit të bashkive në Evropë.

KLSH u ftua në këtë takim të marrë pjesë me një model auditimi të kryer në një bashki, për takimin e radhës i cili do të zhvillohet në Riga të Letonisë, në muajin tetor 2017.

Ky takim u mbyll me një bashkëbisedim, ku u shprehën mendimet dhe sugjerimet e palëve në lidhje me përmirësimin e punës audituese në bashki në vendet anëtare të TFMA/EUROSAI.

Kontrolli i Lartë i Shtetit në këtë takim u përfaqësua nga znj.Lolita Baholli, z. Selfo Zeneli, z.Kristaq Gjurgjaj dhe z. Xhein Xhindoli.

Presidenti i Republikës së Polonisë, dekoroi Kryetarin e KLSH-së, z.Bujar Leskaj

Presidenti i Republikës së Polonisë, SH.T.Z Andrzej Duda dekoroi me Urdhrin "Kryqi kalorsiak i urdhrit për merita në dobi të Republikës së Polonisë", Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, z.Bujar Leskaj.

Ceremonia u zhvillua në datën 19 prill 2017 në Varshavë, në ambientet e Institucionit Suprem të Auditimit të Republikës së Polonisë (NIK). Në ceremoninë e dekorimit morën pjesë Ministri i Shtetit, pranë Presidentit, zv/Ministri i Punëve të Jashtme, zj.Renata Szczech, Presidenti i NIK-ut polak, z. Krzysztof Kwiatkowski, zv/Presidenti i NIK, z.Wojciech Kutyla, Ambasadorja e Republikës së Shqipërisë në Poloni, zj.Shpresa Kureta, deputetë të Kuvendit të Republikës së Polonisë, drejtues dhe auditues të NIK-ut polak dhe përfaqësues të KLSH. Dekorata akorduar nga Presidenti i Republikës, SH.T.Z Andrzej Duda iu dorëzua z.Leskaj nga Sekretari i Shtetit, pranë Presidentit z. Andrzej Dera.

Për autoritetet polake, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit mund të konsiderohet padyshim si një mik i Polonisë dhe promovues i kulturës polake. "Zoti Leskaj që në fillim të mandatit të tij si Kryetar i KLSH-së ka mbështetur dhe ka qenë promotor i bashkëpunimit mes dy Institucioneve Supreme të Auditimit. Ky bashkëpunim ka qenë i frytshëm në drejtim të forcimit të kapaciteteve të audituesve dhe veçanërisht në drejtim të mbështetjes që institucionet i kanë dhënë njëri tjetrit në komunitetin e INTOSAI-t dhe të EUROSAI-t. Edhe në të shkuarën, në cilësinë e Ministrit të Kulturës të

Shqipërisë, z.Bujar Leskaj ka promovuar kulturën polake në Shqipëri. Kryetari Leskaj ka mbështetur iniciativa për njohjen në Shqipëri të letërsisë, artit dhe muzikës klasike të Polonisë si dhe të historisë dhe traditës së kulturës polake, përmes botimeve dhe artikujve në shtypin dhe mediat shqiptare", theksoi Sekretari i Shtetit pranë Presidentit z. Andrzej Dera.

